
Trashëgimia kulturore-historike

Viti i II-të
Profesioni: hotelierri-turizëm
Teknik hotelieri-turizëm

Mr. Vesna Gjurovska

Dr. Lidia Kovaçeva

Autore:

Mr. Vesna Gjurovska,
Dr. Lidia Kovačeva

Recensues:

1. Akademik Prof. dr. Vitomir Mitevski
2. Prof. Tamara Petreska
3. Prof. Limonka Arminovska

Redaktor profesional: Doc. Dr. Abdilnaser Sinani

Përkthyes: Refadije Zeneli

Lektura: Jehona Ejupi

Botues:

Ministria e arsimit dhe shkencës e Republikës së Maqedonisë

Shtypi: Graficki centar dooel, Shkup

Tirazhi: 30

Со одлука бр.22-264/1 од 14.03.2013 на Националната комисија за учебници, се одобрува употреба на учебникот

Me vendim nr.22-264/1 nga 14.03.2013 të komisionit kombëtar për libra, lejohet përdorimi i këtij libri.

CIP- Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека „Св. Климент Охридски“, Скопје

930. 85 (075.3)

ЃУРОВСКА, Весна

Културно-историско наследство: II година угостителско-туристичка струка: хотелско-туристички техничар / Весна Ѓуровска, Лидија Ковачева. -Скопје: Министерство за образование и наука на Република Македонија, 2013. - 108 стр. : илустр. ; 26 см

ISBN 978-608-226-365-6

1. Ковачева, Лидија [автор]

COBISS.MK-ID 94269962

Trashëgimia botërore kulturore-historike paraqet bazë, themel dhe shenjë për njohjen e çdo qytetërimi. Të gjitha format artistike të trashëgimisë botërore kulturore-historike (arkitektura, skulptura, pikturimi, religjioni, muzika, letërsia) janë definuar dhe me ligj janë mbrojtur.

Me leximin e këtij libri, nxënësi mund të fitoj bazë solide mbi atë që paraqet trashëgimia botërore kulturore-historike. Libri është përgatitur sipas programit mësimor të lëndës mësimore Trashëgimia kulturore-historike për vitin e II-të, për profilin arsimor profesioni Hotelieri-turizëm, teknik hotelieri-turizëm.

Përmbajtja është ndarë në nëntë tërësi tematike: trashëgimia botërore kulturore-historike, parahistoria, shekulli i vjetër, shekulli i mesëm, renesanca, baroku dhe rokokoja, arti evropian në shek. e XIX-të, arti modern në shek. XX-të, kultura dhe arti i Lindjes së Largët dhe Amerika Jugore. Këto tërësi tematike duhet t'i ndihmojnë nxënësit në realizimin e qëllimeve të parashtruara në programin mësimor nga kjo lëndë. Pas njohurive të tërësive tematike, nxënësi duhet:

- *T'i njeh fillimet e trashëgimisë botërore kulturore-historike në parahistori;*
- *Të identifikoj trashëgiminë kulturore-historike në shekullin e vjetër dhe të mesëm;*
- *Të shpjegon trashëgiminë kulturore-historike nga epoka e renesancës së hershme dhe asaj të lartë;*
- *T'i dalloj specifikat e barokut dhe rokoko artit;*
- *T'i përshkruajn karakteristikat kryesore të kulturës dhe artit në shek. XIX-të dhe të XX-të;*
- *Të njeh trashëgiminë kulturore-historike në Lindjen e Largët dhe në Amerikën Jugore, dhe t'i përshkruaj karakteristikat e tyre kryesore;*
- *Të shtoj ndjenjën për trashëgiminë botërore kulturore-historike dhe vlerat e saja estetike.*

Krahas kësaj, janë përpunuar dhe qëllimet konkrete që libri duhet t'i realizoj nëpërmjet përpunimit të tërësive tematike.

Autorët me falënderim do t'i pranojnë vërejtjet për përmirësimin e përmbajtjes së këtij libri, si dhe tregimet për lëshimet dhe gabimet e bëra në tekst.

Nga autorët.

Përmbajtja

Parathënie	3
Përmbajtja	4
1. Trashëgimia botërore kulturore-historike	7
Nocioni për kulturë dhe art.....	9
Arti nëpër histori.....	9
2. Parahistoria	11
Kultura dhe arti në parahistori.....	12
Kultura parahistorike dhe arti në hapësirat ballkanike dhe në Maqedoni	16
3. Shekulli i vjetër	19
Kultura mesopotamike dhe arti.....	21
Kultura egjiptiane dhe arti	23
Kultura dhe arti në botën minoje-mikene.....	25
Kultura dhe arti te Grekët e lashtë.....	27
Kultura etrurë dhe arti.....	30
Kultura romake dhe arti.....	31
Kultura antike dhe arti i hapësirave ballkanike në Maqedoni	33
4. Shekulli i mesëm	35
Kultura e hershme krishtere dhe arti.....	37
Kultura bizantine dhe arti	38
Kultura e shekullit të mesëm dhe arti në Rusi	41
Kultura e shekullit të mesëm dhe arti në Evropën Perëndimore	42
Trashëgimia kulturore-historike islame.....	45
5. Renesanca	47
Renesanca e re në Itali.....	49
Arti i hershëm në Flandri, Francë dhe Gjermani.....	52
Renesanca e lartë në Itali	53
Arti në Francë, Holandë dhe Gjermani në shek. XVI.....	58

<i>Zhvillimi i shkencës, letërsisë dhe muzikës</i>	59
6. Baroku dhe rokokoja	61
<i>Kultura dhe arti i barokut</i>	63
<i>Rokoko-stili</i>	67
7. Kultura evropiane dhe arti në shek. XIX-të	69
<i>Klasicizmi</i>	71
<i>Romantizmi</i>	73
<i>Realizmi</i>	75
<i>Impresionizmi</i>	76
<i>Kultura dhe arti i vendeve ballkanike në shek. XIX-të</i>	77
<i>Kultura dhe arti në Maqedoni në shek. XIX-të</i>	79
8. Arti modern në shek. XX-të	81
<i>Neoimpresionizmi</i>	83
<i>Postimpresionizmi</i>	83
<i>Skulptura moderne</i>	84
<i>Simbolizmi</i>	85
<i>Fovizmi</i>	85
<i>Ekspresionizmi</i>	86
<i>Kubizmi</i>	88
<i>Futurizmi</i>	89
<i>Arti i abstraktit</i>	89
<i>Neoplasticizmi</i>	90
<i>Mbirealizmi</i>	91
<i>Skulptura në shek. XX-të</i>	91
<i>Pop-arti dhe konceptualizmi</i>	92
<i>Arkitektura në shek. XX-të</i>	92
<i>Kultura në shek. XX-të</i>	93
<i>Kultura dhe arti në shek. XX-të në hapësirat ballkanike dhe në Maqedoni</i>	94
9. Kultura dhe arti në Lindjen e Largët dhe Amerikën Jugore	97
<i>Kultura dhe arti në Indi</i>	99
<i>Kultura dhe arti në Kinë</i>	101

<i>Kultura dhe arti në Amerikën Jugore</i>	<i>102</i>
<i>Fjalori i shpjegimit të nocioneve</i>	<i>105</i>
<i>Literatura e shfrytëzuar</i>	<i>107</i>



1. Trashëgimia botërore kulturore-historike

- *Nocioni për kulturë dhe art*
- *Arti gjatë historisë*

Trashëgimia botërore kulturore-historike

Rezyme mbi temën

Gjurmet e shumta të materialeve dhe artefakteve arkeologjike janë shprehja më e dukshme e kulturës popullore materiale dhe shpirtërore, të përcaktuara si *trashëgimi kulturore-historike*, e cila e paraqet pasurinë më të madhe të çdo vendi. Çdo popull ka trashëgimi të vetë kulturore-historike, ndërsa së bashku paraqesin *trashëgimin botërore kulturore-historike*.

Trashëgimia botërore kulturore-historike nëpërmjet kulturës materiale dhe shpirtërore është vazhdimësi nga kohërat e vjetra e deri më sot. Për zhvillimin e kulturës së këtyre hapësirave dëshmojnë një numër i madh i materialeve të zbuluara në lokalitetet e shumta arkeologjike nëpër botë.

Çdo periudhë historike karakterizohet me stil të caktuar të formave artistike, të cilat janë zhvilluar me gjatë ekzistimit të saj. Trashëgimia botërore kulturore-historike i shënon përfitimet ngarealizimet artistike, si nga qytetërimet e ndryshme dhe periudha të ndryshme të historisë së artit.

Terme kryesore:

Kultura, arti, format artistike, stili, drejtimi

Nocioni për kulturë dhe art

Vërejtja kryesore e trashëgimisë popullore kulturore, shpirtërore dhe artistike është sinkretizmi i kulturave dhe religjioneve të popujve që në periudha të ndryshme kohore kanë jetuar në hapësira të caktuara.

Për trashëgiminë botërore kulturore-historike dëshmojnë burime të shumta, **të pa shkruara** (para paraqitjes së letrës) dhe të shkruara (pas paraqitjes së letrës). Me ndihmën e burimeve materiale studiohet edhe **kultura shpirtërore**, siç janë *arti, religjioni, lidhjet kulturore dhe politike*. Njohja e kulturës shpirtërore është e mundshme, vetëm nëse dihet se çdo material i lëndës paraqitet si rezultat i vlerës së përcaktuar shpirtërore të njeriut (mendim, ide).

Që të kuptohet vepra e caktuar artistike, duhet të kuptohet çka në realitet ka dëshiruar të thotë artisti, të njihet bukuria e mënyrës së tij të shprehjes dhe të merret parasysh epoka në të cilën është krijuar vetë vepra.

Krijimtaria artistike ka forma **artistike specifike**, që me kalimin e kohës pësojnë ndryshime të caktuara. Sipas ndarjes së artit të Grekët e lashtë ndahen gjashtë forma artistike, **arkitektura, skulptura, piktura, kërcimi, muzika dhe letërsia**. Më vonë si forma artistike shtohen edhe *filmi dhe fotografimi*.

Mbaj mend:

Veprat që kanë lënë përshtypje më të madhe dhe me ndikim quhen **kryevepra**.

Mbaj mend:

Kultura paraqet tërësi të materialeve dhe vlerave shpirtërore të cilat janë nën ndikim të kornizave tradicionale dhe ndryshimeve bashkëkohore, dhe që e formojnë sjelljen e pranuar të anëtarëve të një shoqërie.

Mbaj mend:

Arti është veprimtaria njerëzore ose prodhim i veprimtarisë së njeriut, që ka për qëllim t'i stimuloj shqisat e njeriut, mendjen e njeriut dhe shpirtin e njeriut.

Bëj dallim:

- Nevoja për art quhet **kreativiteti i njeriut**.
- Me ndihmën e kreativitetit të njeriut krijohet **vepra artistike**.
- Ato që i krijojnë veprat artistike, quhen **artistë**.



Figura 1. Zoti i jep frymë Adamit, fragment, pjesë nga Gjykata tmerruese, Mikelanxhelo, Morgu Sikstin, Vatikan, kryevepër.

Arti gjatë historisë

Arti paraqitet si përgjigje e ndonjë nevoje të thellë të shoqërisë në të cilën ka ndodhur. Qëllimi fillestar i artit në civilizimet e lashta ishte religjioze dhe shpesh ka drejtuar në raportin mes njeriut dhe perëndive. Me zhvillimin e civilizimeve janë paraqitur nevoja të ndryshme për shprehje artistike, si p.sh.: tregimi i personave historik dhe funksioneve të tyre politike, disa ngjarje historike, motive nga jeta e përditshme e njerëzve etj. Dhe përkrah motiveve të ndryshme, arti shpesh është inspiruar nga ngjarjet e vërteta dhe paraqet dëshmitar të kohës në të cilën është krijuar.

Arti, me të gjitha format e ekzistimit të vet nuk është statik, por nëpër shekuj është riformuar dhe plotësuar. Çdo epokë është karakterizuar me stil të caktuar të formave artistike, që është zhvilluar gjatë ekzistimit të vet.

Çdo periudhë historike është shënuar me stile të caktuara artistike:

- **Periudha parahistorike;**
- **Periudha antike;**
- **Shekulli i mesëm;**
- **Epoka e renesancës;**
- **Epoka e barokut dhe rokokosë;**
- **Arti në shek. XIX-të, kur në vend të stileve paraqiten drejtime dhe**
- **Arti modern ose arti i shek. XX-të.**

Gjatë periudhave historike, të gjitha këto stile dhe drejtime artistike, të përfaqësuar në format e ndryshme artistike, kanë dhënë emra kulmor nga fusha artistike, që e kanë shënuar periudhën e dhënë të krijimtarisë së tyre.



Hulumto:

Vizito një nga muzetë dhe shkruaj një ese për veprën artistike që do të le përshtypje më të madhe.



Bëj dallim:

- Historia e artit i hulumton format e ndryshme të shprehjes artistike në epoka të ndryshme nga e kaluara e largët.
- Teoria e artit e hulumton natyrën e artit, ndërsa me këtë edhe shënimet esenciale të veprave artistike dhe vlerës së tyre estetike specifike.



Diskutoni:

Me arsimtarin e artit bisedoni për dallimet në drejtime dhe stilet artistike.

A photograph of the Stonehenge monument in England, featuring several large, grey, rectangular stone structures arranged in a circular pattern on a grassy field. The sky is a mix of orange, yellow, and blue, suggesting a sunset or sunrise. The text is overlaid on the image.

2. Parahistoria

- Kultura dhe arti në parahistori***
- Kultura parahistorike dhe arti në hapësirat ballkanike dhe në Maqedoni***

Parahistoria

Rezyme

Parahistoria është periudhë e zhvillimit të shoqërisë njerëzore, e cila i paraprinë në paraqitjen e burimeve të shkruara. Ndarja e periudhave në parahistori është kryer në bazë të studimeve të zhvillimit të kulturës materiale dhe trashëgimisë materiale.

Format më të vjetra të shprehjes artistike vërehen qenë paleolit. Lokalitetet e zbuluara arkeologjike nga koha e neolitit, nëpërmjet artefakteve të shumta materiale na mësojnë mbi artin nga kjo periudhë. Përdërisa, koha metalike, si etapë përfundimtare të parahistorisë, çon në periudhën e qytetërimeve të para, me të cilat fillon historia e shekullit të vjetër.

Terme kryesore:

Parahistoria, paleoliti, neoliti, kultura megalite, koha metalike, shekulli i vjetër, arti antik

Kultura dhe arti në parahistori

Kultura e paleolitit dhe arti

Parahistoria është periudha më e vjetër në zhvillimin e njerëzimit, e shënuar me: jeta e përbashkët e njerëzve parahistorik në vendbanime natyrore – *shpella*; mbledhja e frutave dhe gjahu i kafshëve të egra; paraqitja e armëve të mprehta të përpunuara dhe armë të përpunuara nga guri dhe kockat; paraqitja e fjalimit dhe zbulimi dhe përdorimi i zjarrit.

Përpjekjet e para për shprehje artistike të njeriu janë paraqitur në kohën e vjetër të gurit ose në atë **paleolite**. Të gjitha vizatimet, gdhendjet dhe fotografitë janë zbuluar në thellësitë e shpellave, larg hyrjes, në vende të pandriçuara dhe me qasje të vështirë për njeriun. Cikli i **pasqyrimeve** të jashtëzakonshme të shpellave janë skena për gjah, kafshë të egra dhe njerëz, të ruajtura në muret dhe tavanet e shpellave **Lasko** në Francë dhe **Altamirë** në Spanjë. **Skulpturat** e përpunuara në dimensione të vogla nga guri dhe kocka. Më të njohura janë skulpturat me figura të grave, të ashtuquajtura **Venera paleolite**, që për shkak pjesëve të theksuara të trupit (stomakut dhe gjoksit) janë konsideruar si **stërgjyshe dhe simbol i frytit**.

Religjioni është zhvilluar nën kushte të caktuara psikologjike. Njerëzit, para paraqitjeve: vetëtimë, rufe, vulkan, lumenj, shkëmbinj me forma të çuditshme, kafshë të ndryshme, etj., janë ndjerë të pafuqishëm dhe i kanë përjetuar si të shenjtë. Për ata ishin (tabu) të ndaluara dhe i kanë strehuar në sferën e mrekullisë. Besimi **për origjinë** nga ndonjë kafshë, bimë ose mjet, ka sjell deri të paraqitja e **totemizmit**, si formë më e vjetër e besimit.

Hulumto: Çka është totemizmi dhe vallë sot ekzistojnë fise që besojnë në të?



Figura 2. Shenjat e dorës, shenjë e parë e materialit nga njeriu, shpella në Gargas, Francë.

Mbaj mend:

Kulturat e paleolitit e kanë marrë emrin sipas lokaliteteve ku janë gjetur.



Figura 3. Venera Vilendorfe

Mendo:

Vallë nën nocionin paleolit është shënuar një periudhë e caktuar kohore, së bashku për tërë botën ose përsëri paleoliti paraqet shkallë të zhvillimit nëpër të cilin kanë kaluar popujt e ndryshëm, në kohë të ndryshme?



Mëso më shumë: Si janë ruajtur deri tani figurat paleolitike?

Figurat janë vizatuar në vetë shkëmbinj të shpellës, dhe në mënyrë të shkathtë janë shfrytëzuar çarjet, plasjet dhe thellësitë e mureve. Së pari, në gur është vizatuar paraqitja e preferuar, pastaj është ngjyrosur me brushë nga fibrat ose pendët e kafshëve. Kohëzgjatja i dedikohet teknologjisë: shkëmbinj të paraprakisht janë lyer me vaj kafshe ose me rrëshirë, ndërsa pastaj me ngjyrë të bërë nga ngjyrat e tokës, e përzier me yndyrë ose qumësht bime për shkak lidhjes më të lehtë, pastaj vizatohet, thahet dhe mbetet e përhershme.



Figura 4. "Bizoni i hershëm" shpella Altamira, Spanja Veriore.



Figura 5. Stounhenxh, Angli

Kultura neolite dhe arti

Neoliti ose koha e hershme e gurit, është koha kur njeriu e ka braktisur gjahun dhe ka filluar të merret me bujqësi dhe blegtori. Prej aty, ishte lidhur me tokën dhe ka banuar në ultësira, pranë lumenjve dhe **afër** burimeve **të ujit**. Atëherë, për herë të parë ka filluar ndërtimi i strehimoreve, të ashtuquajtura vendbanime, dhe me kalimin e kohës ka nisur ndërtimi edhe i varrezave dhe shenjtorë nga guri.

Këto objekte fetare janë ndërtuar në mënyrë monumentale, me tulla të mëdha me gurë jo të përpunuar, të rënda me dhjetëra tonë. Ndërtimi me tulla të mëdha prej guri ka sjell deri te paraqitja e **kulturës megalite**. Kjo kulturë monumentale paraqitet në zonat perëndimore të Evropës, ndërsa në një nga më të njohurat është observatori parahistorik **Stounhenxh në Angli**.

Nga kjo periudhë janë gjetur një numër i madh i enëve qeramike dhe ekzemplarëve të ndryshëm nga **tregimet relieve** të perëndeshave neolite të shkëmbinjve, idhujve dhe maskave, p.sh. **koka e mermertë nga Kikladet**.

Bujku neolit ka besuar se çdo paraqitje ka **shpirt** (animë), pra nga këtu del nocioni **animizëm**.

Hulumto:

Cilat ndryshime kanë ndodhur në jetën e njerëzve parahistorik me paraqitjen e bujqësisë dhe blegtorisë?



Figura 6. Koka e mermertë, Kikladi



Mëso më shumë dhe mendo, në cilin vend në Republikën e Maqedonisë ka ndërtesa të këtilla?

Llojet e ndërtimeve janë dalluar në varësi të mënyrës së jetës së njerëzve. Në fillimin e neolitit njerëzit kanë ndërtuar **ndërtesa** nga **toka ose gjysmëtoka**, të grupuara në kanale me formë rrethi jo të rregullt, drejt-këndëshi ose katrori, të mbuluara me çati nga degët dhe të lyera me argjilë. Për shkak shirave të shumta, vendbanimet shpeshherë ishin vërshuar, prandaj janë ndërtuar vendbanime nëntokësore me dysheme nga toka e ngjeshur, me mure të lyera me lloç dhe me çati nga degë, i cili ishte vendosur në trup në mesin e vendbanimit. Më vonë, në neolit paraqitet grupi më i madh i vendbanimeve të lokalizuara te liqenet ose te toka me moçal, të ashtuquajturat **vendbanime të ngjitura ose të grumbulluara**.



Figura 7. Nga toka

Shkruaj ese:

Bëj krahasim për mënyrën dhe vendin e jetesës së njerëzve në paleolit, neolit dhe kohën e hekurit.

Kultura dhe arti në kohën e metalit

Epoka e metaleve e shënojnë kohën e bronzit dhe të hekurit, që karakterizohen me zhvillim të shpejtë të shoqërisë: Njeriu ka mësuar të mbledh dhe të përpunon flori dhe argjend, ndërsa pastaj edhe bakër (së pari e ka farkuar me çekan, ndërsa pastaj e ka lëmuar).

Veprimtaria artistike ishte drejtuar kah përpunimi i qeramikës, stolisë, pjesëve nga pajisja ushtarake dhe armët, ndërsa materiale bazë për përpunimin e argjilit dhe metaleve: bronz, flori, dhe hekur. **Arkitektura** shënon vendbanime të përsosura të ndërtuara prej druri, të përforcuara me ngjitje të metalta. **Skulpturat** në përgjithësi ishin formuar me duar në argjilën e lagët, që pastaj është pjekur.

Kjo periudhë shënon më shumë zbulime: plugin, rrota e poçarit, kalendar, letër, etj.



Figura 8. Pjesë nga pajisja dhe armët ushtarake (koha e hekurit)

Hulumto:

Me arsimtarin tuaj shkoni deri te lokaliteti më i afërt arkeologjik ose muze dhe bisedoni rreth asaj që aty do ta shihni.

✍ Mëso më shumë dhe hulumto në bibliotekë ose në internet për ndërtimet në kohën e vjetër

Vendet e banuara ishin ndërtuar me adhurime të rëndësishme strategjike dhe jo të qasura, të lokalizuara në lugina të lumenjve ose në drejtime të rëndësishme rrugore. Këto lagje ishin rrethuar me një, dy ose më shumë kështjella me bedene mbrojtëse të larta. Rruga hyrëse kalon nëpër bedeme, me çka mbrojtja ishte më efikase. Në brendinë e bedeneve pranë vendbanimit, ishin strehuar objektet kulte dhe nekropolet.



Figura 9. Rikonstruksioni i vendbanimeve të konfirmuara (koha e hekurit)

Me nevojën për zbulimin e mjeteve të reja, përpunimi i metaleve dhe transformimit të tyre, fillon procesi i shtresimit shoqëror dhe fillimi i shoqërisë klasore.

✍ Diskuto:

Në orë me arsimtarin tuaj bisedoni për mënyrën e jetës së njerëzve parahistorik.

Kultura dhe arti primitiv

Gjatë përdorimit të fjalës *primitiv*, nuk shënohet gjendja fillestare e njerëzimit, por mënyra e jetesës së një grupi të caktuar të njerëzve, që kanë mbetur të jetojnë në bashkësi, të ngjashme me ato të neolitit. Edhe sot, ekzistojnë bashkësi të caktuara primitive në pjesët tropikale të Afrikës dhe Amerikës. Këto bashkësi primitive kanë rregullim fisi, jetojnë në vendbanim fshatar dhe merren me bujqësi. Për shkak nivelit minimal të zhvillimit, konsiderohen për rojtat të identitetit të paraardhësve të tyre të largët, që lehtë mund të vërehet në trashëgiminë e pasur të traditave, folklorit dhe muzikës. Karakteristikë kryesore, është përdorimi i maskave të ndryshme që simbolizojnë demon ose identitet të ndryshuar.

✍ Detyrë:

Që më mirë t'i kuptosh bashkësitë primitive dhe kulturën dhe artin e tyre, nëpërmjet internetit hulumto për fisin australian Aborixhini.



Figura 10. Aborixhin australian

Kultura dhe arti parahistorik në hapësirat ballkanike dhe në Maqedoni

Kultura dhe arti parahistorik në hapësirat ballkanike

Përpjekjet e para për shprehje artistike vërehen nga koha e nisjeve të *paleolitit*. Prania e **kromanjonit**, për të cilin mund të thuhet se është *homo sapiens*, vërehet në pjesën veri-perëndimore të Gadishullit Ballkanik. Ai konsiderohet si mjaft inteligjent dhe raportet dhe e materialet e gjetura nga ky njeri trajtohen në art. Ka gjuajtur me shtizë, hark dhe shigjetë, ndërsa ka përdorur edhe shpatë guri e përpunuar nga njëra anë. Ka jetuar në kasolle të ndërtaur nga lëkura, e ka njohur gjilpërën për qepje të bëra nga koci, stolia nga kocka e elefantit, guaca, etj, ndërsa **përparim** i madh ishte zbulimi dhe përdorimi i zjarrit.

Arkitektura më e vjetër dhe skulptura monumentale e Ballkanit është nxjerrë në lagjen **Vorbull Lepenci**, jo shumë larg nga Gryka Gjerdap, Serbi, nga mileniumi VIII-të p.e.s. Janë gjetur një numër i madh i skulpturave me formë vezore dhe fytyrë njeriu, të paraqitura me sy gjerësisht të hapur dhe gojë të peshkut. Banorët e kësaj lagje konsiderohen autorë të ndjenjave më të sinqerta njerëzore të sëmundjes, mërzisë dhe pikëllimit, që ishte e vetme në atë periudhë në Evropë dhe botë, ndërsa për disa të tjerë kjo paraqitje ka të bëjë me ndonjë katastrofë që atyre u kishte ndodhur.

Mëso më shumë:

Vendbanimet e Vorbullit të Lepencit ishin ndërtaur me formë trapezi, të vendosura njëra pran tjetrës, ndërlidhja e të cilit kishte vlerë të caktuar magjike dhe rituale, ndërsa proporcionet ishin sekret dhe i kanë ditur vetëm disa njerëz ose një anëtar i bashkësisë.



Figura 11. Kromanjoni



Figura 12. Skulptura, Vorbull Lepenci

Mendo:

Në Internet hulumto për vendbanimet në Vorbullin e Lepencit në Serbi dhe gjatë orës, bisedoni për kulturën, artin, religjionin dhe mënyrën e jetesës së këtyre njerëzve parahistorik.

Kultura dhe arti parahistorik në Maqedoni

Kultura artistike dhe materiale e territorit të Maqedonisë shënon vazhdimësi nga kohërat më të vjetra të ekzistimit të njeriut. Nga zbulimet e shumta materiale ndahen: dy skulptura të jashtëzakonshme me figurë të gruas në figurë të **Nënës së Madhe**, mbrojtëse e shtëpisë dhe e zjarrit të shtëpisë, nënë që lind dhe e ripërtrin jetën në tokë, të zbuluara në lokalitete arkeologjike në **Tumba Magjari dhe Goverlevo** në Shkup dhe të dyja nga neoliti mesatar; statujë bronzi nga koha e vonshme e bronzit **Menada e Tetovës**, nga shekulli VI-të p.e.s. është zbuluar në varrezën e kështjellës në Tetovë, etj. Si pjesë përbërëse e kulturës materiale maqedonase është edhe **observatori megalian në Kokinë**, në zonën e fshatit Kokinë, Kumanovë.

Kujdes i veçantë meritojnë mjete kulti të varrosura të dedikuara për pushtues: maska e artë dhe doreza e artë me unazë të artë, të zbuluara në vitin 2001 në lokalitetin **Fortesa e Samoilit, Porta e Epërme** në Ohër, që datojnë nga fundi i shekullit VI-të dhe fillimin e shek. V-të p.e.s. që dëshmon për jetën e pasur religjioze të hapësirave maqedonase nga e kaluara e largët.

Periudha e parahistorisë në Maqedoni është shënuar me zbulime të shumta: armë, mjete kulti dhe religjioze, mjete të përpunuara nga qeramika, etj. Me fillimin e përpunimit lokal të stolive nga bakri dhe kallaji, futet termi **bronz maqedonas**, që dëshmon për zbulimet e shumta të gjerdaneve, vathëve, kopse, pulla, kollan, etj., në vendin tonë.

Shkruaj ese:

Përshkruaj një nga zbulimet e shumta nga periudha parahistorike e territorit të Maqedonisë.



Figura 13. Nëna e Madhe, Govërlevë




Figura 14. Menada, Tetovë



Figura 15. Maska e artë dhe doreza, Fortesa e Samoilit, Porta e Epërme, Ohër.

Hulumbo:

Cili ishte qëllimi i observatorit megalian Kokino dhe bëj krahasim me Stounhenxh në Angli?

3. Shekulli i vjetër

***Kultura dhe arti
mesopotamik dhe persian***

Kultura dhe arti egjiptian

***Kultura dhe arti në botën
minoj-miken***

Kultura dhe arti etrur

Kultura dhe arti romak

***Kultura dhe arti antik në
hapësirat ballkanike dhe në
Maqedoni***

Shekulli i vjetër

Rezyme

Periudha ndërmjet fundit të neolitit dhe shekullit të mesëm quhet **botë e vjetër**. Kultura dhe arti i botës së vjetër e përfshijnë rajonin përreth Mesdheut (Mesopotamia, Persia, Babiloni, Egjipti, qytetërimi minojmiken, Greqia e lashtë, Civilizimi etur, Roma e lashtë).

Arti në këtë periudhë ishte në shërbim të religjionit dhe karakterizohet me karakterin monumental, me ndërtimin e varrezave, piramidave, tempujve, skulpturave, shtyllave etj.

Këtë periudhë e shënojnë paraqitja e letrës dhe monumenteve më të vjetra të shkruara në letërsinë botërore, paraqitja e epikës dhe lirikës të ndërlidhura me instrumentet muzikore lirën, dramën (tragjedinë dhe komedinë), me fillimet e mendimit filozofik dhe paraqitja e emrave të filozofëve të lartë.

Terme kryesore:

Shekulli i vjetër, arti antik, faltore, piramida, letër, ep, lirika, lira, drama, filozofia.

Kultura dhe arti mesopotamik

Kultura e parë e madhe historike ka ndodh në luginat e lumenjve Tigër dhe Euftrat, pra prej aty edhe emri i saj Mesopotami, “vendi mes dy lumenjve”. Mesopotamin e shënojnë tre periudha me kulturat e veta, shënimet politike dhe hapësinore: **periudha sumeriane, akade dhe asiriane**.

Qytetet ishin përplot me pallate dhe faltore të perëndeshave të vjetra mesopotamike. Në muret e pallateve vërehet pikturimi i murit me shfaqje të figurave të njerëzve dhe të kafshëve. Në skulptura janë dhënë perëndeshat dhe qeveritarët dinjitoz në rroba të shtrenjta, me flokë të shpeshta, mjekër, etj. Qytetet ishin fortifikuar me mure ku ishin vendosur porta monumentale me dyer guri. Vepra e madhe në ndërtimin mesopotamik është **Porta e Qytetit në Babilon**, e dedikuar për perëndeshën Ishtar. Në qendrën e qytetit është gjetur tempulli në të cilin ishte shenjëtaria (e ashtuquajtur *zigurat*), ndërsa përreth ishin grupuar shtëpitë. Një nga ziguratet më të vjetra ishin ndërtuar në qytetin **Uruk**. Në Babilon, si një nga shtatë mrekullitë botërore, ishte ndërtuar observatori më i vjetër i ndërtuar në botë, **Kulla e Babilonit**.

Mëso më shumë:

Qytetet që i kanë ndërtuar pllakat nga argjili dhe druri, ndërsa ndonjëherë edhe nga guri. Hapësira qendrore e qytetit, paraqet kodër artificiale me formë piramide, në majën mesatare në të cilën është gjenur tempulli. Në tempull është kleri, ndërsa shtëpitë ishin grupuar përreth kësaj hapësire të botës. Deri te tempulli arrihej nëpër shkallët e vendosura të platformave të ndryshme të përpunuara nga druri dhe argjili, ndërsa has gurë dhe mozaik.



Figura 16. Hamurabi e mbanë Ligjin, Akad



Figura 17. Porta e Qytetit në Babilon



Figura 18. Vizatimi i Kullës së Babilonit

Shekulli i vjetër

Kultura Mesopotamike e shënon paraqitjen e letrës së parë pikturuese, të quajtur **letër pyke**, me të cilën kontratat tregtare janë shkruar në targa argjili. Për përmendoren e vjetër të shkruar në literaturën botërore konsiderohet **epi sumerian për Gilgamesh**, ndërsa me rëndësi të madhe është edhe epi i Babilonit për krijimin e botës **Enuma Elish**. Babilonët i kanë vendosur themelet e shkencave: mjekësia, matematika, astrologjia, ndërsa e kanë krijuar edhe kalendarin. Hyjneshat i kanë identifikuar me paraqitje natyrore: trupa qiellor, ujë, erë, dritë etj., për shembull, perëndia e qiellit *Anu*, perëndesha e ujërave *Tiamant* etj.

Detyrë:

Hulumto nëpërmjet internetit për paraqitjen dhe zhvillimin e shenjave të pykave dhe mënyrës së shkrimit të tyre dhe mundohu vet të shënosh ndonjë shenjë.

Kultura dhe arti persian

Arti persian quhet edhe **art ahemenid**, sipas dinastisë së Ahmenidive. Kjo paraqet sintezë për shumicën e arteve (mesopotamike, egjiptiane).

Me ndërtesa të vlefshme konsiderohen pallatet, nga të cilat ndahen **pallati i Darij në Persepolis**, e ndër-

Rikujtohu:

Me arsimtarin e gjuhës shqipe, përkujtohu për veprat e heronjve të Gilgameshit, nga epi i njëjtë.

Shkruaj ese:

Përshkruaj një nga ndërtesat në Babilon.



Figura 19. Targa prej argjili me letër pyke



Figura 20. Mbetjet e pallatit të Darij në Persepolis

tuar në platforma, me kështjella të shumta, salla dhe shtylla.

Nga **pallati i Darij në Suza** ndahet **Sfinga me Flatra**. Për vepër të pastër persiane konsiderohen si koka të kafshëve të vendosura në majën e shtyllave në pallate. Relievi i pallateve ka karakter ceremonial dhe në skena, gjithmonë është treguar në ndonjë ngjarje hyjnore dhe mitologjike, dhe se janë paraqitur pushtues me rroba të pasura me rrudha.

Persianët nuk kishin tempuj dhe viktimat e hyjneshave i kanë bartur në qiell të hapur. Ata kanë besuar në të mirën dhe të keqen, në dritë dhe në errësirë, *religjion*, themeluesi i të cilit ishin **Zaratustra**.




Figura 21. Sfinga me Flatra, Suza

Kultura dhe arti egjiptian

Arti egjiptian është paraqitur si rezultat i zhvillimit të civilizimit egjiptian, i lokalizuar në kahun e mesëm dhe të poshtëm të lumit Nil. Zona e përbashkët e shprehjes artistike në fushën e arkitekturës, skulpturës dhe pikturimi është *arti i vënë* në shërbimin e të vdekurve.

Arkitektura ishte me karakter sakral. Janë ndërtuar piramida – varreza madhështore të faraonëve, natyra hyjnore e të cilit është treguar sipas madhësisë së varrezave, p.sh. piramidat **Keops**, **Kefren** dhe **Mikeren**. Para piramidës në **Kefren**, si rojtar i nekropolës është vendosur **Sfinga**, me gjatësi prej 20 metra dhe lartësi prej 73 metra. Koka dhe fytyra janë kryer sipas



Figura 22. Piramidat në Giza, Sahara

Hulumto:

Në bibliotekë ose në Internet hulumto për piramidat në Egjipt dhe shkruaj ese sipas zgjidhjes tënde.

Mëso më shumë:

Piramidat janë ndërtuar nga tullat e gëlqeres, të larta 90 deri 140 metra të përbëra prej katër pjesëve: hyrje; korridor i errët që çon deri te tempulli i të vdekurve; një pjesë ku është mbajtur ceremonia e balsamimit dhe varrimit; dhe vetë piramida. Në anën e përparme janë zbukuruar me statue nga hyjneshat, ndërsa hyrja gjithmonë është në anën veriore. Piramidat asnjëherë nuk ishin ndërtuar afër lumenjve dhe në tokë pjellore.

Shekulli i vjetër

figurës së faraonit Kefren, derisa trupi është në formë të maces grabitqare. Me kalimin e kohës është braktisur ndërtimi i piramidave, ndërsa varrezat e faraonëve janë gropuar në luginën e Tebës, e ashtu quajtur **Lugina e faraonëve**.

Tempujt janë të shumtë me shtylla të shumta dhe hapësira të mëdha, në brenandinë e të cilave ishin vendosur skulpturat monumentale të faraonëve, p.sh. **tempulli i Amon Ra në Karnak**. Motivet nga **pikturimi** ishin marrë nga jeta e përditshme: figura me trupë gracioz, kope dhensh, gjah, peshkim, mbledhje e papirusit, etj.

✍ **Mbaj mend:**

Pikturimi egjiptian është themeluar në **kanune** (ligje) që rrallë janë braktisur: *gjatë përpunimit të relievit, figura e njeriut gjithmonë është kryer në profil, sytë dhe supet janë në anfas, ndërsa këmbët në hap.*

Nga perënditë, më të respektuar ishin perëndia supreme **Amon Ra** – perëndi e Diellit, **Oziris** – perëndi e të vdekurve, etj. Kanë besuar në përjetësinë e shpirtit dhe trupit. Brenga kryesore ishte jeta pas varrimit e të vdekurve, që vetëm me trupin e pa prishur kanë mundur edhe më tej të jetojnë në mbretërinë e perëndive. Kanë zhvilluar sistem të balancimit të të vdekurve, nga se i kanë mumifikuar, i kanë varrosur në varre me inventar të pasur: stolisje dhe skulptura nga floriri, piktura muri, etj.

Egjiptianët kanë lënë prurje të madhe në paraqitjen dhe zhvillimin e letrës dhe shkrimit. E kanë krijuar **letrën hieroglifë** përreth me 700 shenja dhe e kanë zbuluar shkathtësinë për përpunimin e papirusit. Vepra më e njohur është *Libri i të vdekurve*.



Figura 23. Piramida e Kefren me Sfigjë




Figura 24. Një pjesë e tempullit të Amon Ra, Karnak



Figura 25. Hieroglifë egjiptian

✍ **Hulumto:**

Cila ishte procedura e mumifikimit të trupit të njeriut të vdekur?

Arti dhe kultura e botës minjone-mikene

✍ Përkufizo:

Koha e bronzit në Krit është shënuar si:

- **Periudha minjone**, e quajtur sipas mbretit mit *Minos* dhe
- **Periudha mikene**, e quajtur sipas fortesës dhe pallatit në Mikenë.



Figura 26. Pallati në Knosos

Qytetërimi minon

Për zhvillimin e **kulturës dhe artit minjone** dëshmojnë mbetjet e shumta të materialeve.

Arkitektura është karakterizuar me pallate të mëdha, lloj i ndërtesave banesore të ndërtuara nga guri, për shembull, **Pallati në Knosos**, i njohur si **Labirinti Minutaur**.

Pikturimi i (freskat) i murit takohet te muret e pallateve me motive të luleve, botës detare, etj, e punuar me madhësi natyrore. Vepra e madhe e pikturimit minon është **Pariziane**, portret i gruas me flokë të zeza të gjata, veshje e thellë dhe buzë me ngjyrë të kuqe. Ishte përfaqësuar edhe **pikturimi i vazos; armëve dhe mjetet** që i kanë përpunuar nga metali dhe guri, ndër **stolinë** nga kocka e elefantit dhe floriri.

Ngjashëm me këtë, qytetërimet e lashta dhe minjonet kanë krijuar letër të tyre, e ashtuquajtur **Letër A lineare**, që akoma nuk është deshifruar.

Bazë e **religjionit** minon ishte **kulti i perëndeshës Nëna e frytit**, derisa shënime kryesore religjioze ishin demi, sëpata e dyfishtë **labris**, faltoret e hapura, shpellat kulte dhe drunjtë që dëshmojnë për jetën e tyre të pasur religjioze.




Figura 27. Pariziane, Knosos

✍ Mendo:

Cili ishte ndikimi i qytetërimin minon mbi qytetërimet tjera dhe cilat janë supozimet për rënien e tij?

✍ Diskuto:

Në orë me arsimtarin, rikujtohuni për mitin e minotaorin.

Qytetërimi miken

Miken ishte qyteti më i rregulluar dhe më i pasur me flori mes qyteteve të vjetra greke. Qyteti ishte vendosur në lartësi, i rrethuar me mure mbrojtëse të bëra nga tullat e parregullta prej guri me trashësi prej 3 deri 6 metra, sepse këto mure në legjende përmenden si vepër e Kiklopeve, janë quajtur **Mure Kiklope**. Hyrja në qytet ishte nëpër **Portën e madhe të luanëve**, në të cilën ishin vizatuar dy luan. Ndërtimi më monumental në formë rrote nga Mikena është **bashkësia Atreva** ose **varr**, që i ka përgatitur mbretit mit Atrej.

Banorët e Mikenës, me dallime të caktuara kanë ndërmarr shumë gjëra nga Mionët: pikturimi i murit, letra, pallatet, etj. Përkundër pikturimit (afresku) të murit që në masë të madhe ishte përfaqësuar nëpërmjet motiveve florale, skulptura shumë pak ishte përfaqësuar edhe atë nëpërmjet përpunimit të vazove nga floriri pa dekorim. Dallohen maskat e floririt me të cilat janë mbuluar fytyrat e mbretërve të vdekur.

Përkujtimoret e para të shkruara nga **Letra B lineare mikene** janë zbuluar në ishullin Krit dhe në Mikenë. Letra është emërtuar nga ana e arkeologut të njohur anglez **Ser Artur Evans**, i cili realisht i pari e ka zbuluar. Shenjat janë shkruar nga e majta në të djathtë, ndërsa të dhënat nga pllakat i zbulojnë të dhënat për hyjneshat në shenjëtore.

Në **religjion** vërehet koncepti i dyfishtë i respektimit të Qiellit me hyjneshat olimpike dhe Tokës me hyjneshat e tokës.



Figura 30. Letra B lineare



Figura 28. Porta e luanëve, Mikenë



Figura 29. Maska e floririt, Mikenë

✍ **Mendo:**

Në cilin vend tjetër janë zbuluar maskat e floririt dhe vallë kishin qëllimin e njëjtë?

✍ **Përgatit projekt: paraqitja dhe zhvillimi i letrës**

- Te Sumerët: letër pikturoese;
- Në Egjipt: letra hieroglif;
- Në Mesopotami: letër pyke;
- Te Fenicianët: letër me zë fonetik; dhe
- Te Mikenët: letra B lineare.

Troja

Për nismëtar në hulumtimet arkeologjike të në Trojë (në kodrën Hisarlik, Turqia e sotme, **Hajnrîh Shliman**). Qyteti Troja ishte qendër e madhe e pallateve tregtare, e ndërtuar me mure të trasha mbrojtëse të bëra nga tulla, ndërsa i banuar në "qytetin e poshtëm". Arsyet për shkatërrimin e Trojës, nuk janë të njohura, por ekzistojnë shumë supozime: tërmet, katastrofë, etj.



Figura 31. Rikonstruktimi i Trojës

Edhe pse pas shkatërrimit të Trojës ka filluar një periudhë e caktuar e rënies kulturore dhe qytetëruese, megjithatë në këtë periudhë janë krijuar dy vepra më të mëdha epike nga Homer, **Iliada** dhe **Odisea** (shekulli VIII-të p.e.s.) të shkruara me letër.




Figura 32. Homer

Diskuto:

Së bashku me arsimtarin e gjuhës shqipe, rikujtohuni dhe bisedoni për përmbajtjet e Iliadës dhe Odiseut.

Në këtë periudhë janë paraqitur **aojdi** (këngëtarë), të cilët me ndihmë të instrumentit lira kanë kënduar për veprat heroike dhe për qendrat e famshme mikene. **Lira** është instrumenti i vetëm me tel që dëshmon për qytetërimin minon dhe miken.

Mëso më shumë:

Lira përbëhej nga dy harqet anësore të përpunuara nga druri, koci i elefantit ose brirët e kafshëve. Telat ishin përpunuar prej dy zorrëve të deles ose fijeve. Gjatë shfaqjes muzikore, muzikantët lirën e mbajnë drejtë, e cila ishte e përforcuar me shiritin për kyçet e dorës së majtë. Muzikantët u bien telave me gishta ose pupël.



Figura 33. Goditës i lirës

Kultura dhe arti te Grekët e vjetër

Qendra më e madhe kulturore, arsimore dhe artistike në territorin e Greqisë së Vjetër ishte qyteti Athina, që e ka dhënë vulën e kulturës antike të Greqisë së Vjetër. Karakteristiket më të rëndësishme të kulturës antike të Greqisë së vjetër ishte **antropomorfizmi** (paraqitja e hyjnive si njerëz) dhe animi kah nevojat dhe zakonet e popullit të lirë, *domosi*, pra prej këtu edhe veprimtaria kulturore dhe artistike ishte krijuar në atë drejtim.

Arkitektura e Greqisë së vjetër është ngushtë e lidhur me mitologjinë dhe shprehjen e vet më të madhe artistike e ka dhënë në arkitekturën e **tempujve**, ndërtimet publike janë ndërtuar nga guri dhe mermeri. Kjo ngase tempulli ishte dedikuar për hyjnesha, populli nuk ka qasje në brendësinë e tij. Prandaj, tërë vëmendja artistike ishte drejtuar nga rregullimi i pjesës së jashtme të tempullit, proporcionet dhe dekorimet e tij. Synimi drejtë proporcioneve ideale me ndërtim të shtyllave dhe dërrasave, vërehet në tempullin **Partenon** të **Akropolit** në Athinë, i ngritur në nder të hyjneshës Atena. Si element i lidhur në çdo tempull janë shtyllat të zhvilluara në tre stile: **stili dorik, jon dhe korinth**.

Teatrot, gjithashtu kanë paraqitur ndërtesa publike në të cilat janë luajtur tragjeditë dhe komeditë më të mëdha. Ato ishin ndërtuar në të hapur, zakonisht në shpateve tokë të lakuar. Janë karakterizuar me formë të vetme dhe funksionale dhe akustikë të jashtëzakonshme. Shembull më reprezentativ është **teatri në Delfi**.

Mbaj mend:

Grekët e Vjetër i kanë krijuar **kanunet**, të ashtuquajtura *formularët ideal*, pa dallim nëse është bërë fjalë për skulpturën e trupit të njeriut ose për ndonjë ndërtim arkitektonik. Krijimi i proporcionit ideal në të cilën asnjë madhësi nuk ka dominuar mbi tjetrën e cila krijon harmoni të plotë, e ka sjell artin e Greqisë së Vjetër deri te idealja.



Figura 34. Akropol, Athinë



Figura 35. Teatri në Delfi

Skulpturat ishin përpunuar në nder të hyjneshave dhe ishin përplot me paraqitje mitologjike. Skulptura e figurës perfekte mashkullore **kuros**, konsiderohet se e ka paraqitur figurën e perëndisë së bukurisë Apolon. Skulptura me figurën e përkryer femërore **kora**, paraqet figurë të vajzës së re që mban fruta në dorë ose dhuratë në dorë.

✍ **Mëso më shumë:**

Grekët e Vjetër janë munduar që skulpturat t'i paraqesin ideale dhe pa mangësi. Megjithatë, ishte mjaft e vështirë të bëhet figurë e përkryer e njeriut nga druri, bronzi ose mermeri, përderisa para vete nuk kishin figurë të përkryer të njeriut. Prandaj, për model të përkryer të gjallë sipas të cilit do të bëhen skulpturat e hyjneshave, i kanë përcaktuar djemtë e rinj të moshës 15-16 vjeçare me trup të njeriut të rritur dhe vajzat e bukura të reja.

Nga pikturimi ka mbetur shumë pak, për dallim nga **pikturimi i vazove**, që është ruajtur në sasi të mëdha. Vazot janë përpunuar nga argjila më e mirë, e përpunuar në **rrotën e poçarit** në të cilën menjëherë pasi që është fituar forma, janë pjekur dhe në fund janë ngjyrosur dhe dekoruar me figura të ndryshme. Vazot paraqesin një nga veprat më të bukura artistike nga arti i vjetër grek.

Si pjesë përbërëse e jetës së Grekëve të Vjetër ishin **mitologjia dhe religjioni**, të bashkuara në besim në hyjneshat olimprike, të imagjinuara me figurë të njerëzve. Hyjnive u kanë ndërtuar tempujt të mëdhenj, në nder të tyre kanë festuar ditë të caktuara në vit të cilëve u kanë dhënë viktimë dhe dhurata të ndryshme, kanë marrë pjesë në mistere (p.sh. *Misteret Elevesine*) dhe kanë organizuar festime dhe gara të ndryshme. Në nder të perëndisë supreme Zeus, ishin organizuar **Lojërat e para Olimprike**.



Figura 36. Kora



Figura 37. Vazo e kuqe-figurative



Figura 38. Hedhës i diskut

✍ **Mendo:**

Kur ishin mbajtur Lojërat e para Olimprike dhe me cilat sporte janë garuar pjesëmarrësit?

Shekulli i vjetër

Konsiderohet se Grekët e Vjetër e kanë ndërmarrë letrën e Fenikasve dhe e kanë ruajtur formën e shkronjave, vendin e tyre dhe renditjen në letër, me çka e kanë krijuar shkrimin **alfabet**. Risinë që e kanë futur është aftësia e shenjave sipas tingullit. Ato e kanë ndryshuar edhe drejtimin e shkrimit nga e majta në të djathtë, duke e konsideruar "me fat". Krijimi i shkrimit të alfabetit është hapi më i madh në zhvillimin e njerëzimit.

Në territorin e Greqisë së Vjetër janë paraqitur dhe fillimet e mendimit filozofik perëndimor, si *shkencë për dituri*. Nga ajo periudhë e kanë prejardhjen emrat e lartë, që përveç në filozofi kanë kontribuar në zhvillimin e shkencave tjera: matematikë, astronomi, mjekësi, botanikë, histori, gjeografi, etj. Nga lëmia e filozofisë veçohen emrat e **Sokratit, Platonit dhe Aristotelit**; nga matematika **Pitagora**, nga mjekësia **Hipokrati**, nga historia **Herodoti, Plutarhi**, nga gjeografia e **Strabonit**, etj. Filozofët e njohur kanë filluar të hapin akademi në të cilat është mësuar filozofia, p.sh. *Akademia e Platonit*.

Literatura e shënon zhvillimin e epit dhe lirikës. Gruaja më e vlefshme e të gjitha kohërave që ka lënë gjurmë më të thella në këndimin lirik ishte **Sapfo**. Me kalimin e kohës, janë shfaqur lloje të shumta letrare: dramë, komedi dhe tragjedi. Tragjeditë dhe komeditë janë zhvilluar si lloj e garave në teatër, zakonisht gjatë kohës së festave: *Dionis dhe Lenai të mëdhenj dhe të vegjël*. Nga autorët e tragjedive dallohen emrat e **Sofokleut, Euripidit**, etj., ndërsa nga autorët e komedive dallohet **Aristofani**. Gjatë kohës së shfaqjes së paraqitjeve dramatike, aktorët kanë mbajtur maska dhe ishin veshur në kostume dhe këpucë drame.

Shkruaj ese:

Jeta dhe vepra e njërit nga filozofët dhe letrarët e vjetër grek.



Figura 39. Akademia e Platonit, mozaik nga Pompea

Mëso më shumë:

Maskat ishin përpunuar nga ngjyra për vetulla, të bërë nga pëlhura, ndërsa në kohën më të lashtë nga korja e drurit. Në anën e përparme kishin një hapje të gjerë për gojë dhe dy hapje të vogla për sy. Aktorët e tragjedive kanë veshur mbulesa të gjata festive, deri te kyçet e këmbës. Që të jetë aktori më i madh, i kanë përforcuar jastëk, një në gjoks dhe një në stomak. Këpucët që i kanë mbathur gjatë kohës së tragjedive ishin mjaftë të larta dhe ishin përpunuar me shollë të trashë prej druri.



Figura 40. Maska tragjike-komike, mozaik

Kultura dhe arti helen

Zhvillimi i helenizmit në lëminë e kulturës shpirtërore dhe materiale, si dhe krijimtaria artistike ka filluar pas vdekjes së Lekës së Madh. Periudha helene me shtetin antik maqedonas, që ka poseduar shpirt të fuqishëm kozmopolit, ka sjell që Ballkani të vërshohet nga kultet orientale. Ai është më i famshëm sipas opusit krijues, por edhe më i varfëri me vepra artistike. Karakteristika e artit helen është paraqitja e portreteve të personazheve realr, për shembull, *portreti i Sofokle*. Vepra më e mirë skulpturore nga helenizmi është figura e **Nike nga Samotraki**, pa kokë dhe duar, por me flatra engjëjlore që paralajmërojnë që çdo çast do të fluturojnë.

Kultura dhe arti etrus

Për prejardhjen, historinë dhe kulturën e Etrurëve pak është e njohur. Shembujt e vlefshëm të kulturës etrurë vërehen në **arkitekturën e varrezave**. Të ndjerët i kanë varros në *varreza të rrumbullakëta*, të ashtuquajtura **tumbë**, që ishin të pasur me shtojca dhe dekorime të pikturuara që është përplot me skena të gjahut dhe peshkimit, ahengje, violinistë dhe kërcyes, me qëllim që të pasurohet jeta sociale e të ndjerit. Skulpturat janë përpunuar nga argjili, guri dhe bronzi. Një vepër e madhe e skulpturës etrurë është **statuja e Apolonit nga Vej**, ndërsa nga skulptori i Vej është ruajtur edhe **statuja e bronzit e ujkonjës**, që sipas mitologjisë romake i ka ushqyer Romulin dhe Remin. Kanë besuar se bota, që e ka kontrolluar hyjninë, është manifestuar në çdo pjesë të natyrës dhe në mjetet e krijuara nga njerëzit. Ka dhënë kontribut më të madh në krijimin e **shkrimit të alfabetit**, nëpërmjet huazimit të *shkrimit të alfabetit* në shekullin VII-të p.e.s.



Figura 41. Nike nga Samotraki

Diskuto:

Çka paraqet Ulëkonja për Romën dhe rikujtohet në legjendën e krijimit të qytetit të Romës.



Figura 42. Tumba Çerveter



Figura 43. Ulkonja, simboli i Romës

Kultura dhe arti Romak

Civilizimi romak e mban emrin e qytetit të Romës, të lokalizuar në zonën Latium, e banuar me fisin italian Latini. Shpirti i popullit romak më shumë ka kontribuar në sferën e politikës, organizimit ushtarak dhe shtetëror, ndërsa më pak në krijimtarinë artistike origjinale. Originalitetin e vet romakët e kanë treguar në arkitekturë dhe vizatimin e portreteve artistike.

Arkitektura ishte përfaqësuar në Romë, të gjitha ndërtesat ishin monumentale dhe me karakter publik dhe të shenjtë. Qytetet kanë poseduar: *forum*-shesh publik në qendrën e qytetit ku është zhvilluar jeta publike, për shembull, **forumi Romak**, pastaj bazilika, tregjet, bibliotekat, teatrot, ndërtesat për jetesë, banjë publike, etj. Me ujësjellës kanë sjellë ujë për pirje në qytete. Janë ndërtuar rrugë dhe ura të dedikuara për qëllime ushtarake dhe nevoja të qytetarëve, ndërsa për shënimin e fitoreve ushtarake, janë ndërtuar edhe portat triumfale. Vepra e madhe e arkitekturës romake janë **Panteon**, tempulli i të gjitha hyjnive i ngritur në Fushën e Marsit në Romë dhe **Koloseum**, amfiteatri më i madh në Romë.



Figura 44. Rikonstruksioni i forumit Romak



Figura 45. Koloseumi, Romë

Shkruaj ese:

Përshkruaj një nga ndërtimet më të vlefshme në Romë.

Mëso më shumë:

Koloseumi paraqet arenë të madhe të hapur, të gjatë 188 metër, ku kanë mundur të hyjnë 50.000 vizitues. Është ndërtuar me fasadë në tre kate, por e cila ka shërbyer vetëm si efekt vizual. Koloseumi ofron më shumë mundësi: sipas nevojës është ndriçuar gjatë kohës së shfaqjeve të natës, mund të mbulohet me strehimore të madhe prej pëlhure, (arena), ka mundur të mbushet edhe me ujë për të treguar betejat detare me anije më të vogla. Në të janë mbajtur gara, mundje gladiatorë dhe mundje të robërve me kafshë të egra. Sot, Koloseumi paraqet një nga trashëgimitë kulturore më të mëdha botërore.

Shekulli i vjetër

Originaliteti i Romës vërehet në portrete të **skulpturave**, në të cilat njeriu është shfaqur realisht. **Pikturimi** si teknikë në Romë është shumë rrallë i përfaqësuar dhe kryesisht paraqitet në **mozaik**. Në Romë, veçanërisht theksohen mozaikët e dyshemesë, të përmbajtura nga gurët e imtë me ngjyra të mrekulueshme. Një nga mozaikët e njohur është zbuluar në Pompe, në **Shtëpinë e Faunit**, sot në Neapol, ku në dysheme ka mozaik në të cilin janë shfaqur në **Dariu dhe Leka i Madh** në betejën në **Is**.

Pikturimi i murit në Romë është i rrallë, përderisa pikturimi i mureve në qytetin Pompe është tërësisht i ruajtur. Pompea është gjetur në afërsi të malit Vezuv. Falë erupsionit nga vullkani Vezuv, qyteti plotë 18-të shekuj ishte rrënuar, si i konservuar. Qyteti është zbuluar në shekullin XX-të. Që atëherë, pikturimi romak quhet **pikturimi i Pompesë**. Kompozicioni më i njohur i pikturuar në muret e një salle festive në Pompe është **Bahantki**, që paraqet vepër të madhe të pikturimit romak.

Religjioni i Romakëve ishin ngushtë të lidhur me mitologjinë. Më të respektuar ishin **Jupiteri**, të cilin e kanë konsideruar për perëndi kryesore dhe **Marsi**, perëndi e luftës, kurse nga perënditë dallohet, **Vesta** mbrojtëse e shtëpisë dhe familjes (votrës së shtëpisë). Me kalimin e kohës, Romakët, perënditë e veta më të rëndësishme, sipas karakteristikave i kanë barazuar me ato të Greqisë së Vjetër dhe u kanë dhënë figurë njeriu.

Nga lëmia e **shkencës**, Romakët kanë dhënë prurje në zhvillimin e retorikës dhe hapjes së shkollave retorike. Nga lëmia e retorikës veçohet emri i **Kikeron**; nga filozofia emrat e **Seneka dhe Lukreci Kar**, i cili njëkohësisht ishte edhe poet; nga historia **Takit dhe Tit Livit**, etj.

Zhvillimi i letërsisë ka sjell deri te paraqitja e veprave të shumta të shkruara dhe atë: poezia epe dhe lirike, komedi, tragjedi, elegji, etj. Veçohen epet **Aneida dhe Virgjili** dhe **Metamorfoza e Ovidit**, ndërsa shkrimtari më i famshëm i komedive nga Roma ishte **Plauti**.



Figura 46. Beteja Is, mozaik, Neapol



Figura 47. Bahantki, Pompe

Analizo:

Në cilat perëndi kanë besuar Romakët, dhe sipas karakteristikave të tyre bëni krahasim mes perëndive romake dhe të Greqisë së Vjetër.

Mendo:

Nën ndikimin e kujt janë zhvilluar shkenca dhe llojet letrare te Romakët dhe cilat ishin karakteristikat e tyre?

Diskuto:

Arritjet e Romakëve në art, shkencë dhe literaturë.

Kultura dhe arti antik të hapësirave ballkanike në Maqedoni

Kultura dhe arti antik i hapësirave ballkanike në masë të madhe janë zhvilluar në kohën e sundimit të Perandorisë Romake, periudha kur janë ndërtuar një numër i madh i rrugëve, ujësjellësve, pallateve, kullave, amfiteatrove, etj.

Për nga bollëku i tij veçohet **pallati Dioklencial** në Split, i ndërtuar me gur nga ishulli Braç. Si amfiteatër monumental i hapësirave ballkanike është **amfiteatri** në *Pula*. Nga periudha romake në Shqipëri, vlerë të veçantë kanë rrugët të cilat në atë periudhë ishin mjaft shkëmbyese, për shembull. **rruga Durrës-Konstantinopjë**.

Edhe në Maqedoni gjatë kohës së periudhës romake vërehet zhvillim i shpejtë urbanistik. Nga kjo periudhë veçohen trashëgimia e qyteteve antike, **Skupi, Stobi, Heraklea Linkestide, Lihnida**, etj., ku janë gjetur teatro të rënuara, banjo të qytetit, bazilikave, tregut, etj. Me vlerë të madhe është objekti më i ruajtur dhe më i rëndësishëm ushtarak nga periudha antike, **Fortesa** e lokalitetit *Engelana te Shën Erazmo* në afërsi të qytetit Lihid, si dhe rrugët: **Via Egnatia, Via Aksia** dhe e **ashtuquajtura rruga Diagonale**.

Diskuto:

Me arsimtarin e gjuhës rikujtohuni në udhëtimin e Ajnej-it.



Figura 48. Pallati Dioklencial, Split



Figura 49. Amfiteatër, Pula



Figura 50. Heraklea, Manastir

The background of the slide is a photograph of St. Basil's Cathedral in Moscow, Russia, during sunset. The sky is a vibrant mix of orange, pink, and purple. The cathedral's colorful, onion-shaped domes and intricate facade are silhouetted against the bright sky. The text is overlaid on the image in a yellow, sans-serif font.

4. Shekulli i mesëm

***Kultura dhe arti i hershëm
krishter***

Kultura dhe arti Bizantin

***Kultura dhe arti i shekullit të
mesëm në Rusi***

- Romanika

- Gotika

- Trashëgimia

kulturore-historike islamike

Shekulli i mesëm

Rezyme

Është shumë e vështirë të përcaktohet kufiri kohor ndërmjet kulturës dhe artit antik dhe asaj të shekullit të mesëm, sepse kjo kulturë disa shekuj ka ekzistuar në territorin e Mbretërisë Romake.

Kultura dhe arti i shekullit të mesëm, fillimet e veta i shënon në krishterimin e hershëm, që karakterizohet pas artit të *katakombeve*. Pastaj vijon rënia e Mbretërisë Romake në Lindje dhe Perëndim, që ka sjell deri te ndarja e kulturës dhe artit në **periudhën bizantine** në Lindje dhe **romanikë dhe gotikë** në Mbretërinë e Romës Përendimore.

Edhe arti bizantin edhe arti romak dhe gotikë janë me vepra të shumta artistike dhe paraqesin një pjesë të trashëgimisë botërore kulturore-historike.

Arti i shekullit të mesëm në Rusi paraqitet në formën e vetë origjinale, si dhe arti islam, që gjithashtu ka lënë gjurmë të madhe në artin e shekullit të mesëm. Veprimtaria e tyre artistike paraqet pjesë përbërëse të trashëgimisë botërore kulturore-historike.

Terme kryesore:

Edikti Milanez, bazilika, periudha bizantine, periudha romane, gotika, katakombi, mauzole, kaligrafi, baptisterium, zoomorfe dhe simbole antropomorfo.

Kultura dhe arti i hershëm krishterë

Si arsye për dobësimin e ushtrisë dhe fuqisë ekonomike të Mbretërisë Romake përmendet paraqitja e religjionit krishterë në shekullin e I-rë p.e.s., si **religjion monoteist** (besim në një Zot), që Romakët e konsiderojnë për erez, dhe e kanë ndaluar dhe e kanë ndjekur. Dy shekuj më vonë, nga ana e Konstantinit të Madh në vitin 313-të ishte sjell **edikti Milanez**, me të cilin krishterimi ishte shpallur për religjionin zyrtar shtetëror.

Diskuto:

Arsyet për paraqitjen dhe zhvillimin e krishterimit.

Me paraqitjen e krishterëve të parë në shekullin e I-rë është zhvilluar arti në katakombe. **Katakombet** janë varreza krishtere nëntokësore të ndërlidhura me tejkalimet nëntokësore (galeri), të lokalizuara jashtë mureve të qytetit. Më të mëdha dhe më të shumta janë katakombet romake, për shembull, Katakombet e **Shën Kalikst në Romë**, galeri të ngushta me ndërprerës prej 80 centimetra deri një metër. Në tavanet dhe muret e katakombeve janë zbuluar freskët, shkrimet, dhe vizatimet e shumta, etj., me shënime të caktuara (simbole). Në katakombe nga pikturimi i hershëm krishterë janë ruajtur vetëm fragmente. Me shpalljen e krishterimit si religjion zyrtar në kufijtë e Perandorisë Romake, janë braktisur katakombet dhe ka filluar periudha e predikimit publik të mësimin për krishterizëm dhe ndërtimin e përsheptuar të kishave krishtere, kryqeve dhe kishave të varrezave.

Mbaj mend:

Me ndarjen e Mbretërisë Romake:

- Në **Lindje** është themeluar kryeqyteti i ri i Konstantinopolit, Stambolli i sotëm. Në Lindje **kultura dhe arti krishterë** quhet **kultura dhe arti bizantin**, ndërsa periudha në të cilën ishin përfaqësuar quhet **periudha bizantine**, dhe
- Në **Perëndim** me Romën si kryeqytet, në fillim arti konsiderohet si barbar, ndërsa pastaj është zhvilluar në **romanikë** dhe **gotikë**.



Figura 51. Brendësia e katakombeve

Hulumto:

Hulumto nëpërmjet internetit për katakombet në Romë dhe shkruaj ese për jetën dhe artin në katakombe në kohën e hershme të krishterimit.

Krishterët, ceremonitë e veta i kanë përfunduar në tempujt krishtere të quajtura **bazilikë**. Veçohen bazilikat **Shën Petër dhe bazilika e Konstantinit** në Romë, të ndërtuara gjatë kohës së sundimit të Konstantinit të Madh. Janë ndërtuar dhe **pagëzimore** (baptisterium), në të cilat është krijuar akti krishterë i pagëzimit. Më e njohur është **pagëzimorja Laterne në Romë**, ndërsa janë paraqitur edhe **kishat e varrezave**, të ndërtuara mbi varrezat e të torturuarve të krishterë.

Përmendorja më e madhe e artit të krishterimit të hershëm nga shekulli i III është bazilika e **Shën Mëri Maxhore** në Romë, që është përplot me pikturimin dhe mozaik monumental me simbole krishtere.

Pastrimi krishterë për ikonografi është **literatura**, e përbërë nga **Bibla, Dhiata e Re dhe Dhiata e Vjetër dhe tekstet liturgjike**. Në këtë periudhë është zhvilluar dhe **vizatimi i miniaturave** që ka shërbyer për dekorimin e librave të shkruara, të shkruara me shkronja floriri dhe argjendi të pergamentit purpur.

Krishterimi në Maqedoni manifestohet shumë herët dhe atë nëpërmjet përhapjes së mesimit të krishterimit nga ana e **apostol Pavle dhe Shën Erazmo Antiohiski**, i cili për një kohë të shkurtë në qytetin Lihnid ka pagëzuar 20.000 persona. Me pranimin e krishterimit kanë filluar të ndërtohen edhe tempujt krishterë, bazilika (kisha). Një nga kishat më të vjetra në Maqedoni ishte ndërtuar në gjysmën e parë të shekullit IV në **Stobi**. Ajo më vonë ishte rindërtuar dhe përsëri në vendin e njëjtë ishte ndërtuar **bazilika Episkopike** me pagëzimore (baptisterium), me dekorim me **mozaik**, që ishte përplot me motive të ikonografisë krishtere.

Mendo:

Në çfarë forme janë ndërtuar kishat krishtere dhe si ishte zhvillimi i tyre? Bëj krahasim të kishave krishtere me tempujt antik.



Figura 52. Brendësia e bazilikës Shën Mëri Maxhore, Romë



Figura 53. Baptisterium, bazilika episkopike, Stobi

Shkruaj ese:

Përhapja e qendrave krishtere dhe të krishterimit të hershëm në Maqedoni.

Kultura dhe arti bizantin

Qendra e artit bizantin ishte kryeqyteti Konstantinopol, ku nën ndikim të mbretit dhe kishës janë krijuar principet estetike të kulturës dhe artit bizantin. Konstantinopoli ishte rregulluar me kisha, pallate mbretërore, amfiteatra, banja publike, tregje të mbuluara, ujësjellës, etj, ndërsa nga jashtë ishte ndërtuar me mure të fuqishme. Ka paraqitur qendër të prodhimit dhe tregtisë së armëve, stolive, pëlhurave, etj.

Periudha e parë e frytshme e artit bizantin, e ashtu quajtur koha e artë gjatë kohës së sundimit të mbretit bizantin **Justinian**, i lindur në *Taorisium*, *Taori* i sotshëm, i Shkupit, që në vitin 535 e ka ndërtuar qytetin dhe qendrën **arkiepiskopike Justinian Prima**. Gjatë kohës së sundimit të tij është ndërtuar një ndër kishat më monumentale **Shën Sofje** në *Konstantinopol*, Stambollin e sotshëm., emri i të cilit shënon *dituri të shenjtë*. Me rënien e Konstantinopolit nën qeverisjen turke, kisha në shekullin XV-të është shndërruar në xhami, por përveç shtimit të katër minareve, arkitektura e saj nuk është ndryshuar. Kishat bizantine nga *koha e dytë e artë* janë ndërtuar në periudhën e shekullit IX-të deri në shekullin XI-të. Kisha më e madhe është **Shën Marko** në *Venedik*, ndërsa sipas vlerës së tyre veçohen edhe manastiret në **Malin e Shenjtë dhe Meteori** në territorin e Greqisë.

Nga përfaqësuesit e **letërsisë teologjike** përmendet emri i kryepeshkopit të bizantisë së hershme antiokij **Jovan Zlatoust**. Në kohën e Justinian ishte formuar universiteti i *Carigradit* dhe *veprat historike*. Veçohet **Prokopij Kesariski** i cili ka shkruar më shumë vepra historike.

Mbaj mend:

Me ndarjen e Mbretërisë Romake, *arti i krishterë në Mbretërinë Lindore Romake* është zhvilluar në **artin bizantin**, ndërsa periudha në të cilën ishte përfaqësuar arti bizantin quhet **periudha bizantine**.



Figura 54. Shën Sofje, Stamboll



Figura 55. Shën Marko, Venediku

Diskuto:

Bizanti në kohën e Justinianit.

Në periudhën bizantine është anashkaluar mendimi filozofik për llogari të asaj teologjikes, por ka arritur deri në zhvillim të retorikës. Në këtë periudhë është kompozuar edhe **muzika bizantine**, që paraqet zhanër më të vjetër të traditës muzikore evropiane. Muzika bizantine përfshin traditë të pasur të muzikës instrumentale dhe të vallëzimit oborrtar, prandaj konsiderohet edhe si muzikë ceremoniale edhe festive, ndërsa veçohet edhe muzika (kishtare) shpirtërore, e ashtuquajtur **këndim liturgjik**.

Kultura dhe arti bizantin në Maqedoni

Me rënien e Konstantinopolit në qeverisjen e perandorisë otomane në shekullin XV-të, nga ana tjetër ka sjell deri te zhvillimi më intensiv të artit në Maqedoni, Serbi dhe Rusi. Periudha bizantine paraqet një ndër periudhat më të frytshme të shpirtit, zhvillimit kulturor dhe artistik në Maqedoni. Këtë periudhë e shënojnë një numër i madh i ndërtesave sakrale krishtere, kisha dhe manastire, që karakterizohen me **jetë-përshkrim fresk të lartë (pikturimi i murit)**.

Veçanërisht e rëndësishme është pikturimi i freskëve dhe mozaikëve, për shembull, freskët nga **kisha Shën Sofje në Ohër**. Sipas pikturimit të murit me famë është edhe manastiri **Shën Pantelejmon në Nerez**, në afërsi të Shkupit, i cili llogaritet në majën e realizimeve më të mira të artit bizantin. Nga manastiri veçohen freska **Vajtim**, në të cilin arti në Nerez në një farë mënyre realiste e ka shprehur dhimbjen e shprehjes së personit të Shën Mërisë gjatë vajtimit të djalit, që dukej e pamundur për artin bizantin.

Mbaj mend:

Nën ndikim të Lindjes, arti bizantin më shumë ishte pikturim.

Pikturimi ishte dekorimi kryesor i arkitekturës bizantine, vëmendja e të cilit ishte drejtuar drejtëdekorimit të hapësirës së brendshme.

Hulumto:

Me arsimtarin tuaj shkoni në kishën Shën Pantelejmon në Nerez, në afërsi të Shkupit, bisedoni për freskët që do t'i shihni aty dhe shkruani ese mbi atë që do t'u bëjë përshtypje.



Figura 56. Vajtim, Shën Pantelejmon, Nerez, Shkup

Diskuto:

Nga paraqitja dhe zhvillimi i shkrimit sloven, deri te krijimi i shkollës letrare të Ohrit.

Shekulli i mesëm

Përkrah jetëpërshkrimit të freskut, si pjesë përbërëse e pasurisë kulturore-historike maqedonase veçohen: *gdhendja sakrale, grafika, shkrimet iluminuese dhe ikonë-përshkrimi.*

Janë paraqitur edhe misionarët e parë, vëllezërit **Shën Kirili dhe Metodi**, që në vitin 855 e kanë krijuar alfabetin sllloven të quajtur **glagollik**. Kah fundi i shekullit IX-të është krijuar alfabeti, që për nder të **Shën Kirilit** është emërtuar **kirilic**. Veprimtarinë e tyre e kanë zgjeruar nxënësit dhe trashëguesit e tyre, shenjëtorët **Klimenti dhe Naumi i Ohrit**.

Nga shekulli i IX-të, në brigjet e Liqenit të Ohrit dhe Prespës, kanë filluar të paraqiten qendrat e para të shkrimit sllloven. Në manastire janë formuar *shkolla*, ku priftërinjtë e kanë mësuar shkrimin sllloven dhe i kanë përkthyer librat kishtarë, me çka ishin vendosur *themelet e shkrimit dhe kulturës slllovene*.

Vlerë të madhe për përhapjen e shkrimit sllloven ka **Shën Klimenti**. Ai në Ohër e ka ndërtuar **manastirin Shën Pantelejmon**, që pastaj është bërë qendër për arsim dhe nga aty ka vepruar si mësues. **Shën Klimenti** njëkohësisht i ka vendosur themelet e **shkollës letrare të Ohrit**, që gradualisht është rritur në **universitetin e parë sllloven**.

Për themeluesin e **Arkipeshkopisë së Ohrit** konsiderohet **Shën Klimenti i Ohrit**, i cili i ka vënë themelet e **Kishës ortodokse maqedonase**.



Figura 57. Shën Kirili dhe Metodi, freskë, Shën Jovan Bigorski, Dibër

✍ Diskuto:

Në orë me arsimtarin tuaj bisedoni për fillimet e Kishës ortodokse maqedonase dhe Arkipeshkopisë së Ohrit.

Çfarë domethënie kishte kisha për përhapjen e kulturës dhe shkrimit në Maqedoni?



Figura 58. Shën Kliment dhe Pantelejmon, Pllaoshnik, Ohër

✍ Shkruaj ese:

Kisha Shën Kliment dhe Pantelejmon, Pllaoshnik, Ohër.

Kultura dhe arti i shekullit të mesëm në Rusi

Krishterimi në Rusi ka filluar me pranimin e religjionit të krishterë nga ana e princit **Vladimir i I** në vitin 988-të. Së bashku me krishterimin, në Rusi janë përhapur edhe kultura edhe arti bizantin, pra prej këtu kanë filluar të ndërtohen kisha, të dekoruara me freske dhe ikona.




Figura 59. Shën Sofje, Kiev

Arkitektura në Rusi në shekullin e mesëm ishte lokalizuar në dy seli: në Kiev në jug dhe në Novgorod të madh në veri dhe shënohet me karakter kishtar dhe ndikim bizantin. Nga kjo periudhë theksohet kisha **Shën Sofje** në Kiev dhe kisha e njëjtë në *Novgorod të Madh*, me shenja tipike ruse.

Përreth shekullin XV-të, Moskë është rritur në qendër kulturore politike dhe format e huazuara nga arti i ka marrë në mënyrë të vetë të shprehjes, me çka ka krijuar **stil** të vërtetë **rus**. Stili tipik rus vërehet në një nga kishat më të mëdha dhe më monumentale të shekullit të mesëm në Rusi, kisha e **Shën Valisje Bllazheni** në Moskë.



Figura 60. Shën Vasilie Bllazheni, Moskë

Në periudhën e shekullit të mesëm në Moskë ishte ndërtuar në **Kremlin**, që paraqet kompleks të vërtetuar, pas mureve të të cilit gjenden pallatet e mbretit, kisha dhe ndërtesat e institucioneve shtetërore.

Letërsia e vjetër ruse ishte nën ndikim të kulturës bizantike, por edhe i shkrimit slloven, që qartë vërehet nëpërmjet përdorimit të shkrimit cirilik.

Mendo:

Përshkruaj stilin rus në arkitekturë dhe bëj krahasim me kishat e tjera krishtere nga periodha bizantine.

Kultura dhe arti i shekulli të mesëm në Evropën Perëndimore

Me ndarjen e Mbretërisë Romake, në Mbretërinë Romake Perëndimore me Romën si kryeqytet, në fillim kultura dhe arti janë konsideruar për barbare, ndërsa pastaj janë zhvilluar në **romanizëm** dhe **gotikë**.

Kultura dhe arti i shekullit të mesëm në Rusi

Romanizmi është periudha stilistike e parë dhe e vetme që e ka përfshirë tërë Evropën Perëndimore. Zona qendrore zhvilluese e romanizmit ishte Franca, Gjermania dhe Italia, derisa arti në Angli është zhvilluar si variant i veçantë i romanizmit, i quajtur *stil normanik*.

Stili romak në kulturën dhe artin në Evropën Perëndimore ishte ndërlidhur me formimin e shoqërisë së hershme feudale, si dhe me përforsimin e kishës krishtere dhe të radhëve të murgjve. Fuqia kryesore intelektuale ishte kisha, ndikimi i të cilës ka kulmuar me luftërat kryqëtare.

Arkitektura ishte orientuar nga ndërtimet sakrale. Shprehja më e lartë e artit romak janë **katedralet** (*kishat e qytetit*) dhe **opatit** (*kishat e manastireve*), të ndërtuara në formë të shkronjës latine "T", pra prej këtu baza e tyre quhet edhe **kryq latin**. Kishat janë ndërtuar në selinë e qytetit, në sheshin e tyre, si simbol i fuqisë shpirtërore. Kompleksi monumental i ndërtimeve nga stili romak gjendet në **Pizë, Itali**.

Karakteristika e këtij stili është edhe **skulptura e reliefit prej guri** me motive të ndryshme gjeometrike dhe vegjetative.

Mbaj mend:

Me **romakizëm** nënkuptohen të gjitha manifestimet kulturore dhe artistike në Evropën Perëndimore mes shekullit VIII dhe shekullit XIII, ndërsa periudha nga shekulli XI-të deri në shekullin XIII-të quhet **periudha romake**.

Analizo:

Përmendi ngjashmëritë dhe dallimet mes artit bizantin dhe romak.

Hulumto:

Nëpërmjet internetit kupto më shumë për Kullën e Lakuar në Pizë.



Figura 61. Kompleksi monumental në Pizë

Shekulli i mesëm

Pikturimi në romanizëm është kryer në pikturat monumentale të murit (freske), të vendosura në objekte sakrale. Veçohet fresku në kishën **Shën Klemente në Romë** nga shekulli XI në të cilën janë shfaqur *Shën Kirili dhe Metodi, si e mbajnë trupin e Shën Klimentit në Romë*.



Figura 62. Shën Qirili dhe Metodi e mbajnë trupin e Shën Klimentit në Romë, freskë në kishën e Shën Klemente, Romë

Gotika

Stili i dytë në artin e shekullit të mesëm në Evropën Perëndimore është **Gotika**. Është paraqitur në Francë në fund të shekullit XII dhe ka zgjatur deri te paraqitja e renesancës. Gotika, së pari është përmendur në arkitekturën sakrale. Stili gotik ka dominuar në pallate, shtëpi qytetarësh, katedrale, kapelë fshati, etj. Në këtë periudhë në qytetet janë ndërtuar bedene mbrojtëse. Në qytetet e rrethuara me bedene janë ndërtuar dy lloje të objekteve gotike:

- **Gjykata**, si simbole të fuqisë shenjëtore dhe
- **Katedrale**, si simbole të fuqisë shpirtërore

Shprehja më e lartë e arkitekturës gotike janë katedralet e qytetit, të ndërtuara në sheshet kryesore. Një nga katedralet më monumentale në Francë është **kisha e Shën Mërisë** ose **katedralja Notër Dam** në Paris, e ndërtuar në shekullin XII. E përbërë nga katër nivele, ndërsa enterieri i saj u ngrit deri në tësi prej rreth 108 metra. Për nga bukuritë e tyre veçohen katedralet në *Keln, Gjermani; Solzber në Londër; Toledo në Spanjë*, etj.

Në artin gotik, fotografitë dekorative me copa xhami me **ngjyrë** (vitrage) e kanë zëvendësuar pikturimin e murit dhe paraqesin pjesë përbërëse të ndonjë katedrale gotike. Pjesë përbërëse e katedraleve janë edhe **skulpturat e dekorimeve**.

➤ **Mëso më shumë:**

Te humanistët italian fjala *gotikë* domethënë: "barbarizëm dhe gjithçka që vjen nga ana tjetër e Alpeve".



Figura 60. Katedralja Nort Dam, Paris

➤ **Hulumto:**

Bëj krahasim në kishën Shën Pantelejmon në Nerz, Shkup dhe katedralja Notër Dam në Paris.

Shekulli i mesëm

Pikturimi në gotikë ishte shumë pak i përfaqësuar. Ndryshimet kanë ndodhur në shekullin XIV me paraqitjen e piktorit italian **Gjoto**, ndërsa ndikimi i tij është i njohur si **Gjotoizëm**.

☞ **Mëso më shumë:**

Supozohet se Gjoto i ka parë freskat nga manastiri Shën Pantelejmon në Nerez, Shkup dhe përshtypja e fuqishme ka ndikuar që ai me pikturimin e vet, të bëhet paralajmërues i Renesancës.



Figura 64. Vajtim, Gjoto

Nga lëmia e **filozofisë** veçohet emri i **Toma Akvinski**, i cili i ka përpunuar çështjet për lidhjen e besimit në Zot dhe diturin, arsyet dhe pasojat, metafizika, etj.

Nga letërsia e shekullit të mesëm në Evropën Perëndimore veçohet emri i **Dante Aligierit** me veprën e rëndësishme në periudhën e shekullit të mesëm, *Komedia hyjnore*. Liriku më i madh në këtë periudhë është **Françesko Petrarka**, që konsiderohet për paralajmërues i renesancës. Kanë filluar të shkruhen **romanet fisnike**, nga të cilat më i njohur ishte *Tristan dhe Izolda*. Janë hapur edhe universitetet e para: **Kembrixh** dhe **Oksford** në Angli, **Bolonja** në Itali, etj.

Muzika e shekullit të mesëm plotësohet në mënyrë vokale dhe me përdorim të instrumenteve: harfa, flauta, orgë, etj. Në fillim, më shumë ishte me përmbajtje të shenjtë, derisa në shekullin e vonshëm të mesëm janë paraqitur **truverët**, që kanë krijuar muzikë të shenjtë me motive dashurie dhe heroike.

Trashëgimia kulturore-historike e islamit

Islami, si religjion, është paraqitur më vonë se religjionet e tjera, në vitin 620-të në Mekë, me themeluesin **Muhamed**, që ka predikuar besimin në një Zot, **Allah**.

☞ **Mendo:**

Cilat ishin arsyet për ndërtim të katedraleve në shekullin e mesëm në territorin e Evropës Perëndimore?

☞ **Diskuto:**

Me arsimtarin e gjuhës bisedoni për veprat e Dantes dhe Petrarkës dhe ndikimin e tyre në letërsinë botërore.

☞ **Mëso më shumë:**

Për formimin e kulturës islame dhe artit me vlerë të madhe ishte ndikimi i religjionit islam dhe rregullat e islamit bashkë me lutjet e përditshme dhe shkuarjen e besimtarëve në Mekë.

Shekulli i mesëm

Karakteristikën e arkitekturës islamike e përfaqësojnë **xhamitë** e shumta, objektet fetare të dedikuara për takimin e besimtarëve si dhe për kryerjen e nevojave religjioze. Sipas monumentales së vetë veçohet **xhamia e Kaltër** në Stamboll, e vetme sipas llojit të saj për shkak gjashtë minareve të larta elegante.



Figura 65. Xhamia e Kaltër, Stamboll

Sipas monumentales së vet veçohet edhe mauzoleu **Taxh Mahall** te Agri, Indi, i ngritur nga Shah-Xhahan për kujtimin e bashkëshortes të dashur Mahall.

Motivi bazë i artit islamik, *arabeska*, është paraqitur në Samara, Bagdat. Arabeskat janë elemente dekoruese me motive vegjetative dhe gjeometrike, të vendosura në sipërfaqe të rrafshëta, në dysHEME dhe murre. Të përpunuara nga qeramika, mermeri, guri, druri dhe nga materiali tjetër, në lloj mozaiku ose të pllakave.

Shkrimi arab, është shumë i qëlluar për dekorim, ka sjell deri te paraqitja e **kaligrafistë** – forma elegante të shkrimit arab të dedikuara për zbukurimin e ndërtesave sakrale islamike me citate nga libri i shenjtë i Islamit, **Kurani**. Kaligrafia është pjesë përbërëse e çdo ndërtese fetare islamike.

Nga arti i zbatuar veçohen **qilimat**. Përpunimi i qilimave e ka prejardhjen nga e kaluara e largët dhe supozohet se është zhvilluar te popujt nomad. Së pari, me qilima janë mbuluar muret në tempujt fetar, ndërsa pastaj përdorimi i tyre është zgjeruar. Besimtarët mysliman qilimat i kanë shtruar në tokë dhe mbi to janë përkulur gjatë lutjeve; praktikë që zbatohet edhe sot në botën myslimane.

Mendo:

Çka është minarja, për çka shërben dhe cila është minarja më e lartë në botë?



Figura 66. Taxh Mahall, Agri, Indi

Hulumto dhe diskuto:

Vallë në vendin tuaj ekzistojnë objektet fetare islamike dhe ato krahasoni me objektet fetare krishtere.



Figura 67. Shkrimi Kaligrafik me emrin e Muhamedit



5. Renesanca

- *Renesanca e hershme në Itali*
- *Arti i hershëm në Flandri, Francë dhe Gjermani*
- *Renesanca e lartë në Itali*
- *Arti në Francë, Gjermani dhe Holandë në shek. XVI*
- *Zhvillimi i shkencës, letërsisë dhe muzikës*

Renesanca

Rezyme

Me braktisjen e artit bizantin, në dekadat e para të shekullit XV-të paraqitet një nga lëvizjet më të mëdha në kulturën dhe artin në Evropë, *renesanca*, që ka zgjatë dy shekuj. Emri **renesancë** vjen nga fjala franceze **renaissance me domethënie riparim, ri gjallje, ndërsa në veçanti lindje e përsëritshme, ringjallje e vjetërimit klasik** ose më saktësisht **shpirti krijues dhe krijues i njeriut, nën ndikim të letërsisë klasike, artit dhe filozofisë**.

Kultura dhe arti në renesancë ndahen në dy periudha:

- Renesanca e hershme në shekullin XV dhe
- Renesanca e lartë në shekullin XVI

Futja e artistëve të renesancës në traditën antike ndodhi falë **humanistëve**, përfaqësues të drejtimit të parë në kulturë. **Humanizmi** (nga fjala latine *humanitar, njerëzi*). Humanistët ishin besimtarë, shkrimtarë dhe admirues të letërsisë dhe artit, që e kanë mësuar literaturën e vjetër klasike greke dhe e kanë përhapur kulturën antike në kohën e vetë. Humanistët e kanë luftuar shkencën kishtarë dhe janë përpjekur për: **besimin në njeri**.

Periudha e renesancës paraqet rikthim më të madh progresiv deri atëherë të jetuar nga njerëzimi, koha në të cilën kanë lindur dhe kanë kërkuar personazhe gjeniale me fuqi të mendjes, karakter, mirësjellje dhe shkathtësi.

Asnjë periudhë artistike nuk ishte aq e pasur me piktorë, skulptorë, letrarë dhe muzikantë të lartë, siç ishte në renesancë. Lista e të mëdhenjve është mjaft e gjatë në të dyja periudhat dhe secili nga ata është i mjaftueshëm që të përmirësoj një periudhë dhe një popull.

Termet kryesore

Renesanca e hershme, renesanca e lartë, ringjallja, humanizmi, artisti universal

Renesanca e hershme në Itali

Në shekullin XV-të në Itali, më herët sesa në vendet e tjera evropiane, ka ardhur deri në zhvillim ekonomik të qyteteve dhe ngritja e qytetarëve. Së pari, veçohen Firenca dhe Venediku si qendra të mëdha qytetare, ndërsa në gjysmën e dytë të shekullit XV Roma është bërë qendra e re e renesancës në të cilën është vendosur kështjella e papës. Jeta ishte organizuar në qytete-shtete me borgjezi të fuqishme që kishte mundësi të realizoj idenë për qytetin ideal, me plan të imagjinuar për shpërndarjen e të gjitha funksioneve të jetës qytetare. Bashkë me kulturën materiale është zhvilluar edhe kultura shpirtërore, e cila ishte paraqitur në të gjitha format në interes të njeriut, për emocionet personale, dukjen dhe karakterin personal dhe fizik.

Në fillim të renesancës së hershme, kisha ka administruar me artin. Të gjitha llojet e arteve ishin nën shërbim të kishës. Por, me forcimin e borgjezisë, janë paraqitur sundimtarë dhe individë të pasur, që kanë ofruar mundësi për punë artistike dhe veprimtari. Ofertat e tyre kanë sjellë deri te çlirimi i porositësit të mëhershëm të veprave artistike, kisha, me çka përveç përmbajtjeve kishtarë janë paraqitur edhe motivet e reja në art, sipas dëshirës së porositësit. Duke u futur më thellë në autoritetin e kishës, renesanca e shoqërisë evropiane ka zbuluar pasurinë e kulturës antike, shkencës dhe artit, duke luajtur rol pozitiv në zhvillimin e kulturës.

Mbaj mend:

Arti i renesancës themelohet në vështrimin e formave të dukshme në natyrë, që ka sjell deri në paraqitjen e metodës shkencore, sipas të cilës artistët është dashur që krahas specialitetit të tyre të afërt të posedojnë njohuri nga gjeometria, anatomia, botanika, filozofia, retorika dhe poezia.

Është paraqitur edhe zbulimi i ri teknik, **perspektiva** që paraqet përmbledhje të grafikave dhe të rregullave të matematikës, që mundësojnë krijim të realitetit tredimensional me precizitet të saktë, i shënuar në letër ose në ndonjë sipërfaqe tjetër të rrafshët.



Figura 68. Venediku në kohën e renesancës

Shkruaj ese:

Jeta e përditshme e romakëve në kohën e renesancës.

Arkitektura

Arkitektura në **renesancën e hershme** është lindur në Firencë, në vitet e njëzeta nga shekulli XV, falë krijimtarisë së krijuesit gjenial **Filipo Brunelleski**, që konsiderohet baba i renesancës së arkitekturës.

Format e reja themelore në arkitekturë janë bazuar në një varg rregullash, *kanune*, që më vonë trashëguesit e tyre i kanë zbatuar, studiuar dhe përsosur. Rregullat e veta për herë të parë i ka zbatuar gjatë ndërtesës së **kubes së katedrales Shën Mëri del Fjore** në **Firencë**.



Figura 69. Kube e Katedrales Shën Mëri del Fjore, Firencë

Mëso më shumë:

Me konfirmimin e rregullave, të ashtuquajturat kanunet, ka mbetur vetëm të zgjidhet forma dhe dimensionet e ndërtesës. Këto vendime janë varur vetëm nga arkitekti, ai e ka punuar "*punën kreative*", përderisa të tjerët (skulptorët, piktorët, etj) duhej t'i plotësonin kërkesat e tyre. Brunelleski, kur për herë të parë i ka zbatuar këto rregulla, ka hasur në pakënaqësinë e pjesëmarrësve të tjerë në ndërtim. Zgjidhja e problemit ishte arritja e autoritetit të arkitektit të porositësi, ndërsa pasoja ishte vendosja e arkitekturës së renesancës në rrethet jashtëzakonisht të larta.

Skulptura

Një pjesë e madhe e skulpturave të renesancës njihen sipas natyralizmit, realizmit dhe anatomisë së trupit të njeriut. Skulptorët në renesancë ishin në gjendje nga çdo material, pa dallim nëse është punuar me gurë, mermer, bronz, dru, etj., t'i krijojnë format e dëshiruara, duke i tejkaluar pengesat, të mësuara nga përvoja e paraardhësve të vetë.

Hulumto:

Nga synon dhe me çfarë njihet skulptura e renesancës?

Bëj krahasim të figurës së njeriut me skulpturën e vjetër greke dhe asaj të renesancës?

Piktori i parë gjatë kohës së Mbretërisë Romake që kishte kurajo ta paraqet trupin e njeriut lakuriq, është një ndër skulptorët më të mëdhenj në histori, **Donatelo**. Ai e ka dhënë bazën e skulpturës antike, **bukuria e trupit të njeriut lakuriq**, zbulim që është konsideruar si revolucionare. Duke e përmendur stilin e ri, arti i tij paraqet rikthim në skulpturën italiane dhe në përgjithësi në renesancë. Ishte skulptor, piktor, arkitekt dhe vizatues, ishte individual dhe gjenial. Arritja e tij kulmore është statuja e **Davidit**, e përpunuar në formën e linjës së lakuar "S", e pa njohur në gotikë, e cila është bërë rregull bazë në artin e skulpturës në renesancë.

Fundi i renesancës së hershme e shënon emrin e argjendarit të lartë, piktorit dhe skulptorit **Verokio**, që ishte mësuës i Donatelo, nxënës i Leonardo da Vinçi. Vepra e tij më e vlefshme skulpturore është **statuja e David** e përpunuar në bronz. Derisa e ka punuar statujën e vetë, në mendje e kishte statujën e David nga Donatelo dhe ka dëshiruar të garoj me mësuësin e vetë.

Pikturimi

Temat kryesore të pikturimit të renesancës ishin *paraqitja e njeriut dhe rrethi i tij*, ndërsa risia që ishte futur është vënia e *theksit realist*.

Pikturimi, fillimisht është bazuar në **vizatim**, gjë që ka sjell deri te paraqitja e **vizatimit**. Kah fundi i shekullit XV-të, nga Holanda në Itali ishte bartur **pikturimi në vaj**, teknikë më efikase nga ngjyra e temperit që deri atëherë e kanë përdorur piktorët italian. Njëkohësisht është futur edhe **përdorimi në pëlhurë**, në vend të tabelave të atëhershme të drurit.



Figura 70. Davidi, Donatelo



Figura 71. Davidi, Verokio

Mëso më shumë:

Gjatë përpunimit të freskëve, së pari vizatimet janë bërë në kartonë ose në fleta të mëdha të letrës, të cilat më vonë janë bartur në mur të suvatuara. Bartja nga vizatimi në mur ishte me lyerjen e prapavijës së kartonit ose të letrës me shkumës dhe shtypjen e vizatimit në mur.




Figura 72. Lindja e Venerës, Botiçeli

Për nismëtar të mënyrës së re të pikturimit në renesancën e hershme konsiderohet piktori italian **Ma-zaço**, i cili i pari në pikturim ka zbatuar precizitet anatomic në tregimin e trupit të njeriut. Përfaqësuesi më i rëndësishëm në renesancën e hershme është **Sandro Botiçeli**, veprat e të cilit janë përplot me tema mitologjike.

Analizo:

Analizoni temat kryesore në pikturimin e renesancës dhe krahasoi me temat e pikturimit bizantin.

Arti i hershëm në Flandri, Francë dhe Gjermani

Pas zhvillimit ekonomik në qytetet dhe përforcimi i qytetërimit në Itali, ka ardhur deri në zhvillimin e kulturës materiale dhe të vendeve tjera evropiane. Zhvillimi i klasës qytetare ka ndodhur falë lirimit të dogmave kishtarë të shekujve të mesëm dhe ngritjes së shkallës së arsimit. Pikturimi italian i renesancës ka shkaktuar ndikim te piktorët flaman në Flandri, Francë dhe Gjermani.

Mbaj mend:

Pikturimi në renesancë e shënon edhe paraqitjen e portretit.

Qëllimi i **portretit të renesancës** ishte theksimi i simbolikës së njeriut, dhe jo pamja e tij fizike.

Periudha e rëndësishme në **artin** e hershëm **flaman** ka filluar me krijimtarinë e piktorit të famshëm flaman **Jan van Ajk**, i cili me vëllaun e tij **Huber** e ka përsosur teknikën e tij të pikturimit me ngjyra të vajit. Jan Van Ajk përmendet me veprën e tij impresionuese artistike e **Altarit Gent** ose **Kultin e Agnec sekretit, tabelë** e madhe dhe e komplikuar e **altarit**, e përbërë prej 12 tabelave të vizatuara të drurit, të renditura në dy radhë, nga të dy anët.

Si **piktor** i shquar **francez** në shekullin XV konsiderohet **Zhan Fuke**, miniaturist i renditjes më të madhe, ndërsa për pikturë më të famshme franceze e vizatuar në dru është **Pieta Avinjone**, vepër e madhe e pikturuar në Francë në shekullin XV.

Nën ndikim të artit flamen, në **Gjermani** ishin përfaqësuar mënyra realiste e vizatimit dhe gdhendjes. Në këtë periudhë në Gjermani, janë shtuar doreza druri dhe doreza bakri dhe janë shitur në festa, ahengje dhe panaire. Në atë mënyrë arti është përhapur mes popullit.



Figura 73. Kultin e Agnec sekretit, Jan van Ajk



Figura 74. Pieta avinjone

Renesanca e lartë në Itali

Asnjë periudhë artistike nuk ishte aq e pasur me piktorë të mëdhenj, siç ishte rasti në renesancë. Lista e tyre është shumë e gjatë. Edhe përkrah shumicës së artistëve, veçohen emrat e **Mikelanxhelo**, **Leonardo**, **Rafael**, **Tician**, etj. Secili prej tyre është i mjaftueshëm që të ringjall një periudhë dhe një popull, megjithatë të gjithë ato kanë jetuar në vend të njëjtë dhe përafërsisht në periudhë kohore të njëjtë.

Mbaj mend:

Që të njihet arti i renesancës, duhet të dallohet mënyra e të shprehurit të artistëve individual. Kuptimi i këtillë i artit, si realizim i individit vlen edhe sot.

Arti i renesancës më së shumti ka ardhur në shprehje në qendrat e mëdha në Itali, siç ishin Firenca, Venediku dhe Roma. Me kalimin e kohës, rolin udhëheqës në krijimin e formave artistike e ka marrë qyteti i Romës.

Arkitektura

Stili i arkitekturës në **renesancën e lartë** ishte shumë i ashpër, por edhe i llojllojshëm, nga stili në renesancën e hershme. Arkitektët nga kjo epokë aq shumë janë munduar të përmbahen në kanune, që ka sjell deri te ndërtimi i ndërtesave ideale me simetri absolute. Nga epoka e renesancës së lartë veçohet **kubeja e kishës Shën Petër në Romë**, e projektuar nga **Mikelanxhelo** i Madh.

Në arkitekturën e renesancës, përveç ndërtesave sakrale, janë ndërtuar pallate dedikuar për banim dhe vila – rezidenca të aristokratëve, të vendosura jashtë zonave të banuara. Si zbulim i ri në renesancë konsiderohet projektimi i **fortesave** që shërbejnë për mbrojtje. Ato kishin kulla të larta rrethore dhe mure të trasha të ulëta për t'u bërë ballë sulmeve të topave dhe për qëllim sulmi. Shembull i parë i ndërtesës mbrojtëse është **Fortesa e Tivolit**.

Renesanca merret edhe me studimin e zgjidhjeve urbanistike. Shembulli më i rëndësishëm është **sheshi i Letërsisë në Vixhevano**, i projektuar nga ana e **Leonardo da Vinçit**. Sheshi ka paraqitur sallë të madhe për pranim të hapur dhe është konsideruar si shembull për realizimin e një pjese nga qyteti ideal, që sipas artistëve të renesancës, saktësisht ashtu duhej të dukej "zemra" e qytetit.



Figura 75. Kupola e kishës Shën Petër në Romë



Figura 76. Fortesa në Tivoli

Shkruaj ese:

Përshkruaj një nga ndërtesat më të rëndësishme nga renesanca e lartë.



Figura 77. Sheshi i Letërsisë në Vixhevano

Skulptura

Karakteristikë e skulpturës në renesancën e lartë është anatomia e theksuar e trupit të njeriut dhe shfaqja e cilësive trupore nëpër shprehjet e fytyrës dhe lëvizjes së trupit, me çka ishte krijuar tema kryesore, *njeriu*.

Skulptura në renesancën e lartë në Itali në shekullin XVI-të lidhet me emrin e artistit të shkathtë të madh **Mikelanxhelo Buonaroti**. Me emrin e tij është arritur kulmi në format artistike në skulpturën e renesancës dhe nëpërmjet veprave të tij ndiqet zhvillimi i plotë në skulpturën e renesancës së lartë në Itali. Nën ndikim të Mikelanxhelos, arrihet njohuria se asnjë statujë, sa do që të jetë e përpunuar me përsosshmëri, nuk mundet në tërësi ta paraqet dramën e njeriut. Edhe pse, vetë ai është konsideruar skulptor dhe tërë shekullin e tij krijues e ka drejtuar nga përpunimi i skulpturave nga mermeri, veprat e tij nga fusha e arkitekturës dhe pikturimit, mbeten të pa përsëritshme. Veprat e tij më të vlefshme në artin e skulpturës janë skulpturat **Pieta dhe Mojsej**.

📖 Hulumto:

Hulumtoni nëpërmjet internetit jetën dhe veprat e Mikelanxhelos dhe në orë me arsimtarin bisedoni për shkathtësinë në artin e Mikelanxhelos dhe për veprat e tij.



Figura 78. Mojseu, Mikelanxhelo

📖 Mëso më shumë:

Mikelanxhelo gjatë jetës së vet ishte i respektuar nga mbretë dhe princ, ai ishte konsideruar si përkrahje për ata. Por nuk është brengosur për atë, ka jetuar i varfër deri në fund të jetës së tij, duke kontaktuar me nxënësit dhe ndihmësit e tij. Pas vdekjes ishte varrosur në Romë, por nipi e tij e ka vjedhur trupin, fshehtazi e ka transportuar në vendlindjen e tij, afër Firencës, dhe në mënyrë shembëlltore e ka varrosur.

Pikturimi

Të gjitha prurjet e pikturimit të renesancës së hershme ishin bartur në pikturimin e renesancës së lartë. Gjatë kohës së renesancës ka mbisunduar një temë, ajo e rrëfimit të **Shën Mërisë me fëmijë**.

📖 Mëso më shumë:

Rafal, tre shekuj e gjysmë ishte konsideruar si një prej emrave më të famshëm në pikturim, deri në gjysmën e dytë të shekullit XIX, kur është shfaqur si "huazues i artistëve të tjerë" me çka i është nënçmuar fama.

Renesanca

Pothuajse se nuk ka ekzistuar artist që nuk e ka përpunuar këtë temë, ndërsa disa artistë, si për shembull, **Rafael Santi**, e kanë miratuar si një ndër temat karakteristike të artit të vet. Veçohet piktura e Rafael, **Madona me fëmijë**, e punuar sipas skemës tipike për Shën Mërinë e renesancës. Synimi kas *bukuria* e përkryer e Rafael, vërehet në të gjitha veprat e tij. Veçohet edhe vepra e tij **Shkolla e Athinës**, e pikturuar në një nga muret e hapësirave në Vatikan.



Figura 79. Madona me fëmijë, Rafael

Shkruajese:

Rafael Santi, i treti nga më të mëdhenjtë.



Figura 80. Shkolla e Athinës, Rafael

Përkrah pikturimit në Firencë dhe Romë, si pjesë përbërëse e pikturimit të renesancës është edhe **pikturimi venedikas**. Përmendet vepra **Venera para pasqyrës** e piktorit venedikas **Tician**. Vitet e fundit nga jeta e tij karakterizohen me pikturim me gishta. Edhe pse, këto piktura nga afër duken pa formë, përsëri nga larg ato janë të përkryera.

Figura 81. Venera para pasqyrës, Tician



Edhe **Mikelanxhelo** me veprën e tij spektakulare: **Gjykata e tmerrshme**, e pikturuar në kapelën Sinkstine në Vatikan, mbetet piktori i papërsëritshëm. Freska e mbulon tërë tavanin në kubën Sinkstine. Në freskë janë treguar si motive biblike nga lindja e botës, deri te përmbytja e Noes. Figura qendrore e Jezusit. **Gjykata e tmerrshme** ishte e njohur para përfundimit. Të gjitha figurat e Mikelanxhelos i ka pikturuar lakuriq, por më vonë me perde ishin mbuluar pjesët e trupave të vizatuar.

Mendo:

Si Mikelanxhelo e ka krijuar **Gjykatën e tmerrshme**, çka ka pikturuar në të, çfarë vlere ka kjo vepër për kubën Sinkstine në Vatikan dhe cilat ceremoni rrjedhin aty.




Figura 82. Perëndia i fryn jetë Adamit, pjesë e Gjykatës së Tmerrshme, Mikelanxhelo, kubja Sinkstine, Vatikan

Përkrah emrit të Mikelanxhelos të papërsëritur, renesanca e lartë e shënon edhe emrin e një gjeniu tjetër të renesancës, **Leonardo da Vinçi**, artisti i shkathtë që pas vete ka lënë mjaft vepra të mëdha, ndërsa shpikjet e tij, të cilat edhe pse nuk janë zbatuar në kohën e tij, përdoren sot në teknologjinë moderne. Ishte arkitekt, skulptor, piktor, inxhinier, shpikës i renesancës italiane. Veprat e tij nga lëmia e matematikës, anatomisë, botanikës dhe teorisë për pikturim, e tregojnë kureshtjen e tyre të jashtëzakonshme për të gjitha lëmitë e shpirtit të njeriut.

Hulumto:

Me ndihmën e literaturës profesionale dhe internetit, hulumtoni inovacionet e Leonardo da Vinçit dhe bisedoni gjatë orës së mësimi me arsimtarin për këto.

Shkruaj ese:

Jeta dhe vepra e Leonardo da Vinçit.

Fama që e ka arritur Leonardo me portretin e **Mona Liza (Xhakonda)** është aq e madhe që sot vështirë mund të imagjinojmë se mënyra e krijimit të saj ishte tërësisht e ri në atë kohë. Leonardo gjatë krijimit të personazhit, si risi në plan parësor i ka përmendur cilësitë psikologjike të natyrës së njeriut, që vërehen në buzëqeshjen e ëmbël të Mona Lizës.

Përmendet edhe vepra e tij e madhe **Darka e fshehtë**, e vizatuar në muret e kishës Shën Mëri dela Gracia në Milano. Kjo pikturë është përplot me inovacione stilistike, me të cilat, në realitet janë përplot veprat e tij. Opusi krijues i Leonardos, në të gjitha sferat e krijimtarisë dhe hulumtimit të tij është i pa kaluar deri më ditën e sotme.




Figura 83. Mona Liza, Leonardo da Vinçi

✍ Analizo:

Bëj analizë pikturave të Mona Lizës dhe Natës sekrete nga Leonardo da Vinçi.




Figura 84. Nata sekrete, Leonardo da Vinçi

Arti në Francë, Holandë dhe Gjermani në shekullin XVI

Në këtë periudhë, njëjtë si në Itali, edhe në vendet tjera vërehet zvogëlimi i porosive të tema-ve artistike sakrale nga ana e kishës. Nga mesi i shekullit XVI, **Franca** i ka përjetuar çastet më të mëdha të artit gjenial. Në këtë periudhë janë ndërtuar kështjellat më të mira në rrjedhën e lumit Loara, nga të cilat veçohen kështjella më e madhe dhe më e bukur **Shambor**, pastaj kështjellat **Bloa, Rezidenca e Mbretit**, etj, që me bukurinë e tyre edhe sot e mahnitin Evropën dhe Botën.

Në **Holandë** në shekullin XVI arkitektura ishte radhitur në klasën aristokrate dhe në nevojat e tregtarëve të pasur, për shembull, Këshilli i qytetit në **Amsterdam**, që sot është Kështjella Mbretërore. Në pikturim janë zhvilluar natyra e vdekur, peizazhi dhe zhanërskemat.

Një nga përfaqësuesit më të mëdhenj të **renesancës gjermane** në shekullin XVI, fama e të cilit është zgjeruar edhe jashtë territorit të Gjermanisë, është **Albert Direr**, artisti i llojit të Leonardo da Vincit. **Doreza** e drurit që e ka ngritur në nivel më të lartë artistik, vërehet në veprën e tij të shquar **Katër kalorësit e Apokalipsës (murtajë, luftë, uri dhe vdekje)**.

Manierizëm – drejtim në art

Me **manierizëm**, në artin italian nënkuptohet periudha mes viteve të 30-ta të shekullit XVI dhe në fillimin e shekullit XVII. Paraqitet në mesin e shekullit XVI në Romë dhe Firencë, nga ana e piktorëve të pakënaqur, të revoltuar kundër balancimit dhe janë

✍ Diskuto:

Në orën e mësimet, bisedo me arsimtarin për përfaqësuesit më të njohur të renesancës dhe për veprat e tij.



Figura 85. Kështjella Shambor, Loarë



Figura 86. Katër kalorësit e Apokalipsës, A. Direr

✍ Mbjaj mend:

Termi **manierizëm** përdoret si stil tepër i çuditshëm, në të gjitha format e ekzistencës artistike dhe në letërsi.

ballafaquar kah stili i çuditshëm, i kryer nga arti i Mikelanxhelos, Leonardos dhe Rafaelos. Nga ky grup i artistëve, veçohet emri i **Jakopo Tintoreto**, përfaqësues i manierizmit nga Italia, ndërsa nga Spanja paraqitet emri i piktorit **El Greko**.

Zhvillimi i artit, letërsisë dhe muzikës

Shkenca evropiane, e liruar nga kufizimet e mësimëve kishtarë, në renesancë e ka përjetuar lulëzimin e vetë. Nga **shkencat natyrore** veçohen emrat më të mëdhenj nga lëmia e shkencës, **Nikolla Kopernik**, **Isak Njutni**, etj. Rikthim në zhvillimin e njerëzimit nga **Johan Gutenberg** me zbulimin e shtypshkronjës. Ai në vitin 1455-të e ka shtypur *Biblën*.

Renesanca, si periudhë në tranzicion ndërmjet **mendimit modern filozofik** dhe të atij të shekullit të mesëm, i ka dhënë emrat e filozofëve **Nikolla Makiaveli**, që konsiderohet si mendimtari i parë modern politik, pastaj **Tomas Mor**, etj.

Në lëminë e **letërsisë**, atë që e ka dhënë Dante për letërsinë e shekullit të mesëm, e njëjta gjë ishte për letërsinë e renesancës ishte shkrimtari spanjoll **Miguel de Servantes**, me veprën më të përkthyer në përmasa botërore *Don Kishoti* dhe përfaqësuesi kryesor i renesancës angleze, **Viliam Shekspir**, poeti ose dramaturgu më i madh i të gjitha kohërave, i cili me veprat e veta *Romeo dhe Xhulieta*, ka lënë ndikim të përhershëm në teatër dhe letërsi.

Muzika e renesancës karakterizohet me përdorimin më të madh të muzikës instrumentale. Veçohet emri i kompozitorit **Klaudio Monteverdi**, që ka shkruar një nga operat më të hershme dhe veprat e të cilëve e shënojnë kalimin nga renesanca në barok, pra prej aty edhe veprat e tij mund të futen edhe në të dy periudhat.

Mbaj mend:

Shmangiet e radhitjes klasike konsiderohet si **ndërmjet stil**, që e ndërlidh renesancën me barokun.

Diskuto:

Cilat janë arritjet e Isak Njutnit dhe Nikolla Kopernikut?



Figura 87. Miguel de Servantes

Përkujtohu:

Në orën e mësimt, me arsimtarin e gjuhës rikujtohuni në veprat e Servantesit dhe Shekspir.

Mbaj mend:

Fundi i renesancës dhe fillimi i muzikës baroke është shënuar me paraqitjen e **operës së parë**, rreth vitit 1600-të.

The image shows a highly detailed and ornate ceiling, characteristic of Baroque or Rococo architecture. The ceiling features a central dome with a complex, multi-layered design. The dome is surrounded by a series of smaller, circular medallions and intricate carvings. The overall aesthetic is one of grandeur and complexity, with a focus on light and shadow. The colors are primarily white and gold, with some darker tones in the shadows of the carvings.

6. Baroku dhe rokokoja

- Kultura dhe arti i barokut***
- Kultura dhe arti në stilin e rokokosë***

Baroku dhe rokokoja

Rezyme

Stili i barokut dhe rokokosë paraqiten pas renesancës, me ide tërësisht të kundërta. Përballë renesancës, që paraqet baraspeshë dhe masë:

- *Baroku*, që është përplot me lëvizje dhe kontraste dhe synon drejtë madhështores dhe të famshmes, dhe
- *Stili i rokokosë*, që synon kah e pëlqyera dhe ajo artificialja

Terme kryesore:

Barok, rokoko, baldakin, lëvizje, madhështore, artificiale

Kultura dhe arti i barokut

Kultura dhe arti i stilit të barokut e përfshin periudhën nga shekulli XVII-të dhe dekadën e parë të shekullit XVIII-të. Është përhapur në vendet e Evropës Perëndimore ku kisha katolike kishte ndikim të madh: Italia, Spanja, Portugalia dhe Flandria (Holanda). Stili i barokut nuk është paraqitur njëkohësisht, prandaj format e barokut dallohen nga njëri vend në tjetrin.

Mbaj mend:

Në artin evropian me **epokën e barokut** nënkuptohet periudha që e ndan renesancën nga epoka e neoklasicizmit.

Mëso më shumë:

Me paraqitjen e krizës në Evropën Perëndimore, është paraqitur edhe lufta klasore si edhe kryengritjet fshatare. Është formuar lëvizja qytetare, riformimi, interesat e të cilit ishin të kundërta me kishën katolike. Si reagim i lëvizjes qytetare, është formuar kundërriformimi, i udhëhequr nga ana e kishës katolike që ka dashur të rikthej famën dhe qeverisjen. Në momentin kur paraqitet kundërriformimi ishte fillim i një etape të re në zhvillimin politik dhe ekonomik në Evropën Perëndimore, por edhe fillimi i një etape të re në kulturë dhe një formë të re të krijimtarisë artistike. Edhe një dukuri që e shënon barokun është formimi i shteteve me regjim të monarkisë absolute. Në atë periudhë me rregullim të tillë ishte Franca, prandaj me artin baroken është madhështuar mbreti. Në vendet protestante, zhvillimi i stilit të barokut ishte ndërlidhur me përforsim dhe pasurim të borgjezisë.

Baroku, së pari është paraqitur në Romë, në fillimin e shekullit XVII-të. Sepse kisha katolike ndikimin e vet më të madh e kishte në papën e Romës, Roma bëhet qendra e barokut. Me qëllim që të mahniten më shumë besimtarë, kisha katolike ka zhvilluar idenë për kisha të pajisura të pasura. Prandaj, shteti i Papës në Romë është bë mbështetës i artit me qëllim përfundimtar që Roma të bëhet qyteti më i bukur i krishterë. Kështu, nga Italia, baroku është përhapur në tërë Evropën.

Edhe pse artistët e barokut janë konsideruar për trashëgues të renesancës, ato në vazhdimësi i shkelin të drejtat e artit të renesancës.

Mëso më shumë:

Fjala **barok** në gjuhën spanjolle do të thotë edhe një lloj rruaze me *formë të parregullt dhe të pazakontë*. Pothuajse në të gjitha gjuhët evropiane, termi barok paraqet sinonim për diçka anësi, të tepruar, artificiale dhe absurde.

Arkitektura e barokut

Arkitektura e barokut ka filluar në **Itali** përrreth vitit 1600, me Romën si seli e barokut. Baroku dallohet me rregullime urbanistike të qyteve dhe shesheve të plotësuara me shtylla dhe shatërvanë, që janë bërë element i rëndësishëm në barok. Një nga sheshet më të njohura nga koha e barokut është **Sheshi i kishës Shën Petër në Romë**, i projektuar sipas planit urbanistik të **Xhan Lorenzo Bernini**, përfaqësuesi më i rëndësishëm i barokut romak.

Shprehja më e përkryer e **barokut francez** është **kështjella në Versajë**, që ishte rezidencë e Luj XIV-të. E lokalizuar në afërsi të Parisit, ishte ndërtuar me qëllim që të rrit shkëlqimin dhe fuqinë e sundimtarit. Forma e kështjellës ka shërbyer si prapavijë e **parkut** të madh, i cili me numrin e pasqyrimeve ujore dhe rrugëve të gjata drejtkëndëshe, është bërë element i jashtëm i përhershëm i arkitekturës franceze, jashtë zonave qytetare. Si ndërtesë më e shquar barokene nga **Austria** merret kështjella **Belvedere** në afërsi të Vjenës.

Arkitektura barokene në Spanjë dallohet me ndërtime të ngarkuara me dekorime dhe me linja të shpërndara. Shembull tipik i arkitekturës baroke spanjolle është katedralja **Santiago de Kompostela** nga qyteti i njëjtë, i ndërtuar me statuja të shumta, kulla dhe sqep.

Në arkitekturën kishtarë në Austri dhe Gjermani vërehen kisha me kupolë qendrore dhe me dy kulla anësore, skemë që është futur nga baroku italian. Në këtë stil është ndërtuar **kisha Shën Karlo** në Vjenë.

Projekt sipas zgjedhjes:

- Sheshi i kishës Shën Petër, Romë;
- Kështjella Versajë, Paris.



Figura 88. Sheshi i kishës Shën Petër, Romë



Figura 89. Santiago de Kompostela, SpanjëPetër, Romë

Mbaj mend:

Muret e valëzuara janë një nga dallimet e arkitekturës barokene, me të cilat realizohet ideja gjithmonë e pranishme e barokut, **lëvizja**.

Skulptura e barokut

Skulptura e barokut shënon një numër të vogël të skulptorëve të lartë, para se gjithash për shkak të faktit se skulptura në këtë periudhë është konsideruar për plotësim të arteve të tjera. Sipas kësaj, *dallimi themelor sipas të cilit njihet skulptura në barok, është pranimit i saj*. Skulptura baroke, përkrah skulpturave të zakonshme, ishte dedikuar për dekorim, përkatësisht plotësimin të arkitekturës. Skulpturat e barokëve gjithmonë ishin paraqitur në lëvizje dhe paraqesin triumf në kohën e tyre. Shembull është skulptura **Apolon** dhe **Dafne** nga **Xhan Lorenzo Bernini**.



Figura 90. Apolon dhe Dafne, Bernini

Pikturimi i barokut

Një nga shënimet më të mëdha të pikturimit baroken është *dekorimi iluzion i mureve të ndërtimeve*, qëllimi i të cilës ishte krijim i përshtypjes se muret dhe tavani nuk ekzistojnë. Me figura janë përshkruar skena nga jeta e shenjtorëve, historia e dinastive, legjendat për heronj, dhe personat e mitologjisë, etj. Karakteristikë për barokun është edhe **pikturimi në kurora muri**. Për përfaqësues më të shquar të kurorave të murit, njëkohësisht edhe i barokut të vonshëm dhe stilit të rokokosë në Itali konsiderohet **Xhovani Batista Tiepolo**.



Figura 91. Alegoria e planetëve dhe kontinenteve, Tiepolo

Krahas pikturimit të murit, është paraqitur edhe **pikturimi i pëlhurës**, me karakteristike të *studimit të dritës dhe të efekteve të saj*. Këto efekte, si inovacion në pikturim i ka sjell artistit italian **Karavaxho**. Ai ishte filluesi i pikturimit në **natyrë të vdekur**, figura që paraqet fruta, aranzhime të luleve dhe mjete tjera, të pikturuara në atelie.



Figura 92. Torturimi i Shën Matej, Karavaxho

Baroku dhe rokokoja

Në Flandri është krijuar fisi i piktorëve i lidhur për *paraqitjen e besueshme të realitetit të përditshëm*, i cili nuk është vërejtur në Itali. Ndërlidhet për dy figura të ndryshme: **Rubens** (Flandri), i shquar sipas temave të tij mitologjike dhe **Rembrant** (Holandë), i cili e paraqet anën tjetër, anën dramatike të barokut. Rembrant në veprat e veta e ka zhvilluar pikturimin e synuar më të madh baroken: *i ka shfaqur cilësitë fizike, morale dhe psikike të personave të portretizuar, që i ka arritur me ndihmën e kontrasteve dhe hijeve të ndriçuara*. Ishte vizionar, poet dhe imagjinues që është inspiruar nga legjendat e vjetra, biblat dhe dhiatat që në mënyrë figurative i ka interpretuar.



Figura 93. Roja e natës, Rembrant

Mbaj mend:

Baroku, si vazhdim i stileve artistike, letrare dhe muzikore nga renesanca, me kalimin e kohës është zhvilluar në stilin e rokokosë, që ka zgjatur deri në gjysmën e dytë të shekullit XVII-të, d.m.th deri te paraqitja e klasicizmit.

Kultura në këtë kohë

Në **letërsinë barokene** ka filluar përdorimi i mjeteve stilistike: metafora, kontrastet dhe paradoksi, etj. Është shkruar *poezia minirizmi*, e plotësuar me vargje dashurie, në të cilat detajisht është përshkruar bukuria e trupit të femrës. Vargjet, sigurisht ishin plotësuar me tinguj, muzikë dhe pamje.

Muzika e barokut e shënon epokën historike të muzikës klasike. Në këtë periudhë operat kanë aritur famën, janë zhvilluar muzika instrumentale dhe janë standardizuar orkestrat. Nga muzikantët baroken veçohen emrat e **Antonio Vivaldi**, **Georg Fridrih Hendl** dhe kompozitori më i mirë i të gjitha kohërave **Johan Sebastian Bah**, viti i vdekjes i të cilit e shënon fundin e muzikës barokene.

Mendimi filozofik moral dhe politik nga kjo periudhë, i shënon emrat e larta filozofike: **Fransis Bekon**, **Xhon Lok**, **Spinoza**, **Zhan Zhak Ruso**, etj.



Figura 94. Johan Sebastian Bah

Diskuto:

Në orë me arsimtarin bisedoni për mendimet filozofike nga kjo periudhë.

Stili rokoko

Stili rokoko vërehet në periudhën e shekullin XVIII-të në Francë, si vend udhëheqës në art, dhe është konsideruar si stil udhëheqës. Karakteristikë kryesore e stilit të rokokosë veçohet shija specifike e klasës aristokrate gjatë kohës së qeverisjes së Luj XV-të dhe Luj XVI-të. Karakterizohet me synimin nga eleganca, dhe njëkohësisht edhe synimi nga e pazakonta, artificialja dhe e tepruara.

Arti i zbatuar, si plotësim i rëndësishëm i arkitekturës, në këtë periudhë e përjeton kohën e vet të artë. Kanë filluar të përpunojnë mobilie, tapiceri, pasqyra, prodhimet e porcelanit dhe të argjendit kishin çmim të lartë, etj. Si pjesë përbërëse të enterierit është paraqitur përdorimi i *parketit, pasqyra të mëdha dhe llamba*, nga të cilat më së shumti janë çmuar **llambat veneciane** të përpunuara nga pikat qelqore, ndërsa njëkohësisht është lindur edhe moda e **tapicerive**.

Arkitektura anonte drejtë komoditetit të enterierit të ndërtesave. Përkundër *Francës*, ku arkitektura praktikisht ishte përkufizuar vetëm në shtëpitë aristokrate parisiane, në *Gjermani* ajo zbatohet në arkitekturën kishtare. Në *Austri* si rokoko ndërtesë më e shquar merret **kështjella Shenbrun**, e lokalizuar në afërsi të Vjenës.

Mbaj mend:

Etapa e fundit e barokut është stili rokoko, që në Evropën Perëndimore, ka zgjatur deri në revolucionin francez dhe vdekjen e Luj XVI-të.



Figura 95. Salla për vallëzim, Kështjella e Katerinës, fshati Mbretëror



Figura 96. Brendia e bazilikës në Otobojren, Bavari

Baroku dhe rokokoja

Skulptura anonte nga dekorimi i parqeve, dhomave, shkallëve dhe ngjashëm. Në Francë ishte sjell një lloj i veçantë i **porcelanit biscuit**, që është bë material më i rëndësishëm i rokokosë për përpunimin e elementeve dekorative.

Në **pikturim** është paraqitur përdorimi i **plastelinës**, shkopinjtë të ngjyrosur nga toka e yndyrshme. Janë filluar të bëhen peizazhe me skena idilike të grupeve të dashuruara, të dhëna në lojë me muzikë, *festimet galante*.



Figura 97. Mallëngjim dashurie, Zh. A. Vato

Përfaqësuesi më i shquar i pikturave galante të plotësuara me mallëngjim të dashurisë dhe të sëmurë për jetën është piktori francez **Zhan Antoan Vato**, krijues i stilit rokoko në pikturim.

Arritjet shkencore të **filozofëve-edukatorë (iluministëve)** janë bë armë e fuqishme në betejën kundër shikimeve të vjetra. Për besimin e njerëzve ndaj dijes dhe shkencës ka kontribuar shpirti kritik dhe shkencor i filozofit **Rene Dekart**, veçanërisht me metodën e tij të paragjyqimit dhe me teorinë e vullnetit.

Literatura në fillimin e shekullit XVII-të ishte krijuar me radhë dhe rregulla të forta të konfirmuara. Por, nën ndikim të racionalizmit të Dekart në shekullin XVIII-të, literatura ka filluar të përpunoj tema nga shkencat natyrore dhe shoqërore. Veçohet emri i edukatorit, shkrimtarit dhe filozofit **Deni Didro**, që ishte autor i **Enciklopedisë** së parë që e ka krijuar njëzetë vjet. Rikthimi i kuptimeve njerëzore ka sjell deri te paraqitja e **klasicizmit**, kur literatura ka fituar formë të përkryer.

Hulumto:

Cili është mendimi i njohur i Rene Dekart?

Mbaj mend:

Plastelina dhe porcelani ishin shënimet kryesore të stilit të rokokosë.



Figura 98. Enciklopedia, D. Didro

Bëj projekt:

Arkitektura në renesancë, barok dhe në stilin e rokokosë.

The background of the slide is a photograph of the Eiffel Tower in Paris, France, illuminated at night. The tower is lit up with golden lights, and the sky is a deep purple and blue. The tower is the central focus of the image.

7. Kultura dhe arti evropian në shekullin XIX-të

- Klasicizmi

- Romantizmi

- Realizmi

- Impresionizmi

- Kultura dhe arti në vendet ballkanike në shekullin XIX-të

- Kultura dhe arti në Maqedoni në shekullin XIX-të

Kultura dhe arti evropian në shekullin XIX-të

Rezyme

Revolucioni i madh francez në vitin 1789-të e shënon rikthimin historik dhe ardhjen e klasës borgjeze në pushtet. Ky zhvillim ndikoi në tërë shekullin XIX-të, që zhvillimi i kulturës dhe i artit të ishte më i shpejtë, sesa në shekujt e mëparshëm. Përkundër renesancës dhe barokut që kanë zgjatur nga dy shekuj, në shekullin XIX-të zhvillimi i artit ka shënuar progres.

Disa dukuri e karakterizojnë artin në shekullin XIX-të:

- Arti e humb unitetin që karakterizohej në stile; dominon pikturimi; *në vend të stileve paraqiten drejtime* dhe
- Arti zhvillohet më shpejtë sesa në epokat tjera dhe kalon nëpër katër faza: **klasicizëm, romantizëm, realizëm dhe impresionizëm.**

Me paraqitjen e Amerikës në skenën artistike, **arti perëndimor** e humb karakterin e *artit në kontinentin e Evropës.*

Terme kryesore

klasicizmi, romantizmi,
realizmi, impresionizmi

Klasicizmi

Pas revolucionit borgjez francez, këmbëngulja nga thjeshtëzimi ka sjell deri te rikthimi i artit drejtë antikës, me çka është paraqitur drejtim i ri, i njohur si **klasicizëm** ose **neoklasicizëm**. Klasicizmi më herët është forcuar në Francë, ndërsa paralelisht është zhvilluar edhe në Itali, Gjermani dhe Angli. Dominon në fushën e pikturimit, përderisa skulptura është më pak e përfaqësuar.

Arkitektura në klasicizëm karakterizohet me dekorim më të thjeshtë. Për ndërtesat më të shquara gjatë kohës së klasicizmit merren **Muzeu Britanik** Londinez, pastaj **Porta Brandberbushk** në Berlin dhe **Shkalla e Milanos** në Milano, **Panteonot** në Paris, etj.

Skulptura ishte nën ndikim të periudhës antike dhe gjatë përpunimit të saj është synuar kah bukuria ideale, sipas shembullit të skulpturave të vjetra greke dhe romake. Skulptori më i njohur nga klasicizmi është **Antonio Kanova**. Veçohet vepra e tij **Paolina Borgjeze**, motra e Napoleonit, ku është paraqitur në mënyrë antike si Venera.

Në klasicizëm më së shumti dominon **pikturimi**, që ishte inspiruar nga skulpturat antike. Sepse renesanca paraqet ringjallje të parë në antikë, klasicizmi paraqet përpjekje për të dytën, ndërsa nga aty, ato janë më të përafërta. Ky stil në pikturim shënon emra të famshëm.

Diskuto:

Në orën e mësimet bisedo me arsimtarin për dallimet në art mes barokut, stilit të rokokosë dhe klasicizmit.



Figura 99. Porta Brandberbushk, Berlin



Figura 100. Paolina Borgjeze, A. Kanova

Shkruaj ese:

Përshkruaj një nga ndërtesat në klasicizëm.

Kultura dhe arti evropian në shekullin XIX-të

Përfaqësuesi kryesor i klasicizmit është **Zhak Luj David**, me të cilën vepër **Betimi i Horacit** për herë të parë është realizuar pikturimi klasik. Ai ishte piktori i parë i kështjellës së Napoleonit. Ka pikturuar *pëlhura të mëdha* me motive të famës së Napoleonit, nga të cilat veçohet *Kurorëzimi i Napoleonit* (Versajë), etj.

Si përfaqësues i neoklasicizmit veçohet **Dominik Engr**, piktori më i rëndësishëm i portreteve dhe akteve, karakteristika kryesore e të cilit ishte dashuria ndaj gruas.

Filozofia në këtë periudhë paraqitet racionalizmi. Ishtin aktual edhe sallonet, në të cilat është përhapur edukimi dhe arsimimi.

Klasicizmi si drejtim dhe si **periudhë letrare** themelohet në filozofinë e racionalizmit të Dekartit dhe në literaturën antike, veçanërisht në *Poetikën* e Aristotelit. Me stil të lehtë, me tingull të mirë dhe mashtrues paraqitet menjëherë pas barokut. Letërsia klasike ka mbajtur rregulla të ashpra estetike dhe fortë është mbajtur deri te principet morale, të defnuara në tre zhanret e mëdha: *tragjedi, epike dhe komedi*. Veçohen emrat e **Molier, La Fonten, Gete**, etj.

Muzika klasike, era historike e të cilës e shënon periudhën mes barokut dhe romantizmit, i ka dhënë kompozitorët më të mirë të të gjitha kohërave: **Mocart, Betoven, Shubert**, etj. Veçohet emri i **Johan Shtraus i Riu**, themeluesi i **operës klasike i Vjenës** në të cilën dominon **Vallëzimi**. Shtrausi ka krijuar mbi 400 vallëzime, pra nga këtu është quajtur edhe "Mbret i Vallëzimit". Një nga vallëzimet e tij më të njohura është **I djalit më të bukur Dunav**.



Figura 101. *Betimi i Horacitë*, Zhak Luj David

Hulumto:

Jeta kulturore e njerëzve në kohën e klasicizmit



Figura 102. V.A. Mocart në moshën 14-të vjeçare

Bëj projekt:

Jeta dhe vepra e Mocartit, nga fillimet e tij të hershme, deri në vdekjen e tij.

Romantizmi

Drejtimi i dytë në art në shekullin XIX-të është **romantizmi**, që paraqitet si kundërshtim i klasicizmit. Artistët, shqetësimin e tij romantik e ka shprehur nëpërmjet pakënaqësisë nga kultura e borgjezisë që e konsideron si të paplotë dhe të shëmtuar, si edhe nga inspirimi i Orientit, falë pushtimit të Egjiptit nga ana e Napoleonit. Nga kjo, romantizmi ishte i pa kulluar në Francë.

Në **arkitekturë** nuk ishte krijuar asgjë origjinale, janë imituar stilet historike, veçanërisht gotika në Angli dhe baroku në Francë. Si shembuj më të rëndësishëm veçohen **Parlamenti** në Londër dhe **opera e Parisit**.

Skulptura në romantizëm, më së shumti vjen në shprehje në veprat e artistit francez **Fransoa Rid**. Relievi i tij i njohur **Marseleza**, në të cilën është shfaqur largimi i vullnetarëve në Luftën revolucionare më 1792, është kryer në **Portën Triumfale** në **Paris**.

Në këtë periudhë, ngushtë lidhen letërsia, muzika dhe pikturimi, por nuk ndërtohen me emër të njëjtë. Në romantizëm, revolucionarizimi në **pikturim** është paraqitur nëpërmjet shprehjes figurative: *peizazhi* paraqitet si temë e veçantë që shprehet në gjendjen e shpirtit të pikturës, *karikatura* shënon avancim, ndërsa përmendet edhe *akuareli*.

Mbaj mend:

Si në romantizëm, kështu edhe në klasicizëm është synuar nga rikthimi në të kaluarën dhe në ripërrirjen e stileve të vjetra, veçanërisht të barokut dhe gotikës. Dallimi mes tyre është në zgjedhjen e temës.



Figura 103. Parlamenti në Londër



Figura 104. Marseleza, reliev, Porta Triumfale, Paris

Hulumto:

Nëpërmjet enciklopedive ose internetit hulumto për arsyen dhe fillimet e ndërtimit të portave triumfale nëpër botë.

Kultura dhe arti evropian në shekullin XIX-të

Piktorët më të njohur në romantizëm janë: **Ezhen Delakroa**, i cili ka trajtuar tema historike, i inspiruar edhe nga veprat e Dantes, Shekspirit, Bajronit, nën këtë ndikim ka pikturuar veprën *Vdekja e Sardanapollovit*, piktura e tij më romantike; **Francisko Goja**, piktori spanjoll evropian dhe piktori më i shquar i peizazheve romantike; piktori anglez **Uiliam Turner** etj.



Figura 105. Vdekja e Sardanapollovit, Ezhen Delakroa

Filozofia moderne e mëvonshme paraqitet në fillim të shekullit XIX-të dhe lidhet për emrin e **Immanuel Kantit**. Mësimet filozofike të Kantit për kritikën e racionalizmit, mendjes së pastër dhe praktike, si dhe kritikën për fuqinë e gjyqimit, kanë kryer ndikim të madh te filozofët nga shekulli XIX-të, nga të cilët veçohet **Hegeli**.

Letërsia e shënon periudhën e pikëllimit për shkak të botës dhe realitetit jo të përsosur. Romantizmi, pikërisht është letërsi lirike në të cilën poeti e shpreh vetveten, ndjenjat e veta dhe personalitetin e vetë. Më të përfaqësuara janë llojet letrare: poema, romanet në vargje, lirika, ndërsa si përfaqësues më të shquar njihen **Viktor Ugo**, **Xhorxh Gordon Bajron**, **Edgar Alan Po**, etj.

Përfaqësuesi i parë i **muzikës romantike** është kompozitori **Franc Shubert**, fama e të cilit është paraqitur dhjetë vite pas vdekjes së tij. Kjo periudhë përfaqësohet me kompozitorët e lartë të pianos: **Frederih Shopen**, **List**, kompozitorët e operës **Xhuzepe Verdi**, **Rihard Vagner**, etj.

Diskuto:

Në orën e mësimit me arsimtarin e gjuhës maqedonase, rikujtohuni në vargjet e Bajron dhe Edgar Alan Po.

Hulumto:

Shkoni në teatrin e operës ose në koncertin e muzikës klasike dhe shkruani ese për përshtypjet tuaja.



Figura 106. Xhuzepe Verdi

Realizmi

Nga mesi i shekullit XIX-të, faza e re zhvilluese në të cilën hyjnë kultura dhe arti, është njohur me emrin **realizëm**, ndërsa është paraqitur në Francë gjatë kohës së zgjimit të vetëdijes sociale. Në këtë periudhë, artistët këmbëngulin të shkojnë në hap me ndryshimet e mëdha shtetërore, t'i ndryshojnë dhe t'i kritikojnë. Realizmi kryesisht ishte përfaqësuar në pikturim, ndërsa shumë pak haset në skulpturë.

Në **pikturim** janë përpjekur për hedhjen e religjionit dhe mitologjisë dhe paraqitjes së botës bashkëkohore ashtu siç e kanë shikuar. Përfaqësuesi i vetëm dhe kryesor i realizmit është piktori francez **Gistav Kurbe**. Piktura *Varrosja në Ornans*, konsiderohet vepër e madhe e tij.

Mbaj mend:

Jeta shpirtërore në Francë në shekullin XIX-të është zhvilluar në drejtim të ri – **pozitivizëm**.

Nga aspekti filozofik, **realizmi** është drejtim që në mënyrë naive dhe kritike pohon se bota ekziston pavarësisht nga vetëdija dhe e njohim ashtu siç është.

Mëso më shumë:

Sipas Kubre, figura i paraqet: "zakonet nga koha ime, ashtu siç i shikoj unë". Kur piktura është paraqitur, ajo ka shkaktuar skandal dhe është konsideruar si protestë kundër moralizmit dhe mosrespektim për vdekjen.



Figura 107. *Varrosja në Ornans*, Gistav Kurbe

Edhe në **literaturë** vërehet përpjekja për realizëm, si dhe prekja e fakteve reale të realitetit dhe besimit në tregime. Përfaqësues më të rëndësishëm janë: **Sharl Bodler, Emil Zola, Gi De Moçasan**, etj.

Mendo:

Mbi cilin do parim të realitetit dhe për çka ata janë përpjekur?

Impresionizmi

Impresionizmi, paraqitet në vitet e 70-ta në shekullin XIX-të në Francë, si lëvizje e fushës së pastër figurative dhe paraqet një nga revolucionet më të mëdha të artit. Impresionizmi, në realitet, ka paraqitur shoqëri të artistëve- të mendimit të njëjtë, të ndërlidhur më shumë me shoqëri personale dhe armiq të përbashkët, sesa me unitet në bindje.

Pikturimi impresionist ka dhënë një numër të madh të artistëve të lartë, nga të cilët si më meritori veçohet **Klod Mone**, pas të cilit piktura **Impresion – Lindja e Diellit (Lindjen e diellit)**, ky drejtim e ka fituar emrin – **impresionizëm**.

Për opsion të impresionistëve është konsideruar dalje jashtë nga atelieja dhe pikturimi i dritës së diellit, së bashku me ndryshimet që ajo i shkakton në mjete. Sipërfaqja e pikturave impresioniste është mbuluar me njolla nga shtatë ngjyra, ndërsa eliminohen të gjitha ngjyrat neutrale, veçanërisht e zeza.

Arkitektura në shekullin XIX-të në një pjesë të madhe nuk është origjinale dhe i riparon stilet e mëparshme. Arkitektura moderne që përgjigjet në kërkesat e shoqërisë industriale, ka filluar me ndërtimin e ndërtesave afariste dhe administrative, shtëpitë e mallrave, etj. Veçohet **Kulla e Ajfelit** në Paris, e ngritur nga **Gustav Ajfel** më 1889, që shënon sundim të hekurit si material ndërtimor.

Mbaj mend:

Njohuritë shkencore sipas të cilave ndriçimi është ngjyrë dhe se në të nuk ka as ngjyrë të zezë dhe as të bardhë, se asnjë ngjyrë nuk shkakton dukuri të tjetrës, kanë hasur në zbatim të plotë në pikturim të impresionistëve.




Figura 108. Lindja e diellit, Klod Mone

Hulumto:

Çfarë domethënie ka sot Kulla e Ajfelit për Francën?



Figura 109. Kulla e Ajfelit, Paris

Kultura dhe arti evropian në shekullin XIX-të

➤ Mëso më shumë për zbulimet shkencore-teknike në shekullin XVIII-të dhe XIX-të

- Nikola Tesla e ka zbuluar rrymën me shumë faza dhe e ka transformuar energjinë mekanike në energji elektrike;
- Xhems Vat e ka zbuluar makinën e ngrohjes;
- Amerikani Robert Fulton e ka konstruktuar vaporin e parë, ndërsa anglezi Xhorxh Stivenson e ka konstruktuar lokomotivën e parë të ngrohjes;
- Ivan Mendeleev e ka krijuar sistemin periodik të elementeve kimike;
- Alfred Nobel e ka zbuluar dinamitin;
- Luj Paster e ka zbuluar vaksinën kundër çmendurisë dhe kolerës;
- Maria Kiri Sklodovska, pionier në fushën e radioaktivitetit, ishte gruaja fituese e parë dhe e fundit në Çmimin Nobël në dy fusha të ndryshme të shkencës: fizikë dhe kimi;
- Semjuel Morze e ka shpikur telegrafin dhe e ka krijuar *Alfabetin Morse*;
- Benxhamin Freklin e ka zbuluar rrufenë;
- Luj Braj e ka shpikur shkrimin për të verbër, *shkrimi Brail*.

Kultura dhe arti i vendeve ballkanike në shek. XIX-të

Kultura dhe arti e vendeve ballkanike në shekullin XIX e shënojnë ndryshimet e mëdha shoqërore, lëvizjet liruese të popujve nën qeverisjen turke dhe austro-hungareze, zgjimi i vetëdijes nacionale dhe ringjallja. Në këtë periudhë theksohen idetë e baraspeshës nacionale, liria fetare, si dhe afrimi kulturor dhe politik i popujve ballkanik.

Në Ballkan, drejtimit artistike janë paraqitur me vonesë të caktuar. **Klasicizmi** ka kuruar version të caktuar sentimental, i njohur nën termin *Biedermaer*. **Romantizmi** në arkitekturë shënon mënyrë të re të ndërtimit dhe kujtimeve të reja stilistike, që paraqiten si rezultat i shkollimit të arkitektëve të ri në Vjenë dhe Budapest. Në **realizëm** shënohen synimi më i madh ndaj realizmit akademik.

➤ Analizo:

Cilat janë arritjet e zbulimeve shkencore-teknike dhe cilat shkenca janë zhvilluar si rezultat i paraqitjes së tyre?




Figura 110. Oraçi, Rihard Jakopič

➤ Mendo:

Çka ka sjell deri te zgjimi i vetëdijes nacionale te popujt ballkanik?

Kultura dhe arti evropian në shekullin XIX-të

Impresionizmi me fuqi të madhe i ka përfshirë piktorët serb, kroat dhe slloven, të cilët në plan të parë i kanë përmendur sensacionet optike të dritës, ndërsa ndonjëherë e kanë shfrytëzuar ngjyrën për shprehjen e gjendjes shpirtërore.

Arti në shekullin XIX-të në Bullgari ishte sfera e edukimit evropian me ndikim të fuqishëm të kishës. Nga kjo periudhë është ndërtesa e **manastirit Ril**, manastiri më i madh dhe më i njohur në Bullgari. Janë paraqitur edhe **murgjit** piktorë që bëjnë ikona sipas porositi për kishat. Është zhvilluar dhe grafika, në të cilën figurat e shenjtorëve, skenat nga drithërat dhe ngjashëm, nga pllakat e drurit ose nga metali ishin shtypur në letër.

Përfitimet nga zbulimet e reja shkencore-teknike nuk e kanë lënë anash as Gadishullin Ballkanik. Gjatë shekullit XIX-të, në vendet ballkanike të cilat ishin në sundim të Perandorisë Osmane, nga ana e shumë vendeve evropiane ishin ndërtuar rrugë, binarë hekurudhore, linja telefonike dhe telegrafike, etj. Falë zbatimit të zbulimeve teknike, në vende ballkanike kanë filluar që të zhvillohet miniera, metalurgu, teknika makinerike, etj.

Paralelisht me zhvillimin e industrisë, sektor dhe zhvillim i veprimtarisë kulturore dhe edukative. Si reformator i gjuhës serbe dhe letërsisë është paraqitur **Vuk Stefanoviq Karaxhiq**. Nga Mali i Zi theksohet poeti **Petar II Petrov iq Njegosh**, që vlerën e vetë artistike në lëminë e letërsisë e ka arritur me poemën **Kurora e Malit**. Në Shqipëri ishte futur abetarja shqipe e **Sami Frashërit** me shkrimin latin, ndërsa shenja dhe shkronjat e para të gjuhës shqipe **Abetarja**.



Figura 111. Manastiri Ril, Bullgari

🔍 **Hulumto:**

Cilat veprimtari janë zhvilluar në qelitë e shkollave kish-tare dhe të manastirit?



Figura 112. Portreti i Vuk Karaxhiqit

🔍 **Mëso më shumë:**

Shprehja e njohur e Vuk Stefanoviq Karaxhiq është:

“Shkruaj si flet dhe fol siç është shkruar”.

Kultura dhe arti në Maqedoni në shekullin XIX-të

Maqedonia në shekullin XIX-të akoma ishte pjesë e Perandorisë së fuqishme Osmane. Pasiguria ekonomike dhe politike, dhunat e shpeshta, vjedhjet dhe plaçkitjet kanë shkaktuar tërheqje të popullatës së pa mbrojtur nga fshatrat në qytete. Me hapjen e fshatit drejtë qytetit, ka filluar procesi i përsheptuar i urbanizimit të qyteteve që ka sjell deri te vargu i ndryshimeve ekonomike, sociale dhe kulturore. Me migracionet fshat-qytet është krijuar klasa e re qytetare, që së bashku me tregtarët dhe zanatlinjtë kishin ndikim të caktuar në jetën kulturore-artistike dhe jetën edukative të kohës.

Sepse kishat dhe manastiret ishin qendrat e vetme ku është krijuar dhe përhapur edukimi kishtar dhe shkrimi, **arkitektura** në këtë periudhë ishte orientuar nga riparimi dhe muratimi i kishave p.sh. **Shën Pantelejmon** në **Veles**. Veprimtaria artistike intensive vërehet në kompleksin më të madh të manastireve **Shën Joakim Osogovski**, i lokalizuar afër **Kriva Pallankës**, brendësia e të cilit është dekoruar me ikona dhe gdhendje nga gdhendës maqedonas. Gdhendësit më të njohur kanë me origjinë nga familjet **Frçkovski dhe Filipovcit**, të njohur sipas gdhendjes së ashtuquajtur të cekët në dru. Nga **zografët** veçohet ikon-përshkruesi më i njohur **Diço Zograf** nga **Shkolla Mijaçka**, i cili në atelienë e vetë ka ushtruar zograf të rinj. Ai ka poseduar **ermini** të përkthyer dhe të shkruar (*udhëzim për pikturim*).

Diskuto:

Në orën e mësimit me arsimtarin bisedoni për pozitën dhe jetën në qytetet dhe fshatrat në Maqedoni në shekullin XIX-të.

Bëj projekt:

Sipas zgjidhjes, përshkrim të manastirit ose kishës në Maqedoni që ju ka lënë më shumë përshtypje.



Figura 113. Shën Pantelejmon, Veles



Figura 114. Shën Joakim Osogovski, Kriva Pallankë

Kultura dhe arti evropian në shekullin XIX-të

Nga fusha e **pikturimit**, përmendet piktori **Dimitar Andonov-Papradishki**, portretet, peizazhet dhe kompozicionet e të cilit janë punuar në mënyrë më të thjeshtë. Ai gjatë përpunimit të portreteve ka përdor model të ri dhe fotografi.

Me ngjalljen ekonomike të klasës qytetare janë paraqitur arsimuesit e parë kulturor-edukator. **Filles-tarët e literaturës së gjuhës popullore maqedonase** ndërlidhen me veprat e **Joakim Krçovski** dhe **Kiril Pejçinoviç. Shkolla e parë shenjtore në Maqedoni në gjuhën popullore** është hapur në vitin 1873-1838 në **Veles**, nga ana e **Jordan Haxhi-Konstantinov Xhinot**. Ngjarja më e rëndësishme në kulturën maqedonase është publikimi i **Përmbledhjes së këngëve popullore, gjë e gjëzave dhe traditave nga vëllezërit Dimitar dhe Konstantin Milladinov**.

Krijimtaria popullore ka fituar rol kryesor për zhvillimin dhe afirmimin e vetëdijes popullore maqedonase. Veçohen emrat e krijuesve më të mëdhenj të poetëve maqedonas **Konstantin Milladinov, Grigor Prliçev dhe Rajko Zhinzifov**. Paraqiten edhe mësimdhënësit maqedonas, **Partenij Zografski, Kuzman Shapkarrev, Gjorgjia Pulevski dhe Dimitar Makedonski**, të cilët me librat e tyre, të shkruara në gjuhën e kuptueshme maqedonase që e kanë pasur ndikimin më të madh kulturor-edukativ në Maqedoni.

Nga fundi i shekullin XIX-të dhe fillimi i shekullit XX-të, populli maqedonas në dhomën e përfaqësuesve nga trashëgimia kulturore e shënon dhe **folklorin maqedonas**, që është një nga më të pasurit në botë. **Dimitë popullore** janë vlerësuar si krijime të larta estetike dhe figurative të artit popullor maqedonas, me mbi 70 lloje të ndryshme të dimive të zbukuruar me qëndisje, gajtan, shirita, dantellë, topëza, aplikime të ndryshme, etj. Tradita popullore maqedonase ka krijuar qindra vepra të mëdha të **valleve popullore dhe të këngëve**, të interpretuara me instrumente popullore: **me surle, daulle, gajde, kavall, harpë, dajre**, etj.



Figura 115. Autoportret, D.A. Papradishki

Shkruaj ese:

Sipas zgjidhjes, për vlerën e krijuesve të poezisë maqedonase, rilindasëve ose mësuesve.



Figura 116. Vallja e vështirë

Hulumto:

Me arsimtarin shkoni deri te Muzeu i Maqedonisë në Shkup dhe shikoni dimitë popullore dhe instrumentet maqedonase. Bëni projekt për atë që do të shihni dhe do ta mësoni aty.



8. Arti modern në shekullin XX-të

- **Neoimpresionizmi**
- **Postimpresionizmi**
- **Skulptura moderne**
- **Simbolizmi**
- **Fovizmi**
- **Ekspresionizmi**
- **Kubizmi**
- **Futurizmi**
- **Arti i abstraktes**
- **Neoplasticizmi**
- **Mbirealizmi**
- **Skulptura në shekullin XX-të**
- **Pop arti dhe konceptualizmi**
- **Arkitektura në shekullin XX-të**
- **Kultura në shekullin XX-të**
- **Kultura dhe arti në shekullin XX-të në hapësirat ballkanike dhe në Maqedoni**

Arti modern në shekullin XX-të

Rezyme

Asnjëherë në historinë e njerëzimit, arti nuk ishte aq kundërshtues dhe i komplikuar, siç është rasti në shekullin XX-të, kur nga njëra anë ishte i ndaluar, i djezur, i ngrirë dhe i ekspozuar i përqeshur dhe kritike, ndërsa nga ana tjetër, i festuar dhe i aplikuar.

Njohuria se Evropa nuk është qendër e botës dhe se arti i saj nuk është i thjeshtë, as i vjetër, ka sjell deri në ndryshime radikale në të gjitha format e veta. Në fillim të shekullin XX-të ndikimi më i fuqishëm në artin evropian e realizon arti primitiv, veçanërisht arti nga bota afrikane dhe polineziane nga të cilët janë inspiruar Pikaso, Matis, Brak, etj., të cilat vlera në spontanen dhe burimoren e kanë zbuluar nëpërmjet skulpturave dhe maskave të tyre.

Artin modern e shënojnë shumica e drejtimeve pikturuese: neoimpresionizmi, postimpresionizmi, skulptura moderne, simbolizmi, fovizmi, ekspresionizmi, kubizmi, futurizmi, pikturimi metafizik, arti abstrakt, neoplasticizmi, supermatizmi, konstruktivizmi, dadaizmi, mbi realizmi, realizmi, konceptualizmi, pop-arti, etj. Të gjitha këto drejtime artistike të përfaqësuara në forma të ndryshme artistike gjatë shekullin XX-të, kanë dhënë emra të lartë të fushës artistike, që e kanë shënuar periudhën e dhënë në krijimtarinë e tyre. Një pjesë e drejtimeve në artin modern shënohen edhe në literaturë, muzikë dhe filozofi.

Terme kryesore:

Abstrakte,
neoimpresionizmi,
postimpresionizmi, skulptura
moderne, simbolizmi,
fovizmi, ekspresionizmi,
kubizmi, futurizmi,
pikturimi metafizik,
arti abstrakt,
neoplasticizmi,
supermatizmi,
konstruktivizmi, dadaizmi,
mbirealizmi, realizmi,
konceptualizmi, pop-arti etj,

Arti modern në shekullin XX-të

Neoimpresionizmi

Neoimpresionizmi është drejtim që paraqitet pas impresionizmit. Duke i mësuar ligjet dhe teoritë e ngjyrave, kanë arritur deri te *përzierja optike e ngjyrave*. Princiipi i teknikës është pëlhu-
ra e plotë që të mbulohet me pika me ngjyra të ndryshme, me ngjyra të pastra të papër-
ziera, përzierja e të cilave do të bëhet me syrin e shikuesit dhe atëherë do të realizohej sensacioni i kësaj nuance, që piktori e ka lënë në pëlhurë. Piktura jo vetëm që e jep ndriçimin, por edhe vetë bëhet ndriçim. Kjo teknikë në pikturim shkakton sensacion. Paraqitja e neo-impresionizmit ndërlidhet me emrin **Zhorzh Sera**. Ky drejtim kishte ndikim të madh te artistët e rinj.

Diskuto:

Në orën e mësimit së bashku me arsimtarin bisedoni për arsyet dhe paraqitjen e artit modern në shekullin XX-të në Evropë.



Figura 117. E diel pasdite në ishullin Le Grand Zhat, Zhorzh Sera

Postimpresionizmi

Tre artistë, tre tragjikë në mënyrën e tyre dhe të ndryshëm sipas temperamentit, qëndrojnë në ballë, si përfaqësues të artit modern të shekullit XX-të: **Pol Sezan, Pol Gogen dhe Van Gog**.

Postimpresionizmi, si reagim i impresionizmit, paraqitet në vitet e fundit në shekullin XIX-të me piktorin holandez **Vinsent Van Gog**, i shkaktuar nga nevoja e tij që të shpreh botën e tij të brendshme. Ka konsideruar se janë të mjaftueshme vetëm dy ngjyra, e kuqja dhe e gjelbra, që t'i shpreh "tmerret e pasionit njerëzor". Vepra e fundit **Korbi mbi drithëra**, është vepra e tij më e madhe.

Bëj projekt:

Sipas zgjidhjes, hulumto në internet për jetën dhe veprat e **Pol Sezan, Pol Gogen** ose **Van Gog** dhe bëj projekt për njërin nga to.

Mëso më shumë:

Një ditë pas përfundimit të veprës **Korbi mbi drithëra**, në vendin e njëjtë në fushën që e ka pikturuar, Vinsent Van Gog, në moshën 37-të vjeçare i ka dhënë fund jetës së tij me fjalët e fundit: "Mjerimi asnjëherë nuk do të ketë fund".

Arti modern në shekullin XX-të



Figura 118. Korb mbi drithëra, Vinsent Van Gog

✍ **Mëso më shumë:**

Arti postipresionist ka përjetuar fat të çuditshëm. Është shfaqur në Perëndim, ku është sulmuar si shprehje bolsheviste, egërsirës dhe e kaosit modern; në Rusi së pari ishte pranuar si art progresiv, që pastaj të sulmohet si art i borgjezisë; në Gjermaninë nacistë është shpallur si art i degjeneruar; në Italinë fashiste është konsideruar për art zyrtar i fashizmit. Edhe pse i mohuar nga disa, ndërsa sforcuar nga të tjerët, ky art ka arritur të mbijetojmë shumë se gjysmë shekulli.

Skulptura moderne

Franca e ka mbajtur rolin udhëheqës në artin e skulpturës në gjysmën e dytë të shekullit XIX-të. Skulptura moderne fillimet e veta i shënon me veprat e skulptorit të famshëm francez **Ogist Roden**. Sepse më shumë e kanë interesuar emocionet, se sa monumentalizmi i veprës, është munduar që emocionet të shprehen në të gjitha pjesët e skulpturave të tij.

✍ **Mendo:**

Cilat janë veprat e mëdha të Ogist Roden dhe shënoni karakteristikat e tyre?



Figura 119. Njeriu që ec, Ogist Roden

Simbolizmi

Simbolizmi paraqitet në gjysmën e dytë të shekullit XIX-të, si art që në parametrat ndërkombëtare është zgjeruar nëpër Evropë. Pikturat janë të pasura me ngjyra dhe përpunohen lëmi të ndryshme tematike: skena mitologjike të miteve klasike dhe biblike, jepen tregime figurative të temave nga ëndrrat, vdekja, etj. Simbolet që i kanë përdorur artistët gjatë pikturimit janë personale, sekrete dhe të pakuptueshme për të tjerët. Me kalimin e kohës, kur piktura ka filluar të kuptohet si prodhim i shpirtit, dhe jo i asaj që shikohet, është paraqitur reagim kundër simbolizmit.

Veçohen veprat e **Gustav Moro**, që janë të bollshme me rrëfime mitologjike dhe historike: *Vallëzimi Saloma*, *Kleopatra*, *Samson dhe Dalilës*, *Prometej*, etj.

Diskuto:

Në orën e mësimi, bisedoni me arsimtarin për ndikimin e simbolizmit mbi paraqitjen e **Artit të ri (Art nouveau)**, më shumë si filozofi sesa si drejtim artistik.



Figura 120. Vallëzimi Saloma, Gustav Moro

Fovizmi

Fovizmi është konsideruar drejtimi i parë në art në shekullin XX-të, i cili ka dëshiruar të çlirohet nga paraqitja iluzione dhe lëndëve. Paraqitet pothuajse njëkohësisht me ekspresionizmin, të dyja të nxitura nga krijimtaria e **Van Gog**. Është themeluar në Sallonin Vjesh-tor në Paris në vitin 1905, ku në një sallë ishin ekspozuar pikturat e artistëve të rinj, që veçohen me intensitet të ngjyrës dhe pas ekstravagancës së vizatimit.

Mëso më shumë:

Sipas lojës së kritikuesit për skulpturën e ekspozuar në Sallon, e bërë me shpirtin e hershëm të skulpturës florentinase (Donatelo mes bishave të egra – les fauves), ishte kryer në emër të artistëve të rinj, **fovistëve**, ndërsa arti i tyre ishte quajtur **fovizëm**. Fjala *fauves* veçanërisht i është përkushtuar ngjyrës shkëlqyese, që ishte më intensive se ajo e neoimpresionistëve.

Arti modern në shekullin XX-të

Nga fovistët veçohet emri i **Anri Matis**, një nga nuanecat më të mëdha në shekullin XX-të. Vlera e pikturave të tij nuk shtrihet në përshkrimin e saktë të mjeteve, por në vlerën e elementeve figurative.

Mëso më shumë:

Zhorzh Ruo, ishte më i përafërt me ekspresionistët gjerman, sesa me fovistët francez, aty ku i takonte. Nuk ishte kureshtar i ngjyrës së pastër dhe asnjëherë nuk e ka larguar nga paleta e toneve të errëta dramatike, të përafërta me disponimin e tij. Temat e tij i përpunojnë **Vuajtjet e Krishtit** (*Koka e Jezusit*), ndërsa vepra **Odali** është konsideruar si simbol i fovistëve. Grafikët e tij hyjnë në punët më të mira në grafikën moderne. Seria e grafikave e publikuar nën emrin **Mjerim**, është plotësuar me tmerret dhe vuajtjet nga Lufta e Parë Botërore, në të cilën e ka shprehur besimin për shpëtim. Teknikisht, këto lista të grafikave janë vepër e madhe e tij.

Mendo:

Cilat janë karakteristikat e fovizmit?

Ekspresionizmi

Kriza e civilizimit evropian, ndikimi i pikturimit të Van Gog dhe artit në Polinezi, më fuqishëm kanë ndodhur në veprat **ekspresionistëve** gjerman. Historianët dhe kritikët gjerman me **ekspresionizëm** i kanë përfshirë të gjithë dukuritë revolucionare, që janë paraqitur në art në periudhën nga viti 1910 deri më 1920.

Përfaqësuesi më i rëndësishëm i ekspresionizmit konsiderohet norvegjezi **Edvard Munk**, me të cilin pikturimi norvegjez për herë të parë arrin famë




Figura 121. Linja e gjelbër,
Anri Matis



Figura 122. Koka e Jezusit,
Zhorzh Ruo

Diskuto:

Në orën e mësimit me arsimtarin bisedoni për paraqitjen e ekspresionizmit.

Mendo:

Cilat motive i përpunon ekspresionizmi?

Arti modern në shekullin XX-të

botërore. Munk konsiderohet edhe si *baba* i *ekspressionizmit*. Kryesorja në artin e tij duhet të kërkohej në dispozicionin e tij të errët psikologjik: sëmundje, frikë, emocione, vdekje, panik i brendshëm, të cilët në realitet janë tema bazë në veprat e tij. Vepra e tij më e njohur është piktura **Krik**, për të cilën shpjegon se ka ndodhur në periudhën kur ishte shumë i sëmurë duke iu shfaqur ulërima, jo shumë larg në natyrë. Atë që e ka ndjerë, ai e ka vizatuar. Ka krijuar pikturë me re të ngjyrosura si gjak i vërtetë. Siç thotë edhe vet ai: “Ngjyrat ulërojnë”.



Figura 123. Krik, Edvard Munk

✍ **Mëso më shumë:**

Në regjimin nacist gjerman, artin nga Munk e kanë quajtur degjenerim dhe atij ia kanë marrë veprat. Gjatë kohës së okupimit të Norvegjisë, i është ofruar kolaborim, por ai ka refuzuar të jetë anëtar i *Këshillit të nderuar artistik*. Ka vdekur para se të përfundoj lufta.

✍ **Mëso më shumë:**

Austriani **Oskar Kokoshka** është theksuar me portretet e tij të shkrimtarëve, muzikantëve dhe aktorëve në të cilat nuk merret me problemin e formës dhe ngjyrës, por me studimin e ashpër ekspresionist, duke depërtuar në pjesët më intime të qenies njerëzore. Në portretet e tij, rolin kryesor psikik e luajnë duart dhe fytyra. Veprat e tij e ndajnë fatin e njëjtë si veprat e tij, ishin marrë nga ana e nacistëve gjatë kohës së Luftës së Dytë Botërore. Edhe ai ishte shpallur *artist degjenerues*, në shenjë proteste, ka vizatuar veprën **Autoportreti degjenerues**.




Figura 124. Autoportret, Oskar Kokoshka

✍ **Shkruaj ese:**

Sipas zgjedhjes, jeta dhe vepra e Edvard Munk ose Oskar Kokoshka.

Kubizmi

Kubizmi paraqitet në fillimin e shekullit XX-të në Gjermani, si rrymë e dytë, e kundërt me fovizmin dhe ekspresionizmin. Është emëruar sipas një pikturë të **Zhorzh Brak** ku dominojnë **kubet** (katrorët), pra nga kjo mënyra e punës së pikturimit të ri është quajtur **kubizëm**. Kubistët nuk janë kënaqur që veprën të paraqesin nga njëra anë, por i shumëfishojnë projektimet e mjetit të njëjtë, duke dashur që në atë mënyrë, njëkohësisht të shprehin më shumë nga anët e tij. Kishin anuar nga shprehja vizuale e vetëdijes racionale. Gjithsesi, çdo piktor ka pasur mënyrën e vet të punës. Si përfaqësues më i shquar i kubizmit konsiderohet piktori spanjoll **Pablo Pikaso**. Vepra e tij e madhe dhe figura e epokës është **Gernika** (viti 1937), e inspiruar nga Lufta Qytetare Spanjolle. Është emërtuar sipas qytetit bask Gernika, i bombarduar nga ana e aviacionit fashist.

☞ **Mbaj mend:**

Kubistët i presin pjesët të caktuara të letrës, drurit, pëlhurës, etj., i ngjeshin në bazë, me qëllim që pikturës t'i japin vërtetësi materiale. Në këtë mënyrë është krijuar **kolazhi**, që në shekullin XX-të ka tërhequr varg të zbulimeve artistike.

☞ **Mëso më shumë:**

Pablo Pikaso gjatë jetës së vet ka kaluar nëpër më shumë epoka krijuese: ka vizatuar akte të cilave u ka imponuar reformatore të skulpturave afrikane, në vitin 1908 i pari e ka krijuar **kolazhin**, ndërsa nga viti 1910 në kolazh ka futur shkronja dhe fjalë. Përveç ngjithjes së pjesëve, gjithçka tjetër është vizatuar në mënyrë tradicionale.



Figura 125. *Gernika*, Pablo Pikaso

Futurizmi

Futurizmi ishte i zëshëm, agresiv dhe ka ngritur shumë pluhur në gjysmën e parë të shekullit XX-të. Futuristët i kanë shpallur luftë të kaluarës, kanë dëshiruar shkatërrim të bibliotekave, akademive dhe muzeve, të cilat i kanë konsideruar si “varrezë e artit”. Kanë pohuar se automobili garues është mjaft më i bukur nga statuja “Nike nga Vetëkorsitë”, dhe se duhet të vritet Hëna, ndërsa edhe e kanë festuar “lufta si higjienë e vetme e botës”. Një nga figurat më të rëndësishëm të futuristëve është **Xhino Severini**.



Figura 126. Centrifugale, Xhino Severini

✍ **Mendo:**

Përcakto dallimet në kubizëm dhe futurizëm. Për shembull nga kubizmi veprat e Pikasos.

Arti i abstraktes

Edhe pse abstraktja është përfshirë në çdo vepër artistike, deri në periudhën e renesancës së hershme, procesi i abstraktes në këtë lëmi nuk ishte i vetëdijshëm dhe as i kontrolluar. Me kalimin e kohës, artistët kanë filluar t’i analizojnë format natyrore me ndihmën e trupave dhe formave gjeometrike, me qëllim të zbulimit nëse piktura në vete përmban përmbajtje të caktuar për të transmetuar porosi të caktuar. Me artin **abstrakt ndërlidhet** emri i piktorit të madh rus **Vasilij Kandinski**, që pasionin e vet drejtë shpirtërores dhe okultizmin e bart në veprat e veta.

✍ **Mbaj mend:**

Nën nocionin **arti i abstraktes** nënkuptohet procesi i analizimit dhe vizualizimit të realitetit.



Figura 127. Kompozicioni VI, Vasilij Kandinski

Neoplasticizmi

Piktori holandez **Pit Mondrian**, duke anuar të tejkalon shprehjen individuale në artin e vet, ka arritur deri te pikturimi abstrakt gjeometrik, që e ka quajtur **neoplasticizëm**. Për Mondrian, arti ishte shprehje e realitetit të vërtetë dhe jetës së vërtetë, ndërsa qëllimi i saj ishte të zbuloj aspektin universal të jetës. Gjatë krijimit të veprave të veta është përdorur me tre ngjyra: e kuqe e kaltër dhe e verdhë.

Në cepin tjetër të Evropës, pothuajse njëkohësisht, paraqitet grupi i artistëve rus, **Avangarda ruse**, që e kanë ndarë idenë dhe nyjet. **Kazimir Maleviq** i pari e ka sjell abstrakten deri në fundin e thjeshtëzimit gjeometrik, që vërehet në veprën e tij **Katrori i zi në fushën e bardhë**.

Diskuto:

Në orën e mësimit së bashku me arsimtarin bisedoni për karakteristikat dhe cilësitë e artit abstrakt të Vasilij Kandinski dhe neoplasticizmit nga Mondrian.

Diskuto:

Vrasjet masive gjatë kohës së Luftës së Parë Botërore te artistët ka shkaktuar rezistencë të madhe kah vlerat estetike dhe morale nga e kaluara. Gjatë kohës së luftës, grupi i piktorëve, skulptorëve dhe letrarëve në Cyrih kanë themeluar lëvizje të re, e quajtur **Daba**, ndërsa anëtarët janë quajtur **dadaistë**. Ato e kanë mohuar realitetin e deritanishëm, veçanërisht artistikja, nëpërmjet krijimit të pacaktuar dhe ndërlihdjes së shprehjeve të ndryshme artistike, p.sh. nga poezia, piktura, ndonjë send i harxhuar apo i hedhur, etj.; dadaizmi si drejtim nuk ekziston (viti 1922), megjithatë ai i ka liruar të gjitha përkufizimet tradicionale të imponuara në shprehjet artistike dhe në atë mënyrë e ka hapur rrugën e mbirealizmit.




Figura 128. Kompozicioni me të kuqe, të kaltër dhe të verdhë, P. Mondrian




Figura 129. Katrori i zi në fushës së bardhë, K. Maleviq

Arti modern në shekullin XX-të

Mbirealizmi

Në vitin 1924 mbirealistët e kanë formuar estetikën e jo të vetëdijshmes, irracionalës dhe automatikes. Një nga përfaqësuesit më të rëndësishëm të mbirealizmit është piktori spanjoll **Salvador Dali**. Ai në veprën e vetë **Qëndrueshmëria e përkujtimit** me procedurë super realiste ka pikturuar disa ora, që gjithsesi si mjete i njohim, por u ka dhënë forma morbide të lëkurave të rrjepura me çka i sjell në prekje me mjetet tjera. Me këto procedura të pikturimit të mjeteve të njohura dhe detajeve, por të vendosura në raporte jo logjike mes veti, nëse ka krijuar atmosferë joreale, që ndoshta ndonjëherë e përjetojmë në ëndrra.

✍ Mëso më shumë:

Në ndikim të psikanalizës së Zigmund Frojd, mbirealistët e kanë zbuluar bukurinë në sferën e të pavetëdijshmes, imagjinatës, ëndrrave dhe mungesës së kontrollit.



Figura 130. Qëndrueshmëria e përkujtimit, Salvador Dali

Skulptura në shekullin XX-të

Skulptori i njohur botëror anglez **Henri Mur**, kishte ndikim të madh në zhvillimin e skulpturës moderne. Ishte trashëgues dhe admirues i artit të popujve primitiv, ndërsa në veçanti atë nga Amerika Latine. Temat e tij të shpesh-ta janë figura të drejta, në mënyrë të ulur dhe të shtrirë. **Figurat shtrirëse** tregojnë ngjashmëri të dukshme me statujën e Majeve nga Çiça Ica, **Çak-Mul, Shpirti i shiut**.



Figura 131. Çiça Ica, Çak-Mul, Shpirti i shiut

✍ Diskutoni:

Në orën e mësimet me arsimtarin bisedoni për ngjashmëritë dhe dallimet e skulpturave të Henri Mur, me ato të majeve.



Figura 132. Pushimi pas pune, Henri Mur

Arti modern në shekullin XX-të

Pop arti dhe konceptualizmi

Reagimi i të gjitha llojeve të abstraktit paraqitet në vitet e 60-ta në lloj të **pop artit** dhe figuracionit të ri. Edhe pse pop arti është lindur në Britaninë e Madhe, zhvillimin e vet e ka përjetuar në Amerikë, veçanërisht në Nju-Jork. Ai paraqet pasqyrim të komunikimeve masive në shoqëri: televizor, film, reklamë, shenja komunikacioni.



Figura 133. Pop arti III, Peter Blek

Konceptualizimi ose **arti dematerializues** karakterizohet me abrogim të veprës së tij të gatshme artistike. Arti është paraqitur si ide, është vërejtur në fotografi, gjatë të cilës fotografia e zëvendëson veprën ose vetëm e dokumenton. Në vete përfshinë: **lendart ose art vendi dhe bodiart ose art trupor**.



Figura 134. Spiralja Xheti, Robert Smitson

Arkitektura në shekullin XX-të

Arkitektura në shekullin XX-të konsiderohet si pjesë e zhvillimit urbanistik. Qytetet në mënyrë teknike janë pajisur, janë gjetur zgjidhje për problemet rrjedhimore të ndërlidhura me komunikacionin, ndërtimi i qendrave tregtare, ujësjellësit, infrastrukturës, etj. Kërkesat e arkitektëve modern janë themeluar në përdorim të materialeve konstruktuese, nga të cilat prioritet kanë hekuri, çeliku dhe betoni. Me zhvillimin e teknikës dhe shkencës dhe me përdorimin e materialeve të reja, ka ardhur deri në ndryshim të idealit për bukurinë në arkitekturë. Që atëherë, ajo është bërë e rreptë, e pastër dhe e lirë nga çdo dekorim.

✍ **Bëj projekt:**

Hulumto në internet për pop-artin, lend-artin ose bodi-artin dhe përpuno projekt sipas dëshirës.

✍ **Diskuto:**

Në orën e mësimin me arsimtarin bisedoni mbi karakteristikat e arkitekturës botërore në shekullin XX-të, për shembull, për *Pallatin e Kombeve të Bashkuara*.

Arti modern në shekullin XX-të

Një nga arkitektët e parë të mëdhenj konsiderohet **Frenk Lojd Rajt**. Nga ndërtimet e tij veçohet **Shtëpia e ujëvarës**.

Në shekullin XX-të është shënuar edhe krijimi i **dizajnit (mjet i përdorur i formular)**, si vepër artistike me vlerë të veçantë. Karakteristike për dizajnin është *zhvillimi i idesë nga imagjinata deri te realizimi*. Zhvillimi i dizajnit për konsum të gjerë varret nga shija e masave të gjera popullore ose nën *kiçin* në të cilin është paraqitur si dukuri universale me modele, kopje dhe riprodhim të artit të lirë. Dizajni duhet të ndjek modën, sepse moda është një nga mënyrat për ruajtjen e stilit, pavarësisht nëse bëhet fjalë për mobilie, gardërobë, ushqim, sport, etj.



Figura 135. Shtëpia e ujëvarës, Frenk Lojd Rajt



Figura 136. Karrigia e Ritveld

Kultura në shekullin XX-të

Edhe përkundër terrorit nga Lufta e Parë Botërore që ka sjell deri te dukuria e pasojave sociale dhe politike dhe falë zërit kritik ndaj realitetit, shekulli XX-të shënon avancim në fushën e shkencës, artit, literaturës dhe muzikës.

Mësimi dhe praktikimi i filozofisë si disiplinë profesionale nga shekulli i XIX-të në shekullin XX-të kanë sjell deri te paraqitja dhe zhvillimi i lëvizjeve të reja filozofike, si për shembull: *ekzistencializmi, fenomenologjia, pozitivizmi*.

Literatura në shekullin XX-të ka kaluar nëpër lëvizje të reja. Veçohen emrat e **Sharl Bodler, Oskar Vajld, Albert Kim, Umberto Eko**. Edhe pse, kah fundi i shekullit XIX-të romani është bë lloji kryesor letrar, ai në shekullin XX-të ishte i llojllojshëm dhe më i pasur.

✍ Përpuno projekt:

Sipas zgjidhjes, dizajn të preferuar ose markë të preferuar.

✍ Mëso më shumë:

Luftërat në shekullin XX-të në Evropë:

- Lufta e Parë Botërore;
- Revolucioni socialist dhe komunist në Evropë
- Lufta e Dytë Botërore.

Arti modern në shekullin XX-të

Ndryshime të mëdha në poezi vërehen pas Luftës së Dytë Botërore, kur literatura ishte pushtuar me kup-tim pesimist për jetën dhe njeriun. Në roman janë bërë përpjekje të reja, në poezi janë hapur rrugë të reja, janë hapur teatro të reja artistike ku janë pre-zantuar krijimet e reja të regjisorëve, etj.

Ngjashëm me artin dhe literaturën edhe **muzika** në shekullin XX-të ka kaluar nëpër lëvizje të reja. Me lulëzimin e romantizmit në muzikë kah fundi i shekullit XIX-të, nëpërmjet veprave të kompozitorit **Klod Debisij** dhe trashëgimtarët e tij vërehet pe-riudha e muzikës në shekullin XX-të. Me kalimin e kohës, kompozitorët e shumtë kanë hyrë në stilet moderne muzikore. Me paraqitjen e radios, tekno-logjitë e reja për incizim dhe riprodhim, muzika ka përjetuar popullaritet të madh në popull. Muzika në shekullin XX-të karakterizohet me liri të re, stile të reja dhe drejtime dhe eksperimentim të gjerë mu-zikor.

Kultura dhe arti në shekullin XX-të në hapësirat ballkanike dhe në Maqedoni

Kultura dhe arti modern në shekullin XX-të në hapësirat ballkanike

Arti modern në shekullin XX-të, i inspiruar me idetë çlirimtare për revolucion dhe edukim, nuk i ka tejka-luar as hapësirat ballkanike. Artistët ballkanik përpu-nojnë motive nga mitologjia popullore, nëpërmjet theksimit të reales dhe mitologjisë, kalimtares dhe sekretit, të resë dhe të vjetrës, e shprehin ndjenjën e vetë subjektive për botën. Me kalimin e kohës ka ardhur deri në pranimin e drejtimeve të shumta ar-tistike, ndërsa janë krijuar të reja, për shembull, **re-alizmi socialist në art**, me tema karakteristike nga LPÇ, riparimi dhe ndërtimi i tokës, etj.

Mëso më shumë:

Zbulimet dhe shpikjet në shekullin XX-të:

- Formulimi i teorisë së përgji-thshme për relativitet nga Al-berht Ajnshtajn;
- Fluturimi i parë me aeropla-nin e vëllezërve Vrajt;
- Zbulimi i radios dhe televizo-rit;
- Fluturimi i parë në hapësirë;
- Zbulimi i energjisë (atomike) nukleare nga Nils Bor;
- Aleksandar Fleming e ka zbu-luar penicilinën;
- Zbulimi revolucionar i kom-pjuterit dhe çipit kompjute-rik;
- Xhejms Votson e ka zbuluar strukturën e ADN-së;
- Maks Plank e ka formuluar kuant teorinë;
- Zigmund Frojd e ka themeluar psikoanalizën.

Analizo:

Në orën mësimore me arsim-tarin bisedoni për zbulimet në shekullin XX-të dhe anali-zoni rëndësinë e tyre në jetën e përditshme të njeriut.

Mëso më shumë:

Në vendet Ballkanike në pe-riudhën e pas luftës, në piktu-rim dhe skulpturë ka mbisun-duar **realizmi heroik, socialist**.

Arti modern në shekullin XX-të

Kultura dhe arti modern në shekullin XX-të në Maqedoni

Arti modern maqedonas është paraqit si rezultat i trashëgimisë kulturore-historike, nga ekzistimi i tij më i hershëm, deri në fillimin e shekullit të kaluar, nëpërmjet numrit më të madh të materialeve dhe përmendoreve shpirtërore, paraqet dëshmi për vazhdimin e gjatë për traditën kulturore dhe artistike në zonën e Maqedonisë. Arti në shekullin XX-të në Maqedoni vërehet në të gjitha format e ekzistimit artistik: arkitekturë, skulpturë, pikturim, etj.

Si shembuj të rëndësishëm nga **arkitektura** para dy luftërave botërore në Maqedoni veçohen ndërtesat arkitektonike nga Shkupi, nga të cilat sot një pjesë e madhe nuk ekzistojnë: **Shtëpia e kulturës, Shtëpia e oficerëve, Banka popullore, Stacioni i vjetër hekurudhor, Teatri popullor, Pallati Ristiqve, etj.**, ndërsa nga Manastiri veçohen **Ndërtesa e mitropolit të Manastirit, Gjimnazi i Manastirit, etj.**

Rrjedhat moderne të pikturimit bashkëkohor maqedonas janë paraqitur me gjeneratën e parë të piktorëve mes dy luftërave botërore, ndërsa qendra e atyre ndodhive ishte në qytetin e Shkupit, ku janë mbajtur ekspozita figurative. Në vitet e 20-ta nga shekulli XX-të është paraqitur gjenerata e parë e rëndësishme e artistëve maqedonas, nga të cilët veçohen **Lazar Liçenoski, Nikolla Mazev,**

Diskuto:

Në orën e mësimet me arsimtarin bisedoni për ndikimin e artit modern në hapësirat ballkanike.

Merrni shembuj nga arkitektura, skulptura dhe pikturimi në Slloveni, Kroaci, Serbi, Bullgari, Greqi dhe Shqipëri.



Figura 137. Stacioni i vjetër hekurudhor, Shkup

Projekt:

Sipas zgjidhjes, në internet humtoni ndonjë nga ndërtimet e vjetra në Shkup nga shekulli XX-të dhe përpunoni projekt për njërin nga ato.

Mendo:

Cilat nga ndërtimet arkitektonike nga shekulli XX-të sot akoma ekzistojnë në Shkup?

Arti modern në shekullin XX-të

ndërsa nga periudha e pasluftës veçohen emrat e **Petar Mazev** dhe të shumë piktorëve të lartë nga drejtimet e ndryshme artistike. Krijuesi themelor i artit të mozaikut në Maqedoni është piktori **Lazar Liçenoski** i cili gjithashtu veçohet edhe sipas freskëve, ikonave dhe tapicerive të tij. Në shekullin XX-të Maqedonia i shënon fillimet e *fotografisë dhe filmit, vizatimit dhe grafikës, artit monumental dhe skulpturës bashkëkohore*, etj.

Një nga themeluesit e gjuhës letrare bashkëkohore maqedonase dhe autor i librit *Për punët maqedonase* është **Krste Petkov Misirko**, që konsiderohet për shtyllë shpirtërore të kulturës maqedonase. Në kalimin e shekullin XIX-të kah XX-të veçohen edhe urtësitë; **Vojdan Çernodrinski**, autori i parë dramaturg maqedonas. Pas Luftës së Dytë Botërore **Sllavko Janevski** e ka shtypur romanin e parë në gjuhën maqedonase *Fshati pas shtatë qartësive*.

Grupi i parë i kompozitorëve profesional maqedonas paraqitet mes dy luftërave botërore, nga të cilët veçohen emrat e **Zhivko Firfov**, themeluesi i shkencës maqedonase për folklor muzikor, **Stefan Gajdov**, **Trajko Prokopiev**, etj. Në këtë periudhë formohen **Filarmonia maqedonase dhe Opera dhe baleti maqedonas**.

✍ **Mëso më shumë dhe mbaj mend:**

Gjatë kohës së Luftës së Dytë Botërore, prurje e rëndësishme në betejën për pavarësi të Maqedonisë ka dhënë luftëtari dhe veprimtari nacional maqedonas **Metodija Andonov Çento**, që është bërë kryetari i parë i Kryesisë së KAÇKM dhe kryetari i parë i Maqedonisë. Në referendumin e 8-të shtatorit të vitit 1991 është shpallur sovraniteti, pavarësia dhe liria e Republikës së Maqedonisë dhe popullit maqedonas.



Figura 138. Nëna me fëmijë, Nikolla Martinovski



Figura 139. Qendisje, mozaik, Lazar Liçenoski



Figura 140. M. A. Çento, përmendore, Shkup

✍ **Diskuto:**

Në orën e mësimit me arsimtarin bisedoni për jetën kulturore në Maqedoni në shekullin XX-të.



9. Kultura dhe arti në Lindjen e Largët dhe në Amerikën Jugore

- Kultura dhe arti në Indi***
- Kultura dhe arti në Kinë***
- Kultura dhe arti në Amerikën Jugore***

Kultura dhe arti në Lindjen e Largët dhe në Amerikën Jugore

Rezyme

Kultura dhe arti në Lindjen e Largët dhe në Amerikën Jugore kanë rrenjë të thella historike. Ato janë një nga vendet më të vjetra në botë ku janë zhvilluar qytetërimet e lashta me kulturë dhe art të pasur, mbetjet e të cilit sot paraqesin trashëgimi botërore kulturore-historike, ndërsa një pjesë e tyre janë shpallur për çudira botërore.

Arti në Indi, Kinë dhe Amerikën Jugore – Meksikë, është përplot me kultura të shumta, artefakte materiale, unike sipas formës dhe qëllimit të vet. Kultura dhe arti i tyre paraqiten si rezultat i dallimit të religjioneve të tyre dhe traditave popullore, shënojnë shumë shprehje, të pa përsëritura dhe të pa vërejtura në qytetërimet tjera të botës së lashtë.

Terme kryesore

Buda, tempull, gurë-themel, gjarpër, pagodë, letër, Muri Kinez, Maçu Pikçu, ushtarë guri

Kultura dhe arti në Indi

Kultura dhe arti në Indi, themelohen në trashëgiminë e saj të pasur kulturore dhe materiale, fillimet e veta i shënojnë në të kaluarën e largët. Zakonet dhe traditat e pasura të bartura nga lugina e lumit Ind, nga koha antike, nëpërmjet periudhës së Vedave, Buda, pushtimeve myslimane dhe kolonizimeve evropiane, këtë art e bëjnë unik në dukjen e vetë. Kultura dhe arti indian, që paraqiten si rezultat i dallimit në religjion dhe traditën indiane, shënojnë shprehje të shumta të manifestuara nëpër hapësirë dhe kohë.

Arkitektura në Indi shënon vazhdimësi nga e kaluara e largët. Si ndërtime të hershme arkitektonike në Indi konsiderohen vendbanimet qytetare **Mohenxho-Daru dhe Harapiu**, të quajtura "Qytetërimet e **lumit Ind**". Karakteristika e tyre kryesore janë qytetet e planifikuara mirë me shtëpi dhe rrugë, për të cilat konsiderohet se janë ndërtuar pa ndikim religjioz.

Ndikimi religjioz në arkitekturë ka filluar me paraqitjen e religjionit indian **budizmi**, kur kanë filluar të ndërtojnë tempuj budistë dhe Hindus. Një nga tempujt më të mëdhenj budist në botë është **Hindu tempulli në Delhi**.

Veçohet edhe **arkitektura e thellë e shpellave të shenjta** që kanë rol në manastire dhe tempuj. Shkëlqimin më të madh e kanë arritur **shpellat e Aqhanta në Hiderabad**.

Ndikimi mysliman është paraqitur si rezultat i pushtimeve myslimane në shekullin XII-të, që ka sjell deri në bashkim kreativ të kulturës indiane me atë islame.

Diskuto:

Në orën e mësimet me arsimtarin bisedoni për dukurinë dhe fillimet e kulturës, artit dhe religjionit në Indi.



Figura 141. Banja mashe, Mohenxho-Daru



Figura 142. Tempulli Hindus, Delhi



Figura 143. Shpellat e Aqhanta, Hiderbad

Në ndikim të kulturës indiane në periudhën e shekullit V-të dhe XIV-të, Kamboxha e ka përjetuar dëfrimin e vet artistik. Arti budist në Kamboxhë vërehet në **tempullin – mal Angkor-Vat**, nga shekulli XII-të, i ndërtuar me ferracë me shumë kate, kulla shkallëzore dhe skulptura në të cilat janë paraqitur relieve me figura të vallëzuesve.



Figura 144. Tempulli-mal, Angkor-Vat

Skulptura indiane, gjithashtu ishte inspiruar nga **budizmi**. Fillimet datojnë nga shekulli i III-të p.e.s, në luginën e lumit Gang, ku është zbuluar **gur-stupi**, përmendore që është përdorur në qëllime religjioze, nevoja të veçanta. Veçohet **Stupa e madhe në Sanshi**, në të cilën vërehen motivet nga arti persian (luan me flatra).



Figura 145. Stupa e madhe-Sanshi

Pas pushtimit të një pjese të territorit të Indisë nga ana e Lekës së Madh (zona e Gandarës, Afganistani i sotshëm dhe një pjesë e Pakistanit), në krijimin e figurave të Budës vërehet ndikimi helen ndërsa më vonë edhe ai romak. Në Indi, religjioni i budizmit është zërtëruar në **hinduizëm**, që konsiderohet si religjioni më i vjetër i vendit.

Theksimi estetik femëror në skulpturë shfaqet falë ndjenjave religjioze të Hindusëve, sipas të cilëve në botë nuk ekziston asgjë e prerë, gjithçka gjendet në gjithçka dhe asnjë punë nuk është ndarë nga mjedisi i vet. Arti indian, i përfaqësuar nëpërmjet shfaqjeve të ndryshme të hyjnive, si simbole të fuqive universale, paraqesin kreativitetin e tyre që paraqitet si rezultat për ndjenjat e tyre të ndryshme religjioze.



Figura 146. Buda në mendim, Sarnat

Shkruaj ese:

Përshkruaj një nga ndërtesat më të rëndësishme në Indi.

Kultura dhe arti në Kinë

Tradita kulturore dhe artistike në Kinë, pa dyshim janë traditat më të gjata në botë. Fillojnë nga mileniumi i III-të p.e.s. dhe janë krijuar falë mënyrës tradicionale kineze për jetë. Luhatësja në kulturën kineze është pellgu i lumit Hoanghoa, *Lumi i Verdhë*, derisa periodizimi i artit kinez është krijuar falë ndryshimeve të qeverisjes së dinastive.

Arkitektura në Kinë, fillimet e veta i shënon në të kaluarën e largët, por për shkak drurit që është përdorur si material bazë për ndërtim, janë ruajtur vetëm mbetjet e verdha. Arkitekturën kineze e shënojnë ndërtimet sakrale, tempujt dhe kështjellat mbretërore, por edhe shtëpitë tipike familjare. Forma më karakteristike arkitektonike sipas të cilit njihet Kina është **pagoda**. Simboli arkitektonik sipas të cilit njihet Kina në botë është një nga shtatë mrekullitë botërore **Muri Kinez**, muri kolosal me gjatësi prej 3000 kilometra me rojtare të vendosur, i lokalizuar në pjesët veriperëndimore të Kinës.

Si motiv më karakteristik në **skulpturën** kineze veçohet **motivi me gjarpër**, që është konsideruar si simbol mbretëror, për të cilin është besuar se paraqet qenie hyjnore, që në këtë vend ka rol të lajmëtarit.

Në **pikturim**, figura tipike kineze paraqitet së bashku me përbërjen poetike, në të cilin zmadhohet gjendja shpirtërore e artistit ose qëllimi që të vizatohet piktura. Pa dallim, nëse është vizatuar me brushë ose tush, në mëndafsh ose letër, teksti ishte shkruar me mënyra të stilizuara me brushë, nga ngjyra e tullës së kuqe deri te ajo e zeza. Në këtë



Figura 147. Pagoda Mahotë

Mendo:

Krahaso arkitekturën kineze me arkitekturën e qytetërimeve evropiane.



Figura 148. Muri Kinez



Figura 149. Gjarpri Kinez

mënyrë njëkohësisht kënaqen edhe gjatë pikturimit edhe në poezi, që paraqet rast të vetëm në botë. Është karakteristike për pikturimin e **lëvizjes së papirusit**, që përveç se lehtë janë bartur, kanë shërbyer edhe si lloj i shiritave të filmit në të cilat është mundur të bisedohet gjatë me ndihmën e fotografive. Veçohet **pikturimi i bambusit**, që ishte i preferuar dhe i përhapur në Kinë. Teknika e pikturimit i dedikohet vështrimit të kujdesshëm dhe njohurës së kësaj bime.

Nga **arti i zbatuar** në Kinë, më të njohura në botë janë veprat e përpunuara në porcelanin e kaltër-të bardhë nga dinastia Ming. Dekorimi i enëve zakonisht ishte bërë me motive të luleve.

Në kohën e periudhës, kur Kina më së shumti i ka zgjeruar kufijtë e vet, nën ndikim të **religjionit konfucian** janë formuar ligjet për kuptimet tradicionale kineze për moralin dhe vendosjen dhe janë konfirmuar raportet e ashpra mes mbretit dhe popullit, prindërve dhe fëmijëve. Të gjitha këto mendime janë futur në pikturim.

Mëso më shumë:

Kinezët konsiderohet si zbulues të **letrës**. Ato të parët e kanë imagjinuar teknikën për prodhimin e saj dhe kohë të gjatë e kanë ruajtur në sekret. Sekretin ishte zbuluar në mesin e shekullin VIII-të nga ana e disa robërve kinez. Kinezët me qëllim që të lirohen nga robëria, Arapëve ua kanë zbuluar sekretin për zhvillimin e shkathtësisë për prodhimin e letrës. Arapët, nëpërmjet ekspeditave pushtuese në Perëndim, e kanë bartur teknologjinë në Afrikë dhe Evropë.



Figura 150. Lëvizje




Figura 151. Figura e bambusit, Li Kan



Figura 152. Vazoja e porcelanit, Dinastia Mina

Shkruaj ese:

Sipas zgjidhjes, përshkruaj një nga pikturat tipike kineze, pikturimin e bambusit ose të lëvizjeve të papirusit.

Kultura dhe arti në Amerikën Jugore

Territori i Amerikës Jugore, nga e kaluara e largët është përplot me pasuri materiale, me të cilën vërtetohet kultura e popujve të atjeshëm, prej para zbulimit të Amerikës nga ana e **Ameriko Vespuçit** dhe **Kristofer Kolombos**. Zbulimet arkeologjike dhe dëshmitë materiale, dëshmojnë për ekzistimin e qytetërimeve të lashta në territorin e Meksikos së sotme, të njohura si **Maje, Actekë, Olmekë dhe Toltekë**. E përbashkët e këtyre popujve të lashtë ishte përdorimi i shkrimit simbolik-idiografik deshifrimi i të cilës do të ndihmonte t'i zbulon momentet e tyre të rëndësishme historike dhe religjioze.

Qytetërimet e lashta prej para periudhës kolumbiane, në Amerikën Jugore kanë ekzistuar 1500 vite p.e.s. deri në vitin 1520 p.e.s, kohëzgjatja është ndarë në tre periudha: periudha **paraklasike, klasike dhe pas klasike**.

Periudha paraklasike e shënon qytetërimin e **Olmekëve**, që si "nënë e të tjerave" konsiderohet si më e vjetër. Për ekzistimin e tyre dëshmojnë **Kokat kolosale**, që dëshmojnë Olmekët si mjeshtër për modelim nga guri. Përpunimi i gurit vërehet edhe te Toltekët, për shembull **ushtarët prej guri**.

Majet e shënojnë **periudhën klasike**. Piramidat që i kanë ndërtuar **Majet** janë një nga piramidat më të mëdha të shkallëzuara të bëra në territorin e Meksikës. Janë të përpunuara nga guri i ndarë, me qëllim krijimi figurë e shkallëve, që çojnë deri në qiell. Në majat e shumë piramidave vërehet platforma për të cilën supozohet se shërben për qëllime religjioze. Për lokalitetet në Meksikë, **Çiçen Ica**, që

Hulumto:

Kur janë zbuluar mbetjet e civilizimeve të lashta në Amerikën Jugore: Majet, Actekët, Olmekët dhe Toltekët dhe cilat shtete sot gjenden në territoret e tyre?



Figura 153. Koka, lartësi 3 m, Olmekë



Figura 154. Ushtarë guri, Toltekë

Shkruaj ese:

Sipas zgjidhjes, për kulturën dhe artin një nga qytetërimet e lashta në Amerikën Jugore.

Kultura dhe arti në Lindjen e Largët dhe në Amerikën Jugore

në vitin 2007 është shpallur si një ndër shtatë mrekullitë botërore në Botën e Re.

Actekët, gjithashtu konsiderohen si banorë të lashtë të Meksikës së sotme dhe e shënojnë *periudhën postklasike*. Shumë më herët që atë të arrijnë fuqinë e tyre, lugina meksikane, për shkak pjellorisë së vetë dhe pesë liqeneve, paraqet qendër të qytetërimit. Raportet e shumta arkeologjike dhe mbetjet materiale flasin për qytetërim mjaf-të të zhvilluar.



Figura 155. Piramida Kukulkanova, Çiçen Ica

✍ Diskuto:

Në orën e mësimit me arsimtarin bisedoni për pushtimin dhe shkatërrimin e qytetërimeve të lashta në Amerikën Jugore nga ana e pushtuesve spanjoll.



Figura 156. Maçu Pikçu, Inki, Meksikë

✍ Mëso më shumë:

Në luginën e Meksikës është zhvilluar Qytetërimi i **Andëve**, me qendër në Peru. Në këtë pjesë ka ekzistuar edhe qytetërimi i përfolur i **Inkëve**, për të cilët dëshmon lokaliteti arkeologjik në qytetin e tyre të shenjtë **Maçu Pikçu**, që gjithashtu është shpallur si një ndër shtatë mrekullitë botërore në Botën e Re.

A

Animizmi, besimi primitiv sipas të cilit gjithçka që ekziston ka shpirt.

Antropomorfizmi, besim se hyjneshat kanë formë dhe karakteristika të njeriut.

Abstrakt, diçka e pa realizuar, që ekziston vetëm si nocion në mendime.

Arti konceptual, drejtimi artistik kur animi mbetet në ide dhe jo në formë.

B

Baptisterium, kube pranë kishës ose një pjese të kishës në të cilën kryhet pagëzimi, pagëzues.

Barok, stil në artin evropian, karakteristikat kryesore të cilët janë me bollëk dekorues.

Budizëm, religjioni indian që e ka themeluar Buda, mësimi i Gotama Buda.

E

Ekspresionizëm, drejtimi letrar dhe artistik nga fillimi i shekullit XX

Episkop, pastor i lartë kishtar.

Eres, mësim që dallon dhe shmanget nga mësimi i vërtetë, në lidhje me çështjet e besimit, herezia.

Estetika, shkenca për bukurinë, në natyrë dhe në art.

G

Gotika, stili artistik që dallohet me ndërtesa të larta me çati të rrafshëta dhe me përpunim nga jashtë i zbukuruar.

I

Ikonostas, mur i gdhendur nga druri me ikona që e ndan altarin nga pjesa tjetër e kishës.

Impresionizëm, drejtim në art dhe letërsi që anon nga rrëfimi i përshtypjeve subjektive.

Iracionale, e pa arsyeshme, ajo që është në kundërshtim me mençurinë.

K

Klasicizëm, drejtimi në letërsi dhe art që shikohet në artin antik (Romak dhe Greqisë së Vjetër) dhe letërsinë e renesancës.

Kubizëm, drejtim artistik, përfaqësuesit e të cilit i kanë shpie figurat e njerëzve dhe mjetet nga natyra në forma gjeometrike, katror, kocka, etj.

M

Megalit, tulla të mëdha prej guri nga koha e hershme e gurit që kanë shërbyer si përmendore mbi varreza dhe viktima.

Minare, kullë e lartë e hollë e xhamisë nga e cila hoxha i thirr besimtarët në lutje.

N

Mbirealizmi, drejtim letrar dhe artistik që anon nga paraqitja e irracionales dhe të pacaktuarës.

Natyalizëm, drejtim në literaturë dhe art që anon kah shprehja më e besueshme e natyrës dhe jetës.

Nekropol, varr nëntokësor, varreza

Neopresionizmi, drejtimi modernist në pikturim.

Neoplasticizmi, një nga drejtimet e pikturimit abstrakt ku mbisundojnë elementet gjeometrike.

O

Observator, ndërtesë e rregulluar enkas për vështrime të ngjashme astronomike, meteorologjike.

P

Pagoda, ndërtesa kineze të ndërtuara sipas kanuneve të arkitekturës kineze, katet janë të ndara me çati të përkulur, me tre radhë të terracave, të rrethuara me një radhë të shtyllave të holla.

Pantomima, shfaqje teatrale në të cilën ndjenjat, mendimet dhe veprimet shfaqen me lëvizjet e fytyrës, duarve dhe trupit, pa folur.

Pozitivizëm, mësim filozofik që insiston pohimin e fakteve.

Periudha komnene (periudha e Komneneve), e quajtur sipas princit Aleksij Komnen, i rëndësishëm sipas pikturimit të freskëve dhe mozaikëve.

R

Racionalizëm, zbatim i mendjes për gjithçka që njeriut i është dhënë nga përvoja.

Realizmi, drejtimi në literaturë dhe arti, që këmbëngul t'i shpreh në tërësi linjat karakteristike të realitetit jetësor.

Rikonstruktiv, riorganizim.

Romantizëm, drejtimi në literaturë dhe art që dallohet me idealizimin e të kaluarës dhe lirinë e plotë të shprehjes.

S

Simbolizëm, drejtim artistik dhe letrar i cili paraqitjet dhe ndjenjat abstrakte i shpreh me simbole (shenja)

Sinkretizëm, në filozofi paraqet kombinim, përputhje me shikimet e kundërta, kinse të palidhura dhe kundërshtuese.

T

Tabu, ndalesë, pa anshmëri dhe shenjëtori të disa mjeteve, vendeve, fjalëve, çrregullimi i të cilëve sjellë vdekje ose sëmundje të shkelësit.

Totem, kafshë, bimë ose mjet i cili në disa fise të prapambetura adhurohet dhe konsiderohet si paraardhës i fisit.

Totemizëm, kult, adhurim i totemit; një nga format më të hershme të religjionit.

U

Urna, enë guri, argjili ose metali në të cilën ruhet hiri i të ndjerit.

Xh

Xhamia, tempull i madh fetar mysliman.

Literatura e shfrytëzuar

- **Anason, H.H** (1974, *Istorija moderne umetnosti*, Beograd;
- **Битракова-Грозданова, В.** (1999) *Рейџијата и уметноста во Анџикаџа во Македонија*, МАНУ, Скопје;
- **Blackburn, V., Holford-Strevens, L.** (1999) *Oxford Companion to the Year, An exploration of Calendar Custom and time-reckoning*, Oxford University Press;
- **Boardman, J. Griffin, J.E.S., Hammond, N.G.L., Spillberger, E., Walker, C.B.F.** (2008) *The Cambridge Ancient History*, Cambridge University Press;
- **Burkert, W.** (1987) *Ancient mystery Cults*, Harvard University Press;
- **Величковски, В.** (1989) *Современа македонска скулптура*, Скопје;
- **Дуев, Р.** (2009) *Музиката во микенскиот свет и Хомер*, Скопје;
- **Ilievski, Hr. P.** (1989) "Doprinos linearnih B testova u rasvetljavanju Grčke religije kasne bronzane epohe", *Godisnjak, Knjiga XXVII*, Sarajevo;
- **Илиевски, Хр. П.** (1996) *Појавата на словенската христијанска култура*, МАНУ, книга 4, Скопје;
- **Илиевски, Хр. П.** (2000) *Живошот на Микенциџе*, Скопје;
- **James, E.O.** (1961) *Comparative religion*, Methuen and Co Ltd., London;
- **Jason, H.W.** (1964) *Istorija Umetnosti*, Leksikografski zavod FNRJ, Zagreb;
- **Jotisky, A., Hull, K.** (1005) *Historical Atlas of the Medieval Woeld*, Penguin Books, London, England;
- **Lesky, A.** (1966) *History of Greek Literature*, London;
- **Машкин, Н. А.** (1994) *Историја на Стариот Рим*, Народна и универзитетска библиотека „Климент Охридски“, Скопје.;
- **McIllopp, H.** (2004) *The Ancient Maya, New perspectives*, Oxford, England;
- **Merrit, V.D.** (1961) *The Athenian Year*, Berkeley.
- **Митевски, В.** (2001) *Анџичка еџика*, Матица македонска, Скопје;
- **Папазоглу, Ф.** (1957) *Македонски жрагови у римско доба*, ЖАНТ, посебна издања књига I, Скопје;
- **Parker, R.A., Dubberstein, W.H.** (1956) *Babylonian Chronology, 626 B.C. – A.D. 75*, Brown University Studies XIX, Providence, Rhode Island;
- **Prettejohn, E.** (2005) *Beauty and Art, Oxford history of art*, Oxford;
- **Проева, Н.** (1997) *Стџугии за анџичкиџе Македонци*, Скопје;
- **Protič, V.M.** (1982) *Skulptura XX века*, Jugoslavija spektak;
- **Ренак, С.** (1990) *Оџшџа историја ликовних уметноста*, шесто издање, Београд;
- **Ростовцев, М.** (1974) *Историја староџ света*, Нови Сад;
- **Флашар, М.** (1986) *Повести из анџичке книжевноста*, Српска књижевна задруга, Београд;
- **Hammond, N. G.L.** (1972) *A History of Macedonia, Volume I, Historical geography and prehistori*, Oxford;
- **Hornung, E., Krauss, R., Warborton, A. D.** (2006) *Ancient Egyptian Cronology*, Brill Leiden, Boston;
- **Hughes, J.** (1990) *Secrets of the Times, Myth an History in Biblical Chronology*, Sheffield Academic Press, The University of Sheffield, England;
- **Čedvik, Dž.** (1980) *Mikenski svet*, Beograd;
- **West, M. L.** (1971) *Early Greek philosophy and the Orient*, Oxford.

